

# MIRTA MEKSI

## mali i slpirtrave

BIBLIOTEKA

854-32  
M.SY



FONDACIONI  
**FV**  
VELIJA

R. Slobotić  
RIBOTIM

8SH-32  
M 97

## Mira Meksi

# Mali i shpirtrave *Tregime*

BIBLIOTEKA  
BASHEK SINDOMASTI  
NR. 114 N<sup>o</sup> 96242

Fondacioni "Velija"

**Kopertina: Ilustrim i Rafael Albertit**

**Botimi i parë: Gusht 1994 "DITURIA"  
Ky botim është pronë e Fondacionit "Velija"  
c Copyright Mira Meksi, 1994.**

*Për llirin, burrin e jetës  
sime dhe për Eleonorën,  
nënën time, që më falë dashuri  
pa kushte - pa të cilët nuk do të  
ishte shkruar ky Mal i Shpirtrave*

*M.M.*

**Mira Meksi**  
**Mali i shpirtrave**

|   |          |
|---|----------|
| <b>Mali i shpirtrave</b>  | <b>5</b> |
| Krishti   | 17       |
| Mikja e toreadorit  | 20       |
| Gjethja   | 23       |
| Gërshëret   | 25       |
| Këpucët me taka të larta  | 30       |
| Nobelisti   | 34       |
| E vdékura   | 40       |
| Portreti  | 46       |
| Takimi tjetër   | 55       |
| Ishte kohë ankthi   | 63       |
| Murgeshat e mbyllura të Santa Anas.                               | 68       |
| Kadare, Atxaga, Çmimi Nobel, Lopez Rubio<br>në shtratin e vdekjes | 74       |
| Ferri i novelave Orientale  | 81       |
| Puthja e Katallanit   | 85       |
| Aksidenti   | 108      |

## **Mali i shpirtrave**

Aeroporti i Madridit njante i përgjumur: a thua ishte kotur për një çast dhe tanë mezi po hapte sytë. Ishte mëngjes herët. Ira Maks u krohd me shpejtësi në përgjumjen e aeroportit dhe nisi të lëvizte zhdërvjellazi për të shpirë këmbët nga mpirja e natës dhe për të mos e lejuar kotjen e përgjithshme t'i binte në kokë. Vështroi me vëmendje ndriçimin e sallës së pafund, pragut që do ta ndante nga ai vend, dhe iu duk i vakët dhe i trishtuar. Mikesha që e shoqëronte kish hyrë në kafe-restorant të blinte kruasant dhe kakao për mëngjes. Bagazhin e kishin regjistruar, tiketin e kishin marrë dhe prapë u mbeteshin edhe pothuaj njëzet minuta kohë që të rrinin bashkë. Hëngrën shpejt, duke përsëritur edhe një herë porositë, listën me libra që mikesha duhet t'i dërgonte sa më parë dhe, kur të njëzet minutat fluturuan, nisën të shkëmbenin të puthurat e vjetra të ndarjes, ndërsa Irës zuri t'i përzihet nga ndjenja e gjithhershme e ndarjes, të cilën ajo s'e bënte dot zap kurrë. U mundua të mos e shfaqte. Shtrëngoi dhëmbët, por lotët i rrodhën nga sytë dhe ndjeu se hunda i qe bërë flakë. I vinte nga larg dhe ishte një ndjenjë e përzier humbjeje dhe imlefi, që i ishte shfaqur së pari majë skërkave të detit kur ishte pesë vjeç dhe kish rrqullisur në shkumën e dallgëve kukullën e saj më të dashur që ta shpëtonte nga duart shkatërruese të të vëllait trevjeçar. Dhe që atëherë e kish cilësuar si ndjenjë përherë triumfuese, të cilës nuk kishte ç'ti bënte as vetë mosha.

U fut në radhën e njerëzve që prisnin kontrollin e pasaportave dhe kur u ndodh përpëra dritarezës së xhamtë dhe zgjati pasaportën, dëgjoi të dijnин andej disa fjalë të pakapshme. Nuk reagoi.

-Nuk dini spanjisht?

- Po, si jo!

- Punonjëse ambasade?

- Jo, pse?

- Ngaqë keni ndenjur këq shumë këtu.

- Jam përkthyese. Kampunuar në një kolegji përkthyeshish.

- Ah, kuptoj. Urdhëroni pasaportën.

Ira kaloi dhe, pasi futi çantën e shpinës në kontroll, u kthye edhe një herë dhe e puthi më dorë mikeshën e saj. Iu duk se ndodhëj tej, në një largësi të pakthyeshme, dhe sytë iu veshën nga një cipë lotësh.

- Çfarë keni në çantë, zonjë? - dëgjoi sakajq një zë të rreptë.

- Në çantën tijme?

- Në çantën tuaj, po!

- Hiç, gjëra të zakonshme...

- Por, aparati...

- Ah, **aparatil Po, se ç'kam disa monedha, franga zviceriane, mos ato... Po i heq...**

Ndërkaq punonjësi i aeroportit po e shoqëronte Irën në një dhomë të veçantë. Mbi një tryezë ajo zbrazi çantën: dy libra, njëri tepër i çmuar ngaqë mbante kushtimin e një shkrimitari të madh, një shishe parfumi "Anais", një xhuxh plastik me barkun plot më saçme karamëlesh, dy çokollata, një qiri i vogël në formë 6, një pako me shami letre, një këllëf itejdukhëm me një shirit mëndafshi ngjyrë blu dhe disa franga zviceriane monedhë.

Punonjësi e mori çantën bosh dhe e kaloi në kontrollor. Pastaj mori me rradhë sendet... Asgjë.

Ira rrinte e topitür. Ai i tha t'i fuste sërisht sendet në çantë se mos ndoshta qenë gabuar...mos kish gabuar aparati...

E kaluan sërisht çantën në kontrollor. Sërisht aparati dha sinjalin se aty diçka kish. Punonjësi qe hutuar. E zbrazën çantën prapë; i kontrolluan edhe njëherë nga e para të gjitha sendet. Asgjë. Ira mbante pa mendje në dorë këllëfin e

tejdukshëm me shiritin e mëndafshëtë.

Përpara kontrollit qe bërë rrëmujë. Kishin njoftuar disa punonjës të tjerë. Ira ktheu kokën dhe pa mikeshën e saj që po i kërkonte shpjegime me duar; ishte tepër e shqetësuar.

Një grua me uniformë erdhi dhe i kaloi Irës një aparat nëpër trup. Minutat kalonin me shpejtësi. Edhe pak... Ira dëgjoi zërin kumbues që njoftonte gjuhë pas gjuhe nisjen e avionit 505 të linjës Madrid-Zürich. Dalja 33.

Atëherë u kujtua. I zgjati punonjësit të aeroportit këllëfin e tejdukshëm me shiritin e mëndafshëtë që mbante pa mendje në dorë. Ai pothuaj nuk e kuptoi. Mekanikisht e futi në aparat... Të gjithë indikatorët e aparatit u ndezën rrufeshëm. Punonjësi syçakërritur pyeti:

- Ç'është kjo? Kjo çfarë është?
- Legjenda, zotëri, - iu përgjigj Ira e mundur.
- Çfaarëë? - Ai rrëshqiste nëpër gishtërinj shiritin e mëndafshëtë blu.
- *La le-ye-nda, señor, la leyenda!* Dhe qënka e thënë të mbetet këtu! O Zot, nuk e marrkam dot me vete!

Përpara se të kalonte daljen 33, Ira mori një kafe të fortë. Rrufiti më gllënjkë të vogla pa zë dashurinë që po e braktiste, dhe që ajo do të vazhdonte ta rrufiste kështu edhe ditëve që do të vinin, sa herë të pinte kafe, dhe kaloi.

Avioni kalonte zhurmshëm mbi një qilim shtëllungash të bardha reje. Ajo kërkoi sërisht kafe për të ndier edhe njëherë shijen e dashurisë që e pat lënë.

Atë çast, shkalla e pjerrët e një dielli pa shkëlqim u tëhoq lart, bardhësia përreth kuqëloji dhe, pas pak, një muzg i vetvetishëm peshoi mbi re. Atëherë ajo u kujtua se vetëm në atë çast qyteti i gurtë, që kish lënë pas, mund të merrte frysë lirisht nga tërë ai zheg që e digjte ditën.

Vetëm kur ndajnata rrokuillisej nga mali Moncayo dhe binte mbi të.

Irës i pëlqente të dilte në muzg e të ulej për të pirë kafe në barin Amadeos, i cili ndodhej përpara lumit të gurtë e të tharë që e pëershkonte qytetin mespërmes dhe e ndante në dy pjesë: Tarazona antike dhe Tarazona e re. Bashkë me freskinë vinin aty edhe miqtë e saj, të cilët nguleshin përpara gotave të uiskit me akull dhe përsërishnë të njëjtën bisedë për zgjedhjet e afërtë bashkiakë.

Ajo ë ndiqte me zorr dhe bezdi fillin e bisedës dhe mezi ç'priste që, sipas ritit, dikush të propozonte të shkonin e të "çukisnin" në ndonjë "bodegë".

Bodegat - qilaret e famshme të qytetit të gurtë, e joshnin si asgjë tjetër. Verërat e moçme të burgosura nëpër kafaze muri, kungujt e ujit dhe lloj-lloj enësh porcelani renditur nëpër sergjene, proshutat e varura në tavan, tryezat e stërmëdha për tridhjetë a dyzet të ftuar, të gdhendura në trungje pemësh, trofe korridash, fotografi toreadorësh dhe një lloj fryme antike dhe misteri përzier, u stisin brendinë.

Ira nuk kishte asnjë argument real, por bodegat i ngjanin se ishin të vetmet vende që, me anë të një teknike të fshehtë a marifeti të panjohur, kishin mundur të ruanin shenjtërisht të pandryshuara pjesëza të Spanjës së lashtë, që tashmë nuk ekzistonte më askund tjetër, e që ajo ish përpjekur më kot ta gjente diku.

Po të hyje brenda, sytë të mjegulloheshin nga avujt e padukshëm të verërave të moçme të burgosura, që vërtiteshin këmbëngulës në ajër dhe që tinëzisht futeshin në kujtesat e njerëzve dhe shkulnë që aty realitetë të harruara, përtë cilat të zotërit e atyre kujtesave as që e dinin se ekzistonin. Ira ishte aty dhe i priste e i përpinte si e babëzitur efektet e verërave të moçme: legjendat, pa të cilat s'do të kish mundur të jetonte as edhe një ditë në atë realitet aq të varfër, përpara imazhit që i kish krijuar për të fantazia.

Beatriçen dhe Alonson i kërkoi pa prehje nga bodega në bodegë, nga krahina në krahinë në tërë Aragonin e vjetër

duke mbledhur thërrime legjende nëpër librat me emblema - e vetmja gjë që pët mebetur nga familjet e mëdha të qëromoçme - derisa e ndërtói të plotë trupin e legjendës në manastirin e Veruelës, me dorëshkrimet e Becquer-it të madh. Kjo ndodhi një të shtunë të vakët qershori, kur në klaustrin e manastirit po luante në lut *Kohë minueti* David Parsons.

Të shtunave që pasuan, ajo vinte dhe ulej në barin *Corza blanca* që ndodhej përballë manastirit, përtë qenë më afër legjendës së saj. Ishte bërë rit. Sa gdhinte e shtuna, malli për legjendën ia shpinte këmbët në *Corza blanca*. Vajza e ndiente se nuk vazhdonte ta tërhiqte kështu drejt saj, duke e joshur me mallin e pakuptueshëm, ajo çka pat zbuluar nga legjenda. Përkundrazi, duhet të qe diçka e fshehur ajo që e mbante robinë, diçka e nënujët, të cilën nuk e njihte dhe nuk guxonë ta merrë vesh: duhet të shkelte në Malin e Shpirtrave. Dhe në një ditë të shënuar, dohësdo.

Një të shtunë të tillë malli, afër mesditës, e gjetën miqtë e saj në *Corza blanca*, duke rrufitur kafe të fortë dhe duke u përcartur pas gjurmëve të legjendave. E ftuan të shkonte me ta në piknik në malin Moncayo:

- Jesusi do të na gatuajë *paella*, - i thirri Adja që nga makina. - S'kemi lënë kusi pa marrë me vete.

- Moncayo është paraja e blertë dhe ti ende s'e ke parë, - ia plasi Ana. - Eja!

Ata i kishin folur sa e sa herë për malin, në këmbët e të cilit shtrihej qyteti i gurtë. I kishin folur si për një gjigand të blertë që çlironë shpirrat dhë dehët sytë.

Ira nuk mori dot vesh se si u gjend ulur në një nga makinat e ekskursionistëve, që ia kishin plasur një zallahie të qeshurash, me një shportë për të mbledhur manaferra në pëqi.

Rrugë po i shpinte rrufeshëm drejt Malit; dhe ajo përherë kishtë menduar se mund të shkonte atje një ditë të shënuar. Rastësia i kish shkelur hamendjet...

Moncayo ishte vërtet i bukur, por Irës nuk i la ndonjë mbresë të thellë: vendi i saj i vogël ishte i téri male, dhe çfarë malesh! Megjithatë, e lëshoi në të shkuar një kompliment për bukurinë e malit, sa për mirësjellje; miqtë e saj kishin kohë që prisin me ngulm përshtypjen që do t'i bënte Irës pamja përreth.

E vetmja gjë që e çuditit vajzën ishin disa lule të verdha të vockëla shkurresh që kishin mbushur malin. Aroma e tyre, që s'ngjante me asnjë lloj tjeter aromë, ishte tepër e egër. Ira s'mund të gabohet. Ato lule i kish parë për herë të parë rrugës së varrezave në qytetin buzë detit ku qe varrosur gjyshi i saj. Dhe shumë kohë më parë. Çudi, tha me vete, të njëjtat lule në Moncayo dhe rrugës së varrezave ku prehet gjyshi im!

*Paeßen* e mrekullueshme të dhjetë ekskursionistët e hëngrën në një shtëpizë të drunjë të hatashme, e cila qe pronë e bashkisë së qytetit. Pastaj ndanë nëpër frutiere manaferrat e dhe luleshtrydhet që kishin mbledhur, dhe u shpërndanë të merrnin rrezet e fundit të diellit, të nderë nëpër shezlongët e shumtë rreth shtëpizës së drunjët.

Ira po mblidhët ca nga ato lulëzat e verdha të shkurreve që e kishin habitur pak më parë dhe që po ia mbushnin duart me aromë egërshane, kur një shenje prej drite në qiell, të cilën ajo e interpretroi si paralajmërim të ardhjes së muzgut, i ndriçoi mendjejn.

Gjithçka qe përbësuar në kalendarin e ditëve dhe ajo ditë që po jetonte në mal, ishte kthyer papritur në një ditë të shënuar. Ajo s'po shkonte dot drejt Kohës, Koha po vinte drejt saj.

- O Zot! - klithi vajza së bredshmi. - Kaq shpejt! - Dhe u përpooq të përgatiste veten.

- Sonte është Nata e të Vdekurve, - tha Ira e tronditur nga kumt i perëndishëm të cilin e shpalli me zë.

- Nata e të Vdekurve? - ia bëri pa shumë interes Marifina.

- Ti e njihke përmendësh kalendarin fetar?

- Jo, çne, di pak gjëra. Po s'onte jam e sigurt, është Nata e të Vdekurve. Prisni kur të dëgjoni kambanat e Sorias! - vijoi ajo dhe ndjeu ta kaplonte një emocion i njojur.

- Oh, jo, mëvjen keq, Ira, por s'kanë për të rënë kambanat e Sorias. Ka mbi njëqind vjet që s'bien më për Natën e të Vdekurve. - përfundoi Adja dhe hapi derën e makinës - Unë po nisem. Jose-Luis, do të vish me mua?

- Ikim se u freskua - tha Jesusi. - Fina, mos harro xhaketën time! Ira do të vish me ne apo me Juanin?

- Shkoni, shkoni! - tha Ira. Po vij me Juanin,

- Ne do të rrimë të shohim si vdesin yjet, - ia priti Juani duke qeshur dhe duke i bërë Irës një shenjë bashkëfajnie.

- Epo, gdihuni përjashta atëherë!

- Si vdesin yjet... - foli si me vete Ira. - Juan ke vërtet qejf të rrish? Më mirë nisu me Jesusin. dhe më lër makinën tënde.

- Të të lë vetëm? Punë që s'bëhet. Me sa mbaj mend unë, rruga për tu kthyer kalon nga Trasmozi, vendi i shtrigave... - Mjeku i ri e trashi zérin.

- *Hasta manana!*

- *Hasta manana!*

- *Hasta manana!*

Zërat dhe zhurmën e makinave i përtypi dhe i gëlltitit ndajnata që po vinte shtruar, ndërsa ajri qe mbushur me aromën egërshane të lulëzave të yerdha të shkurreve.

Ira me Juanin morën ngadalë shtegun që të nxirrte te gërmadhat e lashta të kishëzës së Tempullarëve.

- S'ka mbetur pothuaj asgjë, Ira, që ta dish. Mali i Shpirtrave e ka bluar keqazi kishëzën.

- Me siguri që do të ketë lënë diçka për të përtypur më vonë, - ia priti vajza.

Ecën pa folur edhe pak, dhe kur nuk e prisnin, u mbiu para syve kishëza: Juani ktheu kokën për të părë edhe një herë mirë shtegun që i nxori aty. Çudi! tha me vete, nuk e dija që priste kaq shkurt.

Kishëza qe ronitur e tëra. Shumë pak copa muresh

mbaheshin në këmbë. Barërat e këqia kishin shpallur perandorinë e tyre duke pushtuar çdo vrimë e skutë dhe duke klithur më tëpër, të harlisura për pushtetin e tyre, përmbi varret e shumta e të sheshuara që shtronin truallin e kishëzës. Ira me Juani po hetonin atë vend braktisjeje secili për hësap të vet, por pas disa minutash u gjenden të dy, në të njëjtën kohë, përpara një cope muri me tavan, që mbahej mrekullisht në këmbë dhe ngaku varej një kambanë.

- Oh! - ia bëri mekurazi Juani. - Këtë s'e kam parë kurrë. Kam ardhur këtu me dhjetra herë. Si është e mundur?

Atë çast, nata e anulloj prerasi muzgun ende të ri dhe i zuri vendin. Ndërsa ajo bënte këtë veprim, të largëta, por të qarta, u dëgjuan kambanat e Sorias. Jehona e tyre, e padëgjuar për më shumë se njëqind vjet, shkundi ngadalë kambanën e kishëzës që zuri të binte, e mugët dhe e lagësht. Ishte shumë pranë tyre, por nuk i shqetësonte-me tingëllimën e saj. E kish ulur zërin në pëshpërimë dhe binte vetëm për ta. Dhjetë hapa më larg, me siguri që nuk dëgjohej.

- Pra, ti erdhe këtu që të takoheshe me legjendën, siç e kishe bërë në mendje prej kohësh?! - Juani po i tundte fort. krahun Irës, i kapur bëfas nga një krizë tmerri. Po atë çast, Ira mundohej të dëgjonte se si pikonin djersët prej ndryshku të jeshiltë të kambanës.

Aroma e lulëzave të verdha qe bërë më e fortë, sikur dikush u shtypte petalet.

- Po tani, më thuaj, tani ç'do të ndodhë? - Juani përpiquej më kot të bërtiste. Ira ndjeu dhembje në krah.

- Tani do të ngrihen ata nga varret, Shpirrat. - recitoi ajo ngadalë legjendën.

Nuk kishte frikë, ose më mirë kishte një frikë të njojur, të zbutur, të cilën, si një kafshë shtëpiake, e mbanë në frë.

Ky ishte thjesht një takim. Takim me legjendën. Ajo do të përpiquej të gjente Alonso, kontin Alcudiel, pjesa tjeter s'ishte vetëm dekor.

Edinte se edhe mund të çmendej nga pamjet rrëqethëse: kafkat e zverdhura e të roitura do të dilnin nga gropat dhe kokallat e ngrëna të përziera me kocka ujqërisht do të përpinqeshin t'u hipni skeleteve të kuajvë, lëfetrate qefinëve do të valëviteshin si flamuj pa stemë në betejë dhe kush do të guxonte t'i shihte, ashtu si edhe pat ndodhur, do të humbiste përmbajtjen e kafkës së vet, përpara se t'i kallkanosej gjaku në damarë. Por ajo ishte e përgatitur.

Megjithatë, Koha e legjendës, të cilën Ira nuk e kishte vënë në hesap, i pat shkrirë edhe kafkat edhe skeletet nëpër gropat dhe ledhet ku kishin rënë, dhe e kish zbërdhylur njyrën e tmerrit.

Ira që kujtonte se qe verbuar nga nata, shqoi më në fund, me sytë e plagosur nga stërmundimi i zgurdullimit, ca mjegullina drite që endeshin pa prehje e që kuptoreshin menjëherë që s'ishin bërë prej materies së natës. Ajo dalloi, nga forma, mjegullinat që u përkisnin Tempullarëve, Klerikëve me Mamuze dhe ato që u përkisnin Hidalgoje të Sorias.

Shpirtërat e tyre vinin rrotull dhe pastaj i suleshin me tërbim njëri-tjetrit në një gjueti fantastike, si atëherë kur u gjakosën e u copëtuan për zotërimin e Malit. Në atë zjarr të llahtarshëm beteje, mes mjegullinave të dritës, Irës i shkuani sytë tek një copë nate që po shndërrrohej mes shkurreve. Aroma egërshane e lulëzave të verdha të shponte hundët. Copa e natës, pas shumë shndërrimeve, kish marrë formën e një vërr madhështor anonim.

Vajza u mundua të vinte rregull në imazhet e legjendës, që të gjente se kujt i përkiste.

- I kujt është varri? - i erdhën asaj në vesh fjalët njëra pas tjetrës, si kokërriza tespijesh, të bartura nga zëri familiar i Juanit nga dreqi e di çfarë cepi të natës.

- Ende nuk po e gjej, - u nis përgjigja me fjalë sërisht kokërra-kokërra, drejt dreqi e di çfarë cepi të natës.

Ajo po jetonte në një univers të huaj, por që s'ish pjellë fantazië. Dhe prova që Juani; edhe ai po jetonte në atë

univers.

Ira iu afroa varnit tē askujt dhe pa mbi tē armë gjahu, tē cilat duhet t'i njihte. Përnjëherë një mendim erdhj e i vetëtiu... Po si nuk i kish rënë me tē që në fillim?!

"Beatriçja dhe Alonsoja, fëmijët e kontëve Borges dhe Alcudiel, po ktheheshin nga gjuetia e ujqërve në malin Moncayo, rrethuar nga pazhët dhe hordhia e gjuetarëve. Udhës, Alonsoja i rrëfente Beatriçes së bukur legjendën e llahtarshme të Moncayos-Malit të Shpirtrave. Prandaj edhe e patën lënë aq herët gjuetinë: ajo natë që po afrohej, ishte Nata e të Vdekurve; herët a vonë do tē gjëmonin kambanat e San Juan del Dueros dhe shpirtrat do tē ngriheshin nga gropat e tyre dhe gjarpërinxjtë do tē vërvshëllin; lukunitë e ujqërve do tē nxinin truallin dhe..."

Në kështjellën e Alcudielëve në Castilla:

"- Kushëri ë. bukur, a s'të pëlqeu shumë kapsja e çmuar e kapeles sime, tē cilën ma ka falur ime më, ndjesë pastë? Është e jotja, po ta dhuroj ty me gjithë shpir.

- Si kështu, i dashur kushëri! Unë sot nuk kam ndonjë festë.

- Posi jo, sot është dita e të Gjithë Shenjtëve, pra edhe e Shenjitit tënd. Dhe përpara se tē mbarojë kjo ditë, do tē desha që edhe ti tē më japësh diçka tënden si dhuratë.

- Vërtetë... - Beatriçja e bukur nisi tē rëmonte në palët e gjera tē mëngëve tē saj tē kadifenjtë qëndisur me ar. - Oh! E paskam humbur shiritin blu prej mëndafshi, përngjyrën e tē cilit the se ishte e zemrës sate.. Atë desha tē tē dhuroja, por... më paska humbur...

- Ku vallë?

- Në Malin e Shpirtrave...

- Oh!!!"

Universi i huaj po shkelej nga çapa të lehtë pës shpinës së Irës. Ajo u kthyte dhe pa një vegim të bardhë që po afrohej: dalloj shkoqur qenien e shndritshme, mbështjellë në pelerinën e kadifjenjtë, qëndisur me gjajanë të artë. Nga supi i varej një shirit prej mëndafshi ngjyrë blu, i shqyer e i gjakosur: Beatriçja.

I kaloi fare pranë, pa e përfillur aspak krijesën që nuk i përkiste vdekjes së saj, dhe nisi t'i vërtitej rrotull varrit. Ira pa se fytyra e saj e një bote tjetër, kish të modeluar një ngërdheshje ngazëllimi. Ira qe hequr mënjanë.

Pra Beatriçja nuk paskësh vdekur në dhomën e saj, siç thoshte legjenda, e sakatuar nga mëngjesi i tmerrit që i kishte vënë përparr syve shiritin blu të shqyer e të gjakosur mbi dysheme, shiritin që ia kishte sjellë natën torturuese të të Vdekurve, ku ajo pat vuajtur zemërngrirë, vetë Shpirti i Alonsos nga Mali i Shpirtrave... Ira u shkund. Jo, jo, ajo pikërisht atë mëngjes pat rilindur. Sikurtë ndodhë e kundërtë, sikur të mos i vinte ai shirit i shqyer e i gjakosur, konteshëza do të kish vdekur edhe një herë, siç pat vdekur dhjetëra herë në Oborrin e Francës, ku jetonte rrethuar nga galantët spitullaq, e molepsur nga një dashuri në grahmë.

Kur djaloshi i pat zgjatur kapsen e çmuar, ajo kish parë në sytë e tij flakën e një zjarri të madh që, po të ushqehet pak, rrezikonte t'i shkumbonte të dy të gjallë.

Atëherë ajo kish vendosur të provonte edhe një herë ta mëkonte dashurinë e saj, që po hiqte shpir, me gjakun e altarit të sakrifikit. I kish kërkuar Alonsos një sakrificë që shkonte përtej vdekjes: ta merrte dhuratën e saj në Malin e Shpirtrave, Natën e të Vdekurve. I kish kërkuar një dashuri mbi vdekjen.

Vegimi i bardhë i Beatriçes i vinte mullithi varrit duke e përkëdhelur mermerin e tij, e ngazëllyer gjithsaherë.

Nuk ia kish kërkuar sakrificën në gjunjë e përlotur, duke iu luture përgjëruar në emër të dashurisë. Jo! Ajo i pat luajtur me shigjetën idhnake të ironisë së akullt kordat e krenarisë

sëçartur prej trimi, që aq fort tingëllojnë të nxehura nga zjarri vetsħkaterrues i dashurisë së vërtetë.

Papritur, Beatriċja kish marrë rrugën drejt Irës, vajza që po shikonte tmerrin e zbulimit tē saj, u drodh e tēra. Beatriċja hoqi ngadalę̠ nga supi shiritin e mëndafshtë që i varej gjoksit dhe ia zgjati asaj. Dy universet ishin puqur një čast nē njé pikē.

Irës iu kujtuān vetëtimhi dashuritë e saj tē vjetra e tē reja, tē gjitha tē dështuara dhe ia mbértheu sytē me lakmi shiritit blu prej mëndafshi.

Beatriċja merrte pafundësisht rrugën qē̠ nga varri drejt Irës, pēr t'i dorëzuar shiritin e gjakosur. Dhe çdo herë vegimi i saj zbehej e zbehej.

Ira e kuptoi se, po tē mos e kapte atē sekondë, s'kish pēr ta parë mē shiritin blu. Universet po ndaheshin sērish, nē jetē tē jetēve.

Vajza e mbértheu shiritin nē častin kur vegimi i Beatriċes qe shkriři i téri, dhe ra nē gjunjē.

Yjet qē̠ po hiqnin shpirt, i treguan osh e bran rrugën e shkurtér pēr te makina. Ira e gjeti Juanin qē̠ po dremiste me kokēni lëshuar mbi timon. I erdhi keq ta zgjonte. Siguroi shiritin e mëndafshtë blu nē gjoks dhe peshoi nē shpinore. Pas pak do tē zbardha.

## Krishti

Peshën e ankthit e ndieva që kur dola në rrugicë dhe zura t'i têrhiqja këmbët zharg nëpër kalldrëm. Luftoja e ndarë më dysh, ose më mirë luftonin dy vetat e mia me njëratjetren: të shkoja apo të mos shkoja atje? Po ç'doja unë atje? E pse të mos shkoja, pse?

E kapërxeva pragun e gurtë qindravjeçar. Brenda, drita konkrete e diellit zëvendësohej nga një dritë tjetër, produkt iasaj të diellit, por, që e filtruar nga xhamia të ndryshëm, të jepte ndijesira abstrakte. Nuk ishte i vetmi ndriçim: drita e qirinje dhe e shandanëve e ndihmonte të shndriste tërë atë sallë të stërmadhe e të stërpopulluar. Por edhe mugëtira kish vendin e saj: qe varur kokave të statujave, qe struktur qosheve dhe skutave, ndihmonte qiririn e kuq të altarit, që digjej përjetësisht, të xixëllonte edhe më tepër; rrinte pezull mbi enën e gurtë të ujit të bekuar dhe e bënte të dukej pus i thellë që shkonte me mijrëra kilometra nën tokë.

Murmurima e zërave të njerëzve në kor që përsërisnin fjalët e një njeriu, i cili kish mijëra vjet që i drejtonte dhe ua vinte në gojë atë fjalë arriti të m'i shqepët edhe mua buzët, mua që pa dashur qeshë gjunjëzuar në një stol druri me parmakë; i cili ngjante sikur ndodhej në një tjetër kohë dhe në një tjetër hapësirë.

Nuk arrija të artikuloja asnjë fjalë, tingujt që nxirrja nga goja nuk lidheshin dot: po çrëndësi kish? Mjafton që unë iu nënshtrova atyre ligjeve të gjithjetshme, të cilat deri atë çast më kishin lënë jashtë tyre.

Vazhdoja të lëvizja në rrjedhën e ritualit. Pa asnjë lloj ndjenje.

Bashkova duart me pëllëmbë të hapura; një petëz e bardhë ra në to, pastaj takoi qiellëzën time dhe bashkë me ndjenjën fizike që po më jepte ajo botë magjike, nëpërmjet

56242

shijes së-petëzës së bardhë, kuptova se isha kthyer në një majmun mistik, që përsëriste përsosmërisht veprimet e të tjerëve, madje edhe pa i parë ata. Mos vallë i gjithë ky ritual ishte brenda meje?

U ula sërisht në stol, kësaj here më e sigurt, ngase më dukej se tashmë ndodhesha brenda botës magjike. Nuk kisha vënë re se kush rrinte pranë meje; por papritur, diçka më bëri të kujtohesha për këtë.

Një vështrim i ngulët dhe material, si gisht i shtrirë, filloj të më shqetësonë. Nuk doja të ktheja kokën. Vështrimi vinte nga e majta ime dhe ishte aq i ngulët dhe ngacmues, saqë faqja e asaj ane m'u përndez sa s'po e duroja dot.

Atëhere ktheva kokën. Askush nuk ndodhej majtas meje, askush. Vendi qe bosh. Mirëpo vështrimin ngulës e mora kësaj here si flakurimë ballazi, në tërë fytyrën që m'u iskuq nga afshi i nxehjtë. Atëhere, ngrita kokën lart dhe ndesha në sytë e tij. U pamë sy në sy, Krishti dhe unë. U njohëm menjëherë dhe pa dhembje.

Ndërkohë, ajri u mbush me një erë të çuditshme që bartej nga një tym, erë, të cilën sadoqë e trazova kujtesën time fund e krye, nuke gjeta dot. Ishte erë e mirë apo e keqe? Mos nuk duhej ta pëlqeqa? Njerëzit duke shen të kendellur nga ajo aromë. Dhe unë, brenda disa çasteve mësova ta pëlqeqa.

Turma, më tepër plaka dhe gra të thyera në moshë, drejtoheshin për tek Ai, që më vështronë vetëm mua.

Qe një statujë e madhe me flokë të vërtetë, me kurorë gjembash, po të vërtetë, e mbërthyer në një kryq vigan, që vështronë me sy të gjallë. Krishti i San Franciscos!

Plakat i afroheshin, i puthnin këmbët e kryqëzuara e të përgjakura, e fshinin puthjen me një shami të bardhë, që ndodhej aty pranë, dhe largoheshin...

U afrova edhe unë. Sa i çika paksa buzët në vragën e gjakut prej statuje, i ndjeva të zhuritura. Çova kokën sërisht dhe pashë se, sytë që më vështronin ishin ngritur lartë në

në kubenë e kishës, e cila, nga ana e saj qe zbuluar e bërë njësh me qiellin. Bëra xhiron rrrotulluese të plakave e u gjenda prapë në vendin nga ku qeshë nisur në fillim për tek Ai. Eca sërisht përparrë. Buzët më digjnin. E putha edhe një herë vragën e gjakut dhe e harrova puthjen pa e fshirë me shami. Plaka të tjera vinin pas meje. Për çudi, tani pas puthjes, plakat vinin dorën te buzët, të habitura që po u digjnin edhe njëherë si dikur.

- Ndiz një qiri moj bijë, - më tha njërz prej tyre.

Hodha monedhën dhe ndeza dy qirinj të bardhë e të ngrënë, aq sa dukeshin sikur s'do ta mbanin dot flakën e babëzitur që kisha ndezur me dorën time.

Nuk di ta them me siguri se kur më filloj ajo dherr bje koke. E ndieja të më shtrëngonte kafkën si unazë; nuk më pushonte me asnë lloj qetësuesi, as ditën as natën. Madje ditën, përveç dhembjes, ndieja edhe peshën e rrethit që më rëndonte kokës. Përparrë pasqyrës, fytyra m'u duk e ndryshuar: një brerore drite e situr që kish mbushur kornizën e pasqyrës, ngjante sikur buronte nga flokët e mi, paçka se vinte nga shumë lart...

Një ditë, kur dhembja m'u bë e padurueshme, kuturisa dhe vura dorën në ballë. Dora m'u gjakos nga shpuarje gjembash.

Me cilin do ta ndaja vallë atë dhembje koke, që më shtrëngonte kokën si kurorë gjembash?

*Spanjë, gusht 1990*

## Mikja e toreadorit

Gjysma e sheshit të demave fërgëllonte nga një i ftotë paravjeshtor, ndërsa gjysma tjetër ngrohej nga rrezet e kursyera të një dielli të mekur, i cili të nesërmen do të gdhihej në vjeshtë.

Ishë dita e fundit e gushtit.

Një kalorës i ri në të bardha, mbi një at të bardhë, doli nga arena dhe zuri t'i binte asaj rrotull disa herë, duke e ngarë kalin galopthi dhe duke përshëndetur spektatorët me kapelën e tij të madhe prej plisi. Banda muzikore ia mori një marshi të shpejtë dhe sakaq korrida filloj.

Njollat e ngjyrave ndërroheshin me një shpejtësi të hatashme në arenë: ato dirigjonin ndjenjat e spektatorëve, të cilët e prisnin shfaqjen dhe zhdukjen e tyre me britma. Kur ngjyra vjollcë ndërrohej me të kuqen, ngazëllimi i njerëzve arrinte kulmin, për t'u kthyer më pas në një ndjenjë ankthi, e cila, në më të shumtën e rasteve, pasi shndërrohej me shpejtësi në nervozizëm, frikë, shqetësim, padurim, kurorëzohej me klithma triumfi.

Espartako u ngrit në majë të gishtërinjve dhe me një goditje të përsosur, e nguli shpatën në zverkun e demit.

Urratë u përzien me thirrjet:

- Veshin! Veshin! Veeeshiiin...

Të gjithë qenë kthyer nga një galeri leprozike ku qëndronin, të veshur me një pushtet gati të perëndishëm, gjyqtarët e ndeshjes me kostume të zeza dhe u kërkonin trofenë e fitores së toreadorit: veshin e demit të vrarë.

Gjithçka kaloi aq marramendëse pas kësaj, me zhurmë, britma, gjak, dema që hiqnin shpirt të gremisur në truallin e

arenës, shpata të gjakosura që tundeshin në ajër, "bandera" që valëviteshin, toreadorë që këmbëheshin shpejt, saqë ajo u çudit kur e pa Çamakon në mes të arenës, gati për t'u ndeshur.

Nuk ndiente pikë frike për të. Mbasë ngaqë kish parë me dhjetra korrida, mbase ngaqë e ndiqte në çdo stërvitje, mbase ngaqë i ati i Çamakos, dikur toreador me famë, po e vigjélonte ndeshjen e të birit përgjatë gardhit rrëthues të arenës.

Demi, me kurrizin e copëtuar nga "banderijat" ngjyra-ngjyra, s'lëvizte nga vendi. Rinte i përgjumur dhe kryevarur, duke rrëmihur arenën sikur ta kish zënë gjaku i plagëve të veta.

Spektatorët thërrisin nga padurimi.

Pikadori, hipur mbi një kalë azgan të korracuar rëndë e me sytë të zënë, si një kalorës mesjetar, iu sul demit me ushtën e gjatë në dorë.

Celiku i ushtës hyri në qafën e demit dhe gjaku plasi curril; pastaj, gulshe-gulshe, nisi të binte mbi rërën e arenës që e thithje si e llimaksur dhe e përcillte poshtë.

Jargët e jeshilosura që i shpërthyen demit nga goja, ranë mbi pllangat e gjakut të arenës dhe atëhere një shkrepëtimë njëçastëse që lindi në pikën e tyre të takimit, puqi qiellin me tokën.

Engjëlli i vdekjes u suall mullithi disa herë mbi arenë, por askush, përveç asaj, nuk e pa.

Ankhi që po rinte diku i struktur në një qoshe të sheshit të demave të Tarazonës, lëvizi nga vendi...

Asaj iu ngrit diafragma sipër dhe e kuptoi se nuk do të që më në gjendje të merrete frysë. Ankhi po i rrëshqiste ngadalë nëpër damarë, si lëndë e një tjëtër bote dhe ajo ndjeu fizikisht se po kallkanosej.

Ndërkohë, Çamako kish rrëmbyer cohën e kuqe dhe po luante në arenë me disa lëvizje aq të holla, saqë dukej sikur po vizatonte filigrana në ajër: ai ishte kërcimtari antik i një

valleje të shenjtë, ku demi i përgjigjej magjishëm si një instrument muzike.

Çdo lëvizje e tyre e sinkronizuar përsosmërisht ~~shqerohej me "ole" të fuqishme nga i gjithë amfiteatri~~.

Ankthi u shkëput nga trupit i saj, fluturoi mbi shpinë të ~~demit, e kalëroi dhe zuri ta shponte si i tjeruar me mamuzet e tij grë~~.

**Vallja e shenjtë u prish.** Demi turfullonte si i marrë duke nxjerë shkëndia nga sytë.

Turma këthiste:

- Vrite! Vrite... Çamako!

Çamako i preu hovin demit dhe që të dy qëndruan ballë për ballë. Çamako u ngrit në majë të gishtërinjve me elegancë dhe piketoj me majën e shpatës zverkun e përkulur të kafshës.

Atëherë ankthi iu qep syve të saj dhe i ndërtoi në retinë një pamje të gjenjeshtërt, të cilën ajo e pikasi menjëherë që ish vepër e tij; andaj dhe nuk u tremb: demi po sulmonte toreadorin me dy shpata në vend të brirëve, ndonëse shpatën e toreadorit e kish të rrasur deri te milli në zverk. Ia nguli të dy brirët-shpata në trup djaloshit dhe e vërviti dhjetë pashë lart.

Çamako ende s'po kthehej në tokë -- sytë e saj e panë tek zhdonë të ngjitej e të ngjitej...

Britma ngazëllyeze e turmës shungullonte në amfiteatrin e vjetër.

Dhe ajo vazhdonte të ishte e qetë: u besonte veshëve dhe jo syve.

Befas, britma e njerëzve ngriu pezull mbi shesh.

Me sy të zhveshur ajo pa demin që po jepte shpirt në arenë, me shpatë të rrasur deri te milli në zverk, me flegrat dhe sytë në gjak, dhe pranë tij, toreadorin të shtrirë pa frymë.

## Gjethja

(Intermezzo)

Atje sipër, asaj i shkoi një drithmë e lehtë në trup. Pastaj, një si ngërçi pakuptueshëm e mbërtheu dhe e zuri t'ia ftohte damarët e t'ia bënte dru. Mbajti frymën dhe ndjeu se si gjaku po i firoste dhe në vend të tij, një jolëndë e akullt po imbushte trupin. Zu të mblidhej e të krusullohej për të mbajtur të ngërthyer atë grimëz frymë që i kish mbetur, por atë çast, molekulat e fundit të jetës iu bënë eterike dhe ajo e ndjeu veten të papeshë. Mbylli sytë dhe u lëshua në hiç.

Atje poshtë, gjethëza e tharë dhe e rrëgjuar ishtë bërë një me pluhurin e udhës. Në pluhur nisi të zvarritej e të bënte tutje me një kërr-kërr të neveritshëm. Sa e mundonte e papesha! Zemërtharë, ngriti sytë drejt qiellit për të llomotitur dreqi e di ç'lutje, kur sytë e mykur i panë atje sipër, pranë qiellit, gjethet e tjera që, të gjelbërtë, fëshfërinin në erë. "O perëndi!" kërkëlliti me tmerr, "si vallë paska jetë, kur unë kam vdekur?". Në trurin pa gjak nisi të rregëtinte hakmarrja. Një hakmarrje me erë. "Era" - përshpëritën buzët e vyshkura, "era s'të gjakos, nuk bën plagë, s'lë shenja: era të vret".

Kërr-kërr i neveritshëm zuri të bënte tutje nëpër pluhur. U zvarrit e u zvarrit, gjersa më në fund e gjeti erën të varur në një degë peme. Gjuha rrufake zuri ta yshtëte kërc- kërc- kërc.

Era e vjeshtës i thau dhe i rrëzoi gjethet e pemëve. Në atë kasaphanë verdhësie, gjethja kriminele gëzohej si e marrë. Zvarrazi vinte rrrotull, kontrollonte, prekte, sigurohej. E papesha, e papesha i interesonte. Kërr-kërr i ishte kthyer në fësh-fësh. Një fësh-fësh i trallisur, i dehur nga gjaku i verdhë endej e endej si mortje.

Një pishëz sygjelbër, e re dhe e bukur nuk donte t'ia dinte për vjeshtën. Rrfiste nga toka gjak të gjelbër dhe rinohej. Atje thellë në tokë qe Sekreti i Jetës që rrënjet e saj e pinin me èndje pa pushim...

Gjethëza iu avit avash. Pa nën këmbët e saj erën e vjeshtës, të drobitur e të vrarë dhe mendoi e helmuar për Sekretin e Jetës. Nuk bënte dot gjë, ai ishte kaq i paarritshëm, kaq i pakapshëm...

Një kalimtar e shkeli me këmbë. Ajo u shkërmiq e u copëtua në mijëra çika zili zverdhake, që s'ia ndanin mijëra sytë pishëzës së gjelbër - Pemës së Jetës.

## Gërshërët

Me siguri që s'kisha përtat trazuar atë ngjarje në kujtesën time, sikur atë pasdite me shi të mos kisha parë në lulishtë një palë gërshërë të mëdha kopshtari, pranë një dege të thyer trëndafili.

Nga kalimii i viteve, i shumë viteve ngjarja kishte zënë vend mirë e qe fiksuar fort në ndonjë skutë të kujtesës dhe as pamja e gërshërëve e as ajo e trëndafilave, qoftë edhe të thyer, veç e veç, s'kishin mundur dot ta çvarrosnin.

Por tani që të dy pamjet u bashkuan, mundën ta nxirrin ngadalë nga llumi i kujtesës ku pat ngecur dhe po ma ndërtonin sërisht të freskët e besnikë ngjarjen, por ama të parë me syrin e një fëmije tetëvjeçar.

Ai na qe bërë si hije. Sa herë që e shihja, i shtrëngoj fort dorën mamasë, që porsa e merrte sinjalin, hidhët sytë ahdejkëtej me marifet, e pikaste dhe atëherë krenaria e saj e lindur shpalosej e bëhej me flatra.

Kjo qe arma jonë e vetme për t'i treguar Atij vendin: krenaria e shpalosur.

Mamaja çonte kokën lart, ia qepte sytë e saj të kaltër qiellit të horizontit, që s'hahej dot në kaltërsi me sytë e saj, tendoste dekoltenë e saj të mrekullueshme, ndërsa kindave të fundit u jepte një frufru magjike, e cila e çonte në djall krenarinë e saj.

Unë mezi e prisja atë çast; megjithëse merrja pjesë e devotshme në ritin e krenarisë, me sytë në horizont e trupin të tendosur, rrija dhe e sodisja e mrekulluar mamanë time, që më dukej se e jepte enkas përmua atë spektakël bukurie.

Nuk flisnim kurrë përtë, madje asnjëherë nuk e zumë në gojë, as në atë kohë dhe as kurrë ndonjëherë. Marrëveshja jonë qe e heshtur. Kur e shihja unë e para, i shtrëngoj

dorën, kur e shihte ajo, e jepte sinjalin si të mundte, por asnjëherë me fjalë.

Një ditë, tek po ecnim të dyja të shkujdesura, të zëna përdore si gjithmonë, dëgjova fare pranë veshit një zë të murrëtyer e të rreptë, por fare të qartë:

- I plaçin sytë! I plaçin!

Ktheva kokën dhe pashë një plakë kërbunjase, e cila ndodhej midis mesh dhe Atij që s'ia ndante sytë sime mëje. U tremba dhe ia shtrëngova fort dorën mamasë, që dukej sikur s'kish parë e dëgjuar gjë. Ktheva kokën sërish pas një çasti, por plaka qe zhdukur. Zëri i Fatit vazhdoi të më tingëllinte për vite të tëra në vesh.

Shtëpia e zonjës Eftiqi, ku ne shkonim gati dy herë në javë, ndodhej në një rrugicë të qetë, e cila qe e vetmuar dhe si e ndarë nga bota, megjithëse niste menjëherë pas kangiellave të parkut kryesor të qytetit.

Ishte shtëpi njëkatëshe, e hijesuar nga pemët që kish rrotulli, aq sa dukej, kur hyje tek porta ditëve të nxehtha të verës dhe shkelje nëpër rrugicën që të shpinte në hajat, se tërë ajo rethinë, me shtëpi e me kopsht, qe prerë e marrë nga një pyll. Prapa shtëpisë ndodhej edhe një bahçe e mbjellë me trëndafila kërcellgjatë, të cilët arrinin deri te dritaret e dhomave. Pranë njërsës nga ato dritare, në një fron të vogël, qe vendi im i preferuar. Ulesha aty sa herë që mamaja bënte provën e rrobave të cilatia qepë zonja Eftiqi, në paradhomën e dhomës ku rrija unë, përpara një pasqyre të madhe sa një bojë njeriu. Hidhja pakëz sytë nga prova e rrobave, sepse mamaja më thërriste hera-herës për të më pyetur në i rrin mirë dhe pastaj kridhesha e tëra në soditjen e një porte kishe ngjyrë bari, e vetmja gjë që dallohej nga dritarja përmes trëndafilave dhe derikës së bahçes.

Aty pashë, për herë të parë, nga afër edhe sytë e tij, aty në bahçe, pranë dritares së hapur, fshehur mes trëndafilave që muzgu i kish bërë më të rëndë e më të ngarkuar me

aromë.

Ishin dy sy tē ngulët, por tmerrësisht tē butë e lutës, aq sa nga tromaksja e parë, një nga ato tromaksjet e forta që s'të lënë tē bësh as gëk as mëk, kalova në bashkëfajni; po po në bashkëfajni - e lejova tē shihte mamanë time tek bënte e ngazëller provën e fustanit përpara pasqyrës së madhe, duke i thënë rrobaqepëses t'ia bënte dekoltenë ca më tē dukshme, mëngët ca më tē ngrëna nën sqetull... Tek zhvishej e vishej, tek ngrinte flokët lart, se mbasë i shkonin ashtu më tepër .

Kjo soditje e përbashkët dhe kjo bashkëfajni, vazhduan kohë tē tëra, deri mbrëmjen kur ne shkuam te zonja Eftiqi për tē marrë rrobat e qepura tē verës.

Unë mezi prisja tē ulesha te qoshja ime e dritares, frymëmbajtur nga kureshtja, përtë parë nëse do të shfaqeshin sërisht sytë në bahçen e trëndafilave.

Për çudi i gjeta aty mes trëndafilave, duke pritur në ankth. Përcateshin nga ethja e dashurisë.

Ndërsa tē dyja gratë, gjithnjë përpara pasqyrës, provonin edhe njëherë rrobat e përfunduara, unë u bëra gati t'u flisja syve. Ende nuk i kisha gatitur fjalët: doja vetëm ta paralajmëroja se ky qe takimi ynë i fundit...

Përpjekja për t'a prishur atë lidhje tē heshtur e magjike, më kushtoi shtrenjtë-- padashur e kisha tradhtuar.

Nga një fatalitet i tmerrshëm, e nga një lojë e mallkuar pasqyre, zonja Eftiqi deri atë çast me shpinë nga ne, e urta dhe e buta zonja Eftiqi, u kthyre rrëmbimthi më fytyrë tē prishur, e përshkoi largësinë pasqyrë-dritare sa hap e mbyll sytë me gëershëret e mëdha në duar, shtriu krahun përpara dhe qëlloi vetëtimthi.

M'u morrr fryma dhe mbylla sytë fort.

Dëgjova një kërcitje tē thatë dhe asgjë tjetër.

Kur hapa sytë sërisht, pashë vetëm një degë trëndafili tē thyer dhe zonjën Eftiqi që, e verdhë si meit, fshinte si pa mëndje pas përparëses gëershëret e gjakosura.

Atë nuk e pashë më kurrë. As zonjën Eftiqi.

Kishin kaluar njëzet e ca vjet që nga ajo kohë, kur më zuri syri në lulishte degën e thyer të trëndafilit dhe gërshërët e mëdha të kopshtarit pranë e pranë. Kisha shumë kohë që jetoja në një qytet tjetër dhe kisha pak a shumë moshën që kish pasur Ai dikur.

Ndieuja nevojën e ngutshme të takoja zonjën Eftiqi; nuk dija në ish gjallë apo kish vdekur.

I rashë çokut të derës së shtëpisë që ndodhej në rrugicën e qetë e të vetmuar si të ndarë nga bota: tri herë çokut të derës dhe tri trokitje të tjera me unazë - ashtu si bënte mamaja ime dikur.

U dha në derë vetë zonja Eftiqi, e kërbunjur nga pesha e viteve dhe e të fshehtës që mbante mbi shpinë; vetëm topuzi i flokëve ishte po ai, si gjithmonë.

-Jam ... - nisa të prezantohesha unë

- Eja, - më tërhoqi ajo pas vetes nëpër hajatin e hijezuar. Ashtu si e gjithë shtëpia.

Kur hyra brenda, sytë më shkuan te stoli i vogël bri dritäres që priste aty prej...

- Sot u mbushën njëzet e tre vjet që nga ajo ditë, - foli me zë të dridhur zonja Eftiqi.

Nuk mund ta besoja. Çfarë rastësie e kish bërë atë grua të besonte se mua s'ma kish marrë me vete fëmijëria atë ngjarje? Çfarë rastësie më kish sjellë aty pikërisht atë ditë?

Zonja Eftiqi m'u duk e veshur me një autoritet të jashtëzakonshëm. M'u duk sikur ajo vetë i lëvizte fijet e Fatit, se ajo e pat mbajtur aty gjithçka të pandryshuar madje edhe aromën e trëndafilave që vërvshonte gufla-gufla nga dritarja; ajo vetë e kish vënë në lulishte edhe degën e thyer të trëndafilit, edhe gërshërët e mëdha; ajo më kish sjellë mua gjer aty për të më bërë rrëfimin e saj që të çliriohej...

-Ai më qe bërë makth, - e nisi ajo, ndërsa unë mundohesha të bëja udhi me veshët e mi që s'po donin të besonin.

- Më shfaqej në derë çdo ditë si fantazmë dhe fillonte kontrollin. I nxirrte shtëpisë fundin.

Ndjeva se më ishin zgurdulluar sytë.

- Eh! Asokohe kontrolloheshin të gjithë ata që bënин punë private dhe gjobiteshin rëndë, - nxitoi të më sqaronte ajo. - Po unë doja të ushqeqja vajzën dhe veten, im shoq kish rënë në burg. Ai qe djalli vetë. Ish bërë tmerri i rrobaqepësve privatë, dhe për të zezen time, mua më ishte qepur si askujt tjetër. Më vinte pas edhe kur shkoja te ndonjë kliente për t'i bërë provën. Cohat që më sillnin i fshihja në tavan, por edhe aty m'i gjente lugati. Madje, njëherë, m'u duk si i roitur, zbuloi dy fustanë pothuaj të përfunduar të mamasë tënde dhe pasi i nuhati për disa sekonda m'i sekuestroi. E gjora unë; mblohdha kursimet që kisha dhe ia zëvendësova fustanet. Por atë mbrëmje... - zëri i qe trashur si paluze dhe i mbante era tym. Fjalët i thoshte gjysma shqip dhe gjysma greqisht. Zonja Eftiqi po përcartej... - atë mbrëmje, kisha vënë re edhe përparrë gjurmë në bahçen e trëndafilave, në pasqyrë pashë të shkruar dëshirën e tij. Ai donte ... donte të më rrëmbente, veç fustaneve, edhe mamanë tënde që unë e adhuroja.

U çova si me sustë nga frika dhe bëra të dilja. Fjalët e përcatura të zonjës Eftiqi më ndoqën pas:

- E humbi njërin sy, por mua s'më denoncoi...

Këmbët më çuan nga bahçja e trëndafilave. Mezi e tërhoqa derikën e kalbur të bahçes dhe dola në rruginën përballë derës së ngallmuar të kishës.

## Këpucët me takatë larta

Riti niste që kur ajo çohej nga shtrati në mëngjes; në një pasqyrë të rrumbullakët me një kornizë druri të ngjeshur, të errët është me ca gdhëndje bisqesh e degësh kapriçioze, të trashëguar nga gjyshja, nëna e nënës, ajo fillonte të këqyrte fytyrën. Çdo ditë arrinte të pikaste aty ndryshime, vogëlsira, të cilat s'kish mundurt i shihte dot më parë; e kishte mprehur syrin në atë shkallë të parrëfyer, sa që ai mund të kapte jo vetëm ato vijëzimet e tejholla tradhtare që thelloheshin përditë në lëkurë, duke hedhur në erë qelizat e çmuara të epidermës së bukurisë, por edhe vetë bisturinë e kohës që, maramendëse, vizatonte aty teket e saj me dhembje, po, po, me dhembje, sepse ajo kish mundur të dallonte edhe diçka tjetër të kobshme; vijëzimet tradhtare kishin çuditërisht format e rrudhave të fytyrës së portretit që ndodhej i varur fatalisht mbi pasqyrën e gdhendur. Ishin rrudha të pazakonta, jo njerëzore, sikur të qenë bërë rastësisht nga një lojë peneli e piktorit të vjetër.

Një mëngjes, ajo nuk i dallonte dot mëngjeset nga njëritjetri, pikasi në fytyrë një gjurmëzë vije horizontale në faqen e majtë; kësaj i tmerrohej më tepër -- rrudhës horizontale të llahtarshme të portretit mbi pasqyrë. Si ishte e mundur? Me siguri drita dhe hija bënин punën e tyre: ajo iu lut e përgjëruar hijes, që vërtet i falii një çast paqeje - nuk e pa më gjurmëzën e vijës së llahtarshme horizontale.

Por pas një ore, mbrojtja e hijes s'mund të zgjasë më tepër, ajo e pa atë përsëri dhe, jo vëtëm kaq; pa shkoqurazi bisturinë e kaltëruar të kohës që punonte shpejtazi nën zhurmën e pagabueshme të një palë takave me fund

metalik, që jehonin dikur në fondin e pasqyrës e që dukeshin sikur përpinqeshin të trembnin bisturinë e kaltëruar.

Që nga ai çast, çdo vijëzim që hapej në lëkurë, do të shoqërohej nga tringëllimi i takave me fund metalik në sfondin e pasqyrës dhe do të bëhej përsosmërisht sipas një vizatimi të përcaktuar, besnik i një kodi të mallkuar gjenetik.

Në shtëpinë e së ëmës, në dollapin e këpucëve, ajo zuri të rrëmonte ethshëm. Kish te gjithëfarë lloj këpucësh: me majë të hollë, me majë katrore, të rrumbullakët, me lëkurë, me kastor, pa taka, me pak takë, me takë ortopedike, me ngjyra të ndryshme, të reja e të deformuara nga koha, me pluhur e të reja fringo, por kurkund nuk i pa këpucët me taka të larta metalike - ato duhet të qenë patjetër me taka të larta, se ndryshtë tingëllimi i tyre, që i vinte parreshtur që nga pasqyra në vesh, s'do të qe i thekshëm si një lloj yshtjeje.

E ëma që rrufiste e qetë kafenë në një cep të divanit, e shihte e çuditur tek bënte atë lloj kontrolli të pakuptimitë. Pastaj, si të qe kujtuar për diçka, e pyeti:

- Mos kërkon gjë këpucët me taka metalike? Keni ndonjë mbrëmje? Mos i kërko kot, kanë kohë që s'janë më aty!

Ajo u kthye, dhe pa ia vënë veshin fjalëve të saj, zuri t'i këqyrte fytyrën sikur të mos ia kish parë ndonjëherë; syri i saj i pagabuar pa sërisht rrudhat identike të portretit në pasqyrë, vijën horizontale në faqen e majtë që e tmerronte më tepër se gjithçka, megjithëse kësaj here dukej se peneli i piktorit të vjetër qe squllur dhe dora e tij me siguri qe dridhur: rrudhat qenë shumë më të lehta dhe më njerëzore.

Doli në rrugë; u drejtua nga pazari i vjetër. Gumëzhima njerëzore dëgjohej që shumë larg; ajo e mbështollti të gjithën. Mendjemarruar nga zallahia që bënин blerësit dhe shitësit, ajo përpinqej të gjente mallin që dëshironte, që e kërkonte pa shpresë. I merreshin mend; të thirurat, valëvitja

e tërë atyre plaçkave të varura në erë, aroma e qofteve, e mëlçive, e peshkut të skuqur, qarjet e fëmijëve që u kërkonin prindërve kapriço, i krijoi një ngërç në stomak dhe asaj iu përzie.

Bëri të dilte nga ajo rrëmujë e ethshme, kur syri i zuri një shitës plak me një tezgë këpucësh përpara vetes. Askush s'i afrohej plakut; veshja e tij lëfetra-lëfetra dhe kutërbimi i mallit të vjetër e të pluhurosur, i mbante njerëzit larg. Ajo i pa këpucët që përtej; i dalloj mes vjetërsirave dhe u avit. Plaku e vështroi me sy të picërruar nga pleqëria pa u çuditur dhe i dha në dorë këpucët e zeza gjysmë lëkurë illustrafinë dhe gjysmë kamosh, me takat e larta me fund metalik. Ajo i zgjati paratë dhe mori rrugën e kthimit; s'kish bërë as tri hapa, kur u kujtua; ktheu kokën t'i fliste plakut, por nuk ia zuri syri më.

Zhurma e takave me fund metalik qe bërë më e fortë në fushën e pasqyrës, ndërsa vij zimet që hapeshin në lëkurë, shumë më dembele dhe të ngathhta. Asaj kjo iu duk si fitore dhe mori zemër, megjithëse tani nuk dinte ç'të bënte me këpucët me takat e larta. Befas u kujtua;

Ia vuri përpara të ëmës që, si gjithmonë në atë orë, rrufiste kafenë në një cep të divanit, dhe e ftoi të dilnin; e ëma lëvizi trupin e rënduar nga mosha dhe u ngrit; ajo kish shumë, shumë kohë që nuk kish veshur këpucë me takat e larta. Por nuk kuptoi asgjë; nuk kuptoi se kishte përpara këmbëve pikërisht këpucët e mbrëmjeve valluese të rinise së saj të shkuar... madje as trupi i saj nuk mori vesh gjë. Ajo i veshi lehtazi dhe me qejf, ndërsa trupi i saj qëndroi i drejtë lastar zhdërvjellazi në majë të takave të larta; koka iu ngrit lart vetiu dhe flokët e gjatë gështenjë iu derdhën supeve, ndërsa **sytë e kaltër i vezulluan** në një ballë të lëmuar e të bardhë si mermer. Ajo e shihte e mrekulluar të ëmën; në pasqyrën e madhe, vështronin njëra-tjëtrën, ndërkohë që ajo kapte flokët dybishtaleca... Kish ndodhur çudia.

Në mëngjes, si gjithmonë, ajo nisi ritin e përditshëm të pasqyrës: nuk kish mundur të kuptonte se si kishin rrjedhur tërë ato vite; në hënën e plotë të pasqyrës, ajo pa një fytyrë identike me atë të portretit të varur fatalisht mbi pasqyrën e gdhendur dhe besoi se, me siguri, s'qe e saj.

## Nobelisti

*Deri ku shkon lidhja e një shkrimtari kozmik  
me lexuesin e tij?*

*A vjen ai vallë si një pushtues shpirtrash  
dhe trupash muzgjeve aluçinantë?*

*A ka rëndësi jetë-vdekja e tij, apo mos vallë  
mon si parfumet e moçmë gjithëjetëshe?*

U njoħeri nē një qytet tē lashtë e tē gurtë legjendash, shumë larg vendeve tē tyre, nē një shtëpi babelike, një vjeshtë që dukej sikur qe krijuar enkas pér t'i njoħur.

Me grykésinё e njoħjes sē parë, ajo filloġi tē zbulonte e tē studionte ġjithċka tek ai: qē nga jeta e përditħħme, častet e fikuara, lëvijet e zakonshme, ato qē përsériteshin dhe dha ato qē shfaqeshin vetäm një herë, deri te jeta e tij e vjetër, ajo qē kishte rrjedħur tashmē. Ndérkohë, ai nuk lodhej me zbulime, ai e kish lënë veten nē dorën e saj; e kishte lejuar ta studionte nē paqe.

Ditêt rroðhën shpejt, qëndrimi i tyre nē qytetin e lashtë dhe tē gurtë mbaroi dhe kur rruga e Katedrales u sħtrua me një gjethnaję zverdhake qē sħtyhej sa andej-këtej e lodħur dhe e përgjumur, u largua.

Ajo u kħye nē vilēn e saj buzë detit nē vendin e vogë, ndërsa ai nē kryeqytetin e tē madh tē Europës.

Ajo zuri t'i mbushte muret e dhomave me fotografitë e tij; nē bibliotekën e madhe me dru arre, spostoi disa libra tē vjetër dhe vuri nē raftet e para librat e tij. Nē një qoshk tē saj vendosi edhe çelësin e vogël tē argjendtë tē derës sē pasme tē vilës, tē cilin e kish gjetur, para shumë kohësh nē peshtafin e arturinave qē i kish falur gjysħja. Plaka

tetëdhjetëveçare ishte shkulur gazit, kur e mbesa kish nxjerrë çelésin nga një shami e bardhë mëndafshi e zverdhur nga koha, që kundërmonte era parfum të mocëm dhe, mes kukurizmave që i shkulnin një kollë të thatë nga kraharoni, i pat thënë: "Ruaje mirë çelésin, bija ime, se është i vyer; t'i sjell në derë adhuruesit, si me magji".

Ajo vazhdonte t'i përndiqte të gjitha shkrimet e tij nëpër gazeta e revista dhe mes miqve filloj ta përmendte "Nobelisti im", megjithëse të gjithë e dinin që ai nuk e kish marrë çmimin Nobel. Edhe ajo e dinte, por qe e bindur se kish për ta marrë së shpejti. Kur ua thoshte këtë me këmbëngulje miqve të saj pasditeve erëmira në kopshtin e vilës buzë detit, ata shihnin njëri-tjetrin në sy dhe buzëqeshnin dhemshurisht si për t'i thënë: "Natyrisht që do ta marrë, por qetësohu tanj".

Një mëngjes, kishin kaluar muaj që kur ajo e pat njojur "Nobeliston e saj", mori një letër, mes asaj morie letrash që i vinin nga miqtë e përtejdetit, të cilët mundoheshin t'ia dërgonin të gjitha shkrimet apo librat e tij.

Në zarf gjeti një fletë me figurën e fotokopjuar të një varri me pllakë të bardhë mermeri të ndarë në dy pjesë, ku pjesa e parë, mbi të cilën dodhej aureola e një luleje me sy njeriu, mbante një emër gruaje, ndërsa pjesa e dytë emrin e tij.

Në fund të fletës shkruhej:

"Në qimiterin e Montparnasisit, rrethuar nga varre të zinj, të cilët duken sikur janë ngulur në tokë me kryqe të trishtë, që askush të mos ngrihet deri në një urdhër të dytë, ndodhet varri i bardhë i ...

Asaj iu errën sytë dhe humbi ndjenjat. Kur erdhi në vete dielli e kish kaluar zenitin dhe kish marrë udhën e detit.

Shakaja e përgjakshme që vinte nga larg, i kish lënë në gojë një shije të keqe, ndërsa trurin ia kish bërë esëll. Vërtet, ajo s'dinte asgjë për jetën e tij intime. Mbësë këtë donin t'i rrëfenin me letrën e mëngjesit. Ai emër gruaje në pllakën e bardhë të varrit ndoshta ishte e shoqja, mikesha a e dashura

e tij... Mbase ia kish dërguar vetë ajo në një krizë xhelozie të pakuptimtë.

Po atë ditë ogurzezë u zhduk papritur edhe çelësii i vogël i argjendtë i portës së pasme të vilës.

E trondit, tërë ankthir e mbledhur atyre orëve, ajo ia kushtoi kërkimit të çelësit të vogël të argjendtë. Nuk e gjeti gjëkundi. E ktheu përmbyss bibliotekën e vjetër druarre. Asgjë. Trupi i digjej nga éthet dhe parandjenjat. U kujtua dhe hapi peshtafin e arturinave të gjyshes. Shamia e mëndafshë e bardhë ndodhej aty dhe aroma e perfumit të moçë doli gulfa-gulfa nga kutia.

Sa murd të jetonte një parfum? Dhjetra, qindra vjet? Kur vdiste një parfum?

Mbledhur në shami, në vend të çelësit, ajo gjeti një shishkë të vogël kristali barkrrumbullakët, me bulëza qelqi në sipërfaqe. Tapëza e saj bojari kish ngrirë në rrathët e kristaltë e dukej sikur do të bëhej copë përpara se të hapej. Ajo vuri re se alkooli i perfumit të moçëm qe avulluar me kohë dhe esenca e tij ngjyrëvjollcë ishte qepur fort pas faqeve të kristalta; që andej kish dhjetra vjet që shpërndante me këmbëngulje në ajër molekulat eterike të aromës së saj vjollcë. Filozofia e jetës së pasvdekjes të parfumeve të moçëm iu fut vajzës thellë në mushkëri, i kaloi në gjak dhe i gufoi zemrën.

Ngadalë hapi derën e dhomës së gjyshes. Vetëm ato të dyja, gjyshe e mbesë, jetonin në vilën e vogël.

Plaka nëntëdhjetëvjeçare kish kohë që derdhej në kufirin e fundjetës dhe koha e saj rridhte vetëm nëpër një éndërr-zhgjëndërr dhe zhgjëndërr-éndërr, që përsëritej pafund. Sytë e veckël bojë deti mes rrudhave të thella të ballit ishin përherë gjysmë të myllur, me një dritëz të kaltëruar që rrinte gjithmonë ndezur, si fener në errësirën e vdekjes që po afrohej.

Ajo i foli. Kërkonte të dinte për çelësin e humbur. Plaka në fillim nuk u ndie, pastaj i dha më shumë dritë fenerit të

syve, formoi një dritare mes rrudhave të thella të fytyrës dhe pëshpëriti ultaz: "Është magjik, mos u tremb se nuk humbet kumë!"

Pastaj, sikur ta kish zënë një krizë e beftë gazi, ia plasi një kukurizme të mbytur, që ia shkundi tërë atë mal mishi të plakur dhe e la pa frysë çaste të tëra.

Ajo tërroqi derën e dhomës ngadalë dhe u zhyt në ankthi e saj.

Muzgu detar po rrokullisej shpejtazi nëpër rërën e plazhit drejt vilës së vogël, kur nga tringëllima e mbytur e zilkës së varur në portën e pasme, ajo kupto se dikush kish hyrë brenda.

Nuk ndihej asnjë zhurmë; vetëm frysëmarrja e thellë blu e detit prishte qetësinë absolute që mbretëronte atij muzgu.

Në hajat u dëgjuan hapa që afroheshin. Gjysmë shtrirë në divanin pranë dritares, embushur me një gëzim të pafund e të pakuptueshëm, ajo u zhyt në një ekstazë avujsh rozmarine që i qenë grumbulluar në kokë gjatë banjës që pat bërë me ujin e lules, para një gjysmë ore, për t'u çliruar nga ankthi i celësit të humbur.

Ai u shfaq në derën e dhomës: i gjatë, tepër i gjatë dhe i mbuluar në muzg.

- Juli, - i thirri ajo me pëshpërimë, por s'doli dot nga ekstaza e rozmarinës dhe s'aritti dot të ngrihej.

Ai u përkul mbi të dhe ajo shqoi në gjysmëerrësirë sytë e tij të larguar nga njëri-tjetri, që e vështronin me dhemshuri.

Ajo u mundua edhe njëherë të dilte nga ekstaza e rozmarinës, por s'aritti dot. Ndërkohë ai qe përkulur edhe më mbi të, aq sa qe shkrirë në trupin e saj. Ekstaza e rozmarinës ishte bërë më e dendur.

Dashuria e tyre qe e lehtë dhe e avashtë, me një akord të përkryer që përsëritezë përsëritezë deri ndaj të gdhirë, kur ai largohej, por pa i arritur dot majat e lavdisë.

Çdo muzg, pasi bënte banjën e luleve dhe zhytej në ekstazë rozmarine, gjysmështrirë në divanin pranë dritares në vilën e vogël buzë detit, ajo priste burrin, që hynte pa zhurmë nga dera e pësme e vilës dhe përkulej e përkulej mbi të, duke e vështruar dhemshurisht me sytë e tij të larguar, deri sa shkrihej në trupin e saj dhe akordi i përkryer përsëritez çdo herë, pa i arritur majat e lavdissë.

Në krahët e njëri-tjetrit pritën viteve 89, 90, 91, vendimet e Jurisë së Nobelit, të bindur se çmimi i madh do të mbërrinte ndonjë muzg deri aty në vilën e vogël buzë detit.

Një ndajnatë, u arratisën nga vila e buzëdetit, qe hera e parë dhe e fundit, dhe fluturuan shumë larg, përtej detit, për në studion e tij. Ajo qe shumë kureshtare të shihte vendin ku ai punonte.

Kur arritën përpara ndërtesës dhe u futën te dera kryesore, përpara iu doli një mori e pafundme shkallësh me forma nga më të ndryshmet dhe të vendosura në pozicione nga më të habitshmet: horizontale, vertikale, të varura pezull, të ngritura në kënde të ndryshme, të shkurtëra, të gjata, kërmilllore. Asaj iu morën mendtë kur pa njerëz që i ngjisin dhe i zbrisnin ato lehtësisht, në një hapësirë të tyren krejt të veçantë dhe të pavarur nga ato të shkallëve të tjera. Iu duk e pamundur t'i ngjiste shkallët për të shkuar diku...

Ai e mori atëherë përdore dhe filloj t'i mësonte se si t'i hidhte këmbët, si të mbante kokën, trupin... Dhe ajo u ngjit.

Kishin nisur sërisht pritjet në muzgjet detare të vilës së vogël, kur ajo gaboi një ditë dhe nuk e bëri banjën e luleve dhe nuk u zhyt në ekstazën e rozmarinave.

Ai erdhë sërisht atë muzg të ftohtë shkurti dhe porta e pasme që tringëlloi mbyturazi zilkën dhe hapat në hajat u dëgjuan prapë. Por kur ajo priti që ai të përkulej mbi të dhe të shkrihej në trupin e saj, vuri re, në errësinë-dritën e pranë dritares, trupin e tij të gjatë vezullues që filloj të harkohej prapa ngadalë-ngadalë, deri sa u vidhis pa zhurmë në dysheme. Ajo e kuptoi se, që nga ai çast, nuk do të kishte

më muzgje detare në vilën e vogël.

E tërroqi me kujdes trupin me gjymtyrët e gjata të lehta pendë dhe u nis në drejtim të detit. Gropat që hapat e saj linin mbi rërë, mbusheshin menjëherë me errësirë të kaltëruar. Në breg u ndal, e rregulloi paralel me vijën e valëve dhe nisi ta shtynte ngadalë drejt tyre. S'e kish menduar se deti do ta thithte me aq lakmi. Asaj iu bë se brenda disa çastesh trupi i tij u shkri dhe humbi në ujin e kripur, ndërsa në bregun që kish mbuluar nata, u përplas lehtazi një valëz me një gjerdan të hollë shkume.

Mëngjesi ogurzi është gjeti në breg të detit, me gjunjë të zhytur në rërën e ftohtë dhe me fytyrë të larë nga lotët.

U kthye e dërrmuar në vilë dhe, kur në qoshen e bibliotekës së vjetërdruarre gjeti çelësin e yogël të argjendtë, vendosi të hapte letrën e përtëjdetit që i kish ardhur prej shumë kohësh. Brenda, gjeti një fotografi-kartolinë me një varr plakëbardhë që mbante dy emra:

*Carol Dunlop 1948 - 1982*

*Julio Cortazar 1914 - 1984*

## E vdekura

*Zakonisht vdekja  
është vetëm një fëmijë  
fytyrë trishtuar  
që del nga nata  
pa qëllim  
pa frikë  
një fëmijë i gjorë plak  
që e lëshon dorën  
mbi zemrën time.*

*M. Benedeti*

Dikush, nuk munda ta mbaja mend as se kush dhe as në çfarë momenti të saktë të ditës, më tha se Ajo qe kthyer. Në morinë e madhe të punëve, dita qe vërtetë e rrëmujshme, nuk di pse nuk e kisha përfillur atë njoftim.

Afër darkës, kur e lodhur sa s'thuhet, u shtriva me kokë të boshatisur nga mendimet, një shkëndijë e beftë më ndriçoi kujtesën: Ajo qe kthyer, "Ta marrë djalli" thirra me zë të lartë, "qysh qe kthyer? A ktheheshin njerëzit nga vdekja?". Mirëpo qe e kotë të protestoja e të mos e besoja atë histori - dikush ma kish thënë, më kish njoftuar për këtë, pra ishte fakt kthimi i saj. "Si fakt?" thashë sërisht me vete, "fakt se ma kish thënë dikush, i cili as që më kujtohej se kush qe. Po prova?" vazhdova të flisja me vete. Më pas, kujtesa shtonte: jetonte krejt e vetmuar dhe e mbyllur në shtëpinë e saj të dikurshme dhe e vetmja lidhje që mbante me botën ishte

telefoni... Por mua, mua si nuk më kish marrë në telefon? S'ma dinte vallë numrin e ri? Apo më mbante mëri qysh atëhere... Brofa në këmbë dhe u gjenda me çantën e dorës së hapur duke rrëmuar nëpër xhepat e dhe kuletat e saj. Asgjë. Kisha frikë se mos kujtesa po m'i trillonte të gjitha këto njëra pas tjetrës dhe u revoltova kundër vetes, ndërkaq dora po hapte zinxhirin e një xhepi, që ndodhej krejt i fshehur në pjesën e poshtme të çantës. Që andej doli me një copëz letre të verdhë ku qe shënuar qartë një numër telefonit. E ndje va me të tërë trupin, që m'u dridhërua, se qe i saji.

Kur e mblodha veten, bëra ta formoj atë numër telefonit dhe vetëm në çastin kur i kisha rënë numrit të parë, pikasa që ishte me një shifër më tepër se numrat e zakonshëm.

Prefiksi i botës tjetër - li  
ygjéronte truri im që s'më bindej më.

Prita një sekondë dhe, për çudinë time, zilja u formua e plotë dhe e rregullt në anën tjetër, që me siguri s'kish për t'u përgjigjur kurrë njeri. Zilja vazhdonte të binte dhe unë prisja, pa priturgjë. Zilja këmbëngulte të zgjonte dikë nga përgjumja, që u zgjua mundimshëm dhe foli...

Ishte zëri i saj, o perëndi! Ishte zëri i saj që unë e kisha harruar krejt pas atyre 20 vjetëve mungesë të gjatë. Pata frikë se mos më ndalej zemra dhe e mylla me frikë telefonin. Më ishte krijuar përshtypja se e fliste me zor shqipen, si një njeri që ka vite pa folur.

Ç'gjuhë flasin të vdekurit? Ç'gjuhë flasin të vdekurit?  
Ç'gjuhë flasin...

Më kishin kapur ethet.

Tri ditë e tri net nuk dola dot nga kllapia.

Ditën e katërt, si të mos kish bërë gjë vaki, shpejtova të kaloja nga shtëpia e saj që ndodhej në një rrugicë qorre, mes një morie rrugicash, në anën tjetër të qytetit. Nuk dija kush jetonte tanë atë shtëpi, pasi prindërit e saj kishin vite që kishin vdekur. Shtëpia nuk kishte ndryshuar shumë. Vetëm gardhi që e rrethonte ngjante i ri e i fortë nën atë bimësi të

**limaksur shkurresh që gati sa s'e hidhte përtokë me peshën e saj.**

U ngula përballë shtëpisë në një largësi jo të madhe dhe prita. Orët kalonin dhe porta e saj qëndronte e vulosur si porta e ndonjë kripte. Frymë njeriu. Dikush fiku pastaj dritën e pakët të fundditës dhe muzgu i rëndë, si një perde pellushi e errët, u plas menjëherë mbi mua. Kaluan edhe dy orë të tjera, por askush, nëse ekzistonte njeri, s'u kujtua të hapte dritën në shtëpinë ku ishin fiksuar sytë e mi prej kohësh dhe që tani, prej rrathëve të dritës ngjyra-ngjyra që më dilnin përpara, e shihja fantazmagorike.

U kujtova që metra më tej ndodhej një kabinë telefonike. U përpoqa të formoja numrin e saj, pa ia ndarë sytë shtëpisë që ishte kthyer tashmë në një siluetë ta zezë në një sfond të errët e që ende dukej nga cepi i fundit të rrugicës, ku ndodhej kabina telefonike. Ai numër nuk ekzistonte. Boshllëk. E provova një herë, dy herë, tri herë... numri nuk ngjizej, asnje sinjal nuk formohej, hapej vetëm boshllëk, boshllëk pa ngjyrë, ishte një hiç i bardhë, e megjithatë, aparati telefonik funksiononte. E kuptova se i qeshë futur një loje të kotë e të rrezikshme që po më shkatërronte nervat. Vendosa të harroja gjithçka, edhe numrin e telefonit të cilin e flaka bashkë me pusullën e verdhë, dhe shtëpinë me portë kripte edhe kthimin e saj nga vdekja ... Dhe lëviza këmbët. Ndërsa ecja dhe i qëndroja besnike harrimit, e ndieja veten të lehtë e të çliruar, me një lloj kënaqësie të çuditshme që po më vinte nga një botë tjetër e që qarkullonte nëpër eshtrat e mia si lëndë magjike. Befas u gjenda ballë për ballë me një mall të madh. Nuk ishte brenda meje, sepse unë s'mund ta mbaja dot peshën e tij kozmike; kishte mbushur të gjithë hapësirën që më rrethonte dhe shkonte larg, përtej 20 vjetëve të kaluara...

Ajo kish qenë mikesha ime më e ngushtë. Deri ditën që ai hyri midis nesh. Ose më mirë, deri në çastin kur qëlloi rasti

në shenjë dhe unë u njoha me të.

S'kisha pikasur asfare që në jetën e mikes sime ishte futur dikush. Në jetën që ajo ndante me mua. Një dikush që do të futej, apo ndoshta qe futur, edhe në intimitetin e saj, atje ku nuk s'arrija dot– kur ajo më shpuri për vizitë në shtëpinë e tij. Hymë në një dhomë që dukej se qe kriuar enkas për të ndjellë mrekullira. Mbulesa e kolltukëve të rëndë, perdet që ofshanin madhështi, mbulesa e mocme me gjitanë e tryezës së rrumbullakët, qenë prej kadifeje ngjyrë vishnje të thellë, ndërsa vetë mobiljet e vjetra sikur pshëritinë kur ne u futëm brenda. Gjithçka aty ruante një fshehtësi.

Nga pesha e mllefit të madh që mbaja hopa në krahë kundër atij burri të panjohur që po më rrëmbente dhunshëm gjysmën time, hapat e mi gjëmonin në dyshemenë e fortë të asaj dhome.

U ula në një cep nga fundi, në krah të një rafti librash. Ata të dy ishin përballë meje, në një klimë krejt të tyren, aq larg meje, sa më ndihmonte vetëm një teleskop ndjenjash të mbaja njëfarë kontakti vizual me ta, me kozmozin e vogël të tyre. Mbi kokë kisha një fener të varur me spërdredhje të holla metalike. Ndodhesha, pa dashur, poshtë ujvarës së dritës së tij të butë ngjyrë vishnje që ma kish qullur e shkrirë krejt gjithë mllefin tim të madh kundër tij. Kështu pra, ndodhesha pa pikë mllesi në veten time, kur, befas, kuptova që ata të dy kishin kohë që bënин dashuri. Sepse lëvizjet që i afronin trupat e tyre ishin të natyrshme, të lehta, të mësuara, të cilat unë po i ndieja në tërë qenien time dhe prapë u kujtova se i kisha ndier vagullimthi edhe kohë më parë. Ata po bënин dashuri nëpërmjet meje.

Kisha ngrirë poshtë ujvarës së fenerit dritëvishnje. Kisha frikë se po të bëja qoftë edhe një lëvizje, do t'u prishja harmoninë e dashurisë. Dhe atë çast, atë çast zbulova se qeshë unë që e dashuroja vërtet të dashurin e mikes sime, se Ai qe përmua Ajo, me tërë intimitetin e saj që unë s'e kisha

timin, plus seksin. tjetër, të cilin nuk e kisha njojur deri atëhere, por që po më tërhiqte verbrazi pranë vetes. Dhe Ai, pikasa që dhe Ai po vinte drejt meje, ngaqë Unë i formova gjysmën tjetër të dashurisë së tij, dhe ai e dëshironte atë të plotë. Por ajo nuk arriti dot ta kuptonte magjinë e këtij Triniteti. Nuk e kuptoi dot kurrë, që ne të dyja ishim dy rreze drite që konvergonim në një pikë -- dhe Ai qe pika.

Ajo u largua. Unë sërisht e desha shumë tek Ai që vazhdonte ta dashuronte. Pastaj ajo vdiq nga një rastësi e pakuptimit. Unë prapë e gjeta dhe e desha tek Ai dhe u mundova ta ngushëllloja dashurinë e tij tashmë çyryke. U mundova të isha një më shumë seç isha.

Nuk mundëm të bënim dot kurrë dashuri. Ishim të gjymtë, diçka na mungonte, kishim një gjymtyrë më pak, një gjymtyrë të domosdoshme, ndoshta më kryesoren.

Varrit të saj i mungonte rrasha e mermertë që kanë gjithë varret e tjera. Kishte vetëm një gurë varri të lehtë dhe një kufi varri. Asgjë tjetër.

Kjo më qetësonte, ngaqë më dukej se ajo mund të kalonte edhe këtej, duke qenë andej, dhe prania saj këtej do të më ndihmonte në dashurinë time, në dashurinë tonë ndaj tij. Por ajo sërisht s'po kuptonte...

Vitet kalonin dhe ne të dy, ai dhe unë, takoheshim dhe ritakoheshim duke u munduar të gjenim atë që nuk ekzistonte, deri sa nuk u takuam më. E kishim kuptuar se shqetësonim dikë që kërkonte vetëm paqe...

U ktheva në shtëpi me shpirt në fund të këmbëve nga malli për të vdekurën dhe për magjinë e humbur. Shkova te telefoni. Kujtesa ime këndonte numrin e saj...

“Jam unë” thashë zëdredhur, dhe mbajta vesh zërin që mezi fliste shqip dhe që papritur qe kthyer në zë fërmije. “Të njoha, si dukesh?”, “mirë” vazhdoja unë. “Po ti?”, “Mirë, jam shëndoshur pakëz... dëgjo, kostumi yt i kuq indian më rri i ngushtë te vithet, e kam në trup”.

Pra ishim pajtuar. Ajo po më quante sërish mike të ngushtë, pas tërë atyre viteve. Kish veshur kostumin tim, si atëherë kur i ndërronim rrobat pér të rrëfyer se ishim të njëjtë, se duheshim shumë, se as rrobat nuk mund të na dallonin...

"Jam kthyer që të të falenderoj..."

O Zot, ajo po më falenderonte pse isha ndarë nga Ai, pse nuk qeshë puqur kurrë fizikisht me të. Pra asaj i qe dikur krejt e rëndomtë historia jonë e perëndishme: unë i paskësha rrëmbyer të dashurin dhe tanj ajo më falenderonte... Oh, ajo s'kish pér të kuptuar kurrë më, s'i kish mbetur asnjë shans pér të marrë yesh...

Shpirtlënduar mbylla telefonin dhe u ula. Kokën e kisha rrokopujë. Nisa t'i analizoja edhe njëherë të gjitha nga fillimi, me të tëra hollësitë që më vinin në mendje. Befas pata një ndjesi të çuditshme, por të sigurt: kisha kuvenduar me veten time. Historia e telefonit dhe e të vdekurës qe një trillim i mendjes sime të eksituar, një instrument që më kish vënë përballë ndërgjegjjes e më kish bërë të flisja me të. Ngaqë kisha nevojë. U qetësova. Dhe vetëm atëherë hapa e vendosur dollapin e rrobave...

E kisha para syve varësen e rrobave, ku një ditë më parë kisha vënë kostumin e kuq indian. Ishte bosh. Në një cep varej e vetme kordelja e blertë e përjetshme e të vdekurës.

Atëherë e përfytyrova tek shkonte sërish udhës së vdekjes me kostumin tim të kuq, pa mëri në zemër dhe me buzëqeshjen naive e të kënaqur të njerëzve që i kuptojnë gjërat siç duan vetë.

**2 korrik 1992.**

## Portreti

Ishte mbyllur në studio që në orën dhjetë të mëngjesit dhe nuk po kujtohej të njitej në sallon për të ngrënë drekë. Kishte pothuaj dhjetë ditë që jepej e tëra pas një portreti, me një pasion të panginjur, që jo vetëm po i gjelltiste tërë kohën, madje edhe atë që i takonte atij, por po i brente ngadalë edhe një brazdë të lehtë poshtë syve, të cilën, më pas, ia ngjyente me mellan. Peneli i saj ndiqte pa pushim në telajo mijëra e mijëra lëvizjet e dritës, duke rafinuar qindra vijat e saj dhe duke udhënë nuanca të reja gjithësaherë përzierjevë të ngjyrave të portretit.

Edvini nuk guxoi të hynte brenda. Studioja qe tempulli i saj. Përpala se t'i përfundonte punimet, Ani i ruante me fanatizëm nga sytë e të shoqit. Ai vështroi nga dritaret e mëdha që binin në kopsht, dhe e pa më në fund të fshehtën e së shoqes. Qe portreti klasik i një fisniku të famshëm e të hershëm me jaka dantellash, plisetë e të cilave ishin punuar aq hollë, saqë ngjanin sikur tundeshin nga era. Nuk e gjeti përnjëherë se cili qe. Lu desh të shfletonte enciklopeditë, për të identifikuar portretin e mrekullueshëm të pasionit të ri të së shoqes: ishte Cesar de Bourbon, duka i Vendomës.

I lumtur nga zbulimi, jo gjithmonë i kuptonte pikurat e së shoqes, sidomos ato abstraksioniste, për të cilat ajo thosh se pat fiksuar shpirtin e saj të mbetur pezull çasteve të shkuara, ia pëshpëriti emrin e dukës Anit, që rrinte shtrirë pranë tij në krevatin bashkëshortor, e lodhur përvdekje nga përkryerja e pasionit të saj. Ajo nuk reagoi. Ai i pëshpëriti sërisht. Asgjë. Këmbënguli duke i gjermëzuar çdo fjalë që i

rrëfente, ndërsa ajo hapi përgjysmë sytë, që dukeshin se s'po kuptonin gjë, dhe ra në gjumë të thellë.

Edvini u zgjua i tromaksur pas mesnate nga një ndjenjë e çuditshme. I qe bërë sikur ndodhej në një shtrat me një trup krejt të huaj. U ngrit përgjysmë dhe nisi të zhbironte i shqetësuar, në zbardhëllimën që sillte nata që përjashta, fytyrën e të shoqes që flinte e paturbulluar krah tij. Dantellat ngjyrë rozë të këmishës së natës i qenë mbledhur në gushë dhe ajo dukej si e stolisur me një fustan të qëmotshëm balloje. Kokën e kish kthyer anash dhe ai profil Edvinit iu duk i panjohur. I erdhi ta rrëmbente në krahët e tij e t'ia shkundte gjumin nga themelet dhe të sigurohej se ndodheshin të dy në të njëjtin shtrat, në të njëjtën botë. E zuri për supesh "Ani!", pore lëshoi në çast, ngaqë i erdhi keq ta shqetësonte. U shtri sërisht dhe mbajti vesh erën e lehtë që tundte gjethet e pemëve të kopshtit, xhamat e pafund të studios dhe hollërimat e jakës së fisnikut. U kthye në brinjë, çiku me hundë krahun e të shoqes dhe njohu parfumin e saj të përjetshëm. U sigurua se ishte Ani i tij dhe e zuri gjumi.

U zgjua vonë nga rrezet e thikta të diellit që mbushnin dhomën e gjumit. Ani nuk ndodhej në shtrat. U vesh shpejt dhe e ndjeu veten të këputur nga shqetësimi i madh i natës së shkuar. U fut në kopësht dhe qëndroi përpara dritareve të mëdha të studios. Ani veshur me kominoshet e punës ngjyrë vjollcë, vazhdonte të përkryente portretin e fisnikut. "Ani, Ani", trokiste ai lehtazi mbi xham vetëm për veten e tij, sepse e shoqja nuk e dëgjonte dot.

U bë gati të hynte në studio dhe ta befasonte Anin me emrin e dukës De Vendome, por pëmjëherë u kujtua se asaj nuk i pat bërë asnjë përshtypje ai emër, të cilin ai ia kish pëshpëritur në përgjumjen e shtratit dhe hoqi dorë nga surpriza.

Telefonoi në zyrë dhe njoftoi se nuk do të shkonte. Në orën 11 e gjysmë bëri gati kafet dhe i thirri Anit që prapa portës së studios. Kur ajo u shfaq te dera, ai i fshiku me buzë

një tufë flokësh që iu shhang vetiu puthjes së tij.

- Është ndonjë porosi muzeu? - e pyeti ai duke rrufitur kafenë, ulur në një kolltuk lëkundës në sallon.

- Porosi muzeu? - Ani kish hapur sytë dhe Edvini pa se i qenë bërë më të mëdhenje më të ndritshëm. Dhe si të huaj.

- Jo, pse?

Po ç'të hipët në kokë të merresh me portrete klasike?

Në të vërtetë, pasioni i Anit qenë legjendat e ilustruara me vizatime naivë dhe piktura moderne. E kish mbushur bibliotekën me libra legjendash pothuaj nga të gjithë vendet e botës. Dhe lexonte pa prehje. Dhe e tërë jeta e saj e mbyllur ishte vetëm legjenda dhe copëra fantazish të ngjyrosura.

Edvini e ndjeu me të gjithë qënien e tij se ajo nuk e dinte emrin e burrit, portretin e të cilit përkryente dita-ditës dhe u rrëqeth.

- Ani, cili është ai? - gati briti Edvini.

- Cili ai? - Ani ishte e qetë dhe e lodhur.

- Fisniku i portretit!

- Ah! Nuk ia di emrin ende. - Ani buzëqeshi. - Nuk ekziston, është vetëm në èndrrat e mia.

- Èndrra erotike! - Një gremç xhelozie e çori Edvinin.

Ani nuk foli. Atë çast, dielli që kish arritur në mes të qiellit e që u fiksua paskëtaj për shumë kohë aty, e mbushi salloni me valë të buta drite. Portëza e gdhendur e orës së murit u hap vrulltazi nga një kapriço suste dhe zogu i metaltë e i drojtur u dha në prag e përshëndeti dymbëdhjetë herë. Ani u ngrit.

- Tani është drita më e përshtatshme për të hedhur finesa ngjyrash, - tha ajo dhe e përshkoi ngadalë sallonin e u drejtua për nga dera që të nxirte në kopsht. Një fashë dielli i ra një çast mbi flokët e butë e të verdhë dhe i krijoi rrëth kokës një kurorë prej pluhuri vezullues, që e tërhoqi siluetën e saj pas vetes dhe e ngriti lart në qiellin e sallonit.

Edvini, që po e kundronte të shoqen tek i arratisej rrugës

për në studio, e mori atë imazh si shenjë humbjeje. Dhe netët që do të vinin, do t'i jepnin raste për ta vërtetuar atë interpretim fatal.

Zgjohej i tromaksur çdo pasmesnatë nga ndjenja e përhershme dhe e vetvetishme se ndodhej në shtrat me një trup të huaj, të cilin sa më tepër që mundohej ta bënte të vetin, aq më tepër e ndiente larg, tek i shmangej butazi, por me një ngulmim ta hatashëm e të vërtetë. Ai thërriste duke pëshpëritur "Ani, Ani" dhe detyrohej ta dëgjonte vetë zërin e tij, sepse askush tjetër nuk kujtohej ta bënte. Nisi ta kishte frikë edhe gjumin, edhe shtratin dhe iu përtérinë sërisht ankthet dhe frika nga nata e kohës së adoleshencës. Një natë, ndërsa rrinte dhe zhbironë profilin e panjohur të së shoqes në zbardhëllimin që sillte nata që përjashta, u ndriçua nga një zbulim i beftë: universi i largët ku gjendej Ani, pllluskonte në rrëthinat e hapësirës së portretit. U çua me të shpejtë dhe u bë gati ta braktiste trupin e huaj që flinte i paturbulluar bri tij, për të shkuar në studion e saj. Ndezi dritën vocërrake ngjyrë jargavani të abazhurit dhe u mundua të peshkonte pantoflat përfund shtratit, kuri zuri syri mes tisit të hollë të dritës ngjyrë jargavani, një hulli të trashë errësire, që niste te këmbët e shtratit bashkëshortor dhe humbiste nuk dihej se ku. Edvini u fut në hullinë e errësirës, pa u menduar gjatë, dhe zuri të bënte tutje nëpër të.

Qe shkëputur krejt nga klima e vakët e dhomës. Kish hyrë në një rrugicë me erë. Era përplaste kanata të padukshme me xhamë që thyeshin njëherit dhe shtronët truallin ku ai shkelte, me copa e thërrime qelqesh. Ajri që mbushur me aromë të kripur si të detit dhe me kundërmimin e lehtë të një parfumi të njobur. Ani pat kaluar andej. Edvini eci gjatë në gjurmët e parfumit. Herë-herë i duhej të çante përmes disa mjegullinave të ndryshme e krejt të panjohura për jetën e tij, por që, megjithatë, nuk i krijonin asnjë shqetësim.

Më në fund, rrugica e erës e nxori në një park të

mrekullueshëm që vezullonte nën dritën e hënës së plotë. Edvini pati ftohtë; vesa e natës që kish qullur lehtë gjithçka i qe futur në shpirt. Vështroi pa mendje të gjitha statujat e bardha që i dilnin përpara dhe u detyrua t'i mbante këmbët përpara një nimfe të lakuriqtë ngjyrë rozë, mbi trupin e së cilës luanin të gjitha misteret e dritës së hënës, që kish nën këmbë një hauz të artë; ishte Ani i tij derdhur në mermer rozak. Me dorën e djathë tregonte qiellin dhe me të majtën hauzin që kish nën këmbë, "Ani, oh!" nisi të vajtonte me zë e i pangushëlluar Edvini buzë hauzit, "Ani qysh është e mundur të të gjej mermer, Ani!" Ngriti sytë e mybtur në lotë të shihte edhe njëherë fytyrën melankolike e rozake të Anit - nimfë, dhe pa me tmerr se dora e saj tani tregonte hauzin, ndërsa e majta qe drejtuar nga qielli.

Përpara verandës së ulët e të pafund të pallatit, që shndriste nga drita e qindra shandanëve, kishin ndalur një mori karrocash vezulluese me kuaj: kaloshina, berlina, kabrioleta, viktoria...

Edvini, që kish mbërritur këmbëmarrë deri aty, qe struktur në një kaqubë të madhe trëndafilash dhe vështronte i magjepsur ballon fantazore të fisnikëve të një shekulli të shkuar, të cilin ai nuk mundi ta identifikonte dot. Ishte ballo pranvere dhe Edvini e pat ndier stinën e ringjalljes që kur kish vënë këmbën në park, por qe një pranverë e panjohur, me aromë dhe vesë drithëruese, me një dritë gjysmë të mykur - sikur të kish ndenjur mbyllur për qindra vjet në një sënduk kohe; një pranverë antike.

Kish filluar të rigonte shi. Petalet e trëndafilave të kaçubes shtatlartë ku qe fshehir ai, ishin rënduar, dhe kur s'mbanin më, derdhnin mbi trupin e tij shifte freskët. Edvini u ngjit pas një kolone të verandës dhe kur zbriti në truallin e saj të mermertë, pengoi pa dashur një kamarier petkangrirë me një tabaka plot me gota të larta pijesh. Kamarieri ofshau

rëndë dhe Edvini shpejtoi t'i kërkonte ndjesë, por ai nuk e dëgjoi dot.

Atë çast, fisnikëria e verandës u derdh në një minuet magjik, ndërsa Edvini i vetëm e i mahnitur nga muzika ngau këmbët me mendje për t'u kthyer tek statuja e lakuriqtë dhe rozake e nimfës, që ndërronte lëvizjet e duarve sipas dritës së hënës. U bë gati të zbriste prapë në kaçubene trëndafilave, në kohën që valltarët e fisëm qetësonin trupat nga ritmi i shpejtë i minuetit, me ca lëvizje të thjeshta e të moderuara danci, kur pikasi Anin-nimfë që po afrohej në krah të të Dukës de Vendome. Ishte e freskët dhe e ngazëlluar, me një bardhësi farfuritëse mermeri, me flokët tërë bukle të pudrosura e të zbulkuarë me një diademë gurëbardhë dhe me një fustan të hollë njyrë rozë gjithë dantella fantazie në kraharor, që mundohej më kot t'i fshihte lakuriqsinë e saj të natyrshme prej nimfe.

Edvini ishte ngurosur. Ajo po afrohej pa e parë dhe pa menduar një grimë për të, e lumtur nga prania e dukës së saj. I kaloi aq afër, saqë Edvini e dëgjoi shkoqur tek i pëshpëristë dukës: "I kujt është pallati, cili je ti, si kërcehet minueti?". Duka nuk fliste, vetëm i buzëqeshte.

Edvini doli befas nga shtangia dhe vrapi tek Ani. E mbërtheu nga krahët dhe briti si i çmendur: "Ani, jam këtu, jam me ty, mos e mundo veten me pyetje, Ani, galanti yt është Cezar de Bourbon, duka i Vendomës. Vetëm atë çast vuri re se Ani i kish sytë të mbyllur, frymëmerrete e qetë dhe lakuriqësia e saj qe e ftohtë si prej mermeri.

Edvini e kuptoi, E mori vesh se ajo qe e gjallë në një botë, të cilën Koha e pat lënë pas, ndërsa ai nuk i përfillej dhe qe krejt i huaj përtë. Dhe vërtet, e simund të jetonte në të njëjtën botë me dikë tjétër. Sa jetë kishte njeriu? Një, dy, shumë? Jetonte përjetësisht? Vdiste përjetësisht?

U kthye nga kish ardhur dhe e kaloi si nëpër ëndërr parkun e mrekullueshëm me nimfën rozake, që tashmë mungonte, rruginën me erë e me kundërmimin e parfumit të

njohur, hullinë e errësirës dhe u fut në shtratin e tij të vëtmuar.

Drita verdhacuke e paradites vjeshtake që filtrohej nëpër gjethet gjysmë të thara të pemëve, e që i pat shpërndarë ëndrrat e kobshme të natës, binte mbi skrivaninë deng me shkresurina dhe i jepte një pamje të kotur gjithçkaje përreth. Edvini e la zilen e telefonit të binte tri herë, përparrë se të shkundej nga përgjumja dhe lodhja dhe të ngrinte receptorin. Ishte Ani. Dukej e gëzuar. "Ani nga po flet? Ku je?" e pyeti ai gjithë ankth. "Si nga? Nga studioja ime. Dhe do të jap një sihariq: e mbarova portretin dhe jam shumë e kënaqur nga puna! Tani do të jem e lirë. "Vërtet?" zëri i Edvinit ishte mekur. Kur qe ngritur në mëngjes kish pasur frikë të kalonte nga kopshti përtë vërtetuar mungesën e Anit dhe të portretit. "Vërtet?". "E lirë për ty!" ia kthente ajo. "Po tani?", Edvini e kish të vështirë të bindej se ndodhej në një botë me Anin, "Tani? Eja ta festojmë, shpejt!"

Ai mori më nge rrugën drejt shtëpisë. I ra për së kithi sheshit të madh të blirëve gjysmë të zhveshur, u ndal në një dyqan luksi dhe bleu dy shishe të shtrenjta shampanje. Zonja e dyqanit ia mbështolli me dy letra fantazie të zeza, dhe u lidhi nga një kordele të shkëqyer ngjyrë rozë. "Jo, jo rozë, ju lutem". Edvini ishte tronditur papritur. "Pa kordele, s'prish punë, faleminderit!"

Në sallon Ani e priste ulur në tryezën e lulëzuar. Ishte veshur në të kaltra dhe flokët i kish kapur me një fjongo të madhe të kaltër.

E kaltra i ngazëlleu atij sytë. E mori të shoqen në krahë dhe zuri të rrotullohej me të si të si i çmendur nëpër sallon.

-Ani! Saimarrë paskam qenë! A ubeson ti aluçinacioneve nocturne? A u beson të krisurve si unë?

Ani vetëm lëshonte kukurizma gazi si e dehur. Kuri shoqi i lumtur e uli në tokë, i tha:

- Po portretin e mbaruar nuk ke qejf ta shohësh, hë?  
 Është i mrekullueshëm! Puna ime më e mirë!

- Pstaj, kemi kohë. Të ftohim njëherë shampanjën, që të bëjmë gjëzuar përpara tij.

Edvini e rrëmbeu sërish në krahe dhe zuri ta puthte si i daldisur. Befas, buzët iu ftohën dhe një si frymë ngrice e shtangu në vend. Në flokët e Anit kish zbulua gjurma pudre. "O Zot!" klithi me vete, "Mos po çmendem?". E lëshoi të shoqen përtokë, ngaqë s'i kish mbetur pikë fuqie. Më pas, mundi të dilte jashtë që të përbyste stomakun e të nxirrit gjithë helmin e tmerrit që i ishte grumbulluar në të.

Ndenji në kopsht deri sa nata zuri të plakej, duke klithur me vete: "O Zot! Ajo po kremon sot pikërisht dashurinë e saj me dukën, ndërsa unë jam një i ftuar nderi. O Zot! O Zot! Sa i verbër që jam. E pabesa më mori sytë me ngjyrën e saj të kaltër, më gënjeu, më tradhtoi. O Zot! O Zot"!

Anin e gjeti në shtrat syzgjuar. Lëvdoi perëndinë që nuk e kish zënë ende gjumi dhe solli në dhomë shishet e shampanjës dhe dy gota. Kish vendosur të mos dorëzohej. Do t'ia dehte ëndrrën të shoqes me shampanjë, do t'ia bënte gjumin plumb me shampanjë, që ta mbante të mbërthyer pas tij përgjithmonë.

E mbushi gotën, që rrëzelleu një çast nën zbardhëllimin që sillte nata që përjashta dhë ia zgjati Anit: "Për portretin!". Ajo e rrëkelleu me një psherëtimë të gjatë. Ai e pa dhe ia mori gotën nga dora që t'ia mbushte sërish, por Ani kish marrë udhën e gjumit. Profili i saj mbi nënkesë, u bë prapë i huaj. Ai e kupto se ajo nuik ndodhej më aty dhe u sul t'i vente pas, por nuk gjeti rrugë.

Kaloi shumë kohë përpara se Edvini të gjente, nën dritën vocërrake e të jargavantë të abazhurit, hullinë e trashë të errësirës, që niste në këmbët e shtratit bashkëshortor, dhe shkonte nuk dihej ku. Kur u fut në të, e mbante ende në dorë

shishen e shtrenjtë të shampanjës...

Bari i drejtë i parkut shushurinte. Edvini mbajti vesh dhe dëgjoi shushurimën që ishte fjalë: Ani, Cezar, Ani, Cezar... Ani... Ani... Shushurima u bë fillad që lëvizte mes fijeve të blerta. Shkonte në të gjitha anët, vinte nga të gjitha anët. Edvini nisi të kërkonte ankthshëm qendrën e filladit. Ishtë e pamundur të gjendej. Ai endej i paqetë nëpër park, mendjeçartur si një dashnor tragjik në kërkim të tradhtisë së lashtë, me një shishe të shtrenjtë shampanje në dorë.

E gjeti më në fund qendrën e filladit bri hauzit të artë. Qe në formën e një gushe të bardhë e të zhveshur që lëbyrte nën dritën e hënës. Fustani i hollë rozë ishte hapur si erashkë dhe i qe bërë shtrojë trupit të nimfës që prehej në krahët e dukës.

Në shishe s'kish mbetur asnjë pikë shampanjë: fundi i saj krisi thekshëm, sa hap e mbyll sytë, në buzë të hauzit, dhe , dy thepat e kristaltë që dolën, zunë vend në gushën e bardhë që lëbyrte nën dritën e hënës.

Kur në agim Edvini zbuloi në shtratin e tij të vetmuar profillin e pañjohur të një gruaje me gushë të mavjosur nga plagë vdekjeprurëse pasioni, mendoi i çliruar se më në fund, Ani, kaq kohë e mëdyshur, kish vendosur të rronte përfundimisht në botën që i takonte vetëm asaj dhe të mos kthehej kurrë më.

Shkurt 1993

## Takimi tjetër

Në mes të fletëve të një libri, diku në bagazhin tim, ruaja etiketën e një shisheje vere, të cilën rastësia ma pat hedhur në dorë në një restorant të Arlit; në një etiketë ishte stampuar emri i vendit ku ndodheshin qilarët e verës; Vaucluse

Bashkë me etiketën ruaja edhe një llpj brenge - nuk kisha mundur dot të shkoja në atë vend.

Fluturoja një ditë me një grup miqsh, nga Arli në Avignon dhe shkoja, pa e ditur, rrugës së Vauclusës, kur dikush më tregoi se pikërisht aty kishte rrjedhur një pjesë e jetës së Julio Cortazarit. U mundova në çast t'ua mbushja mendjen të tjerëve, pushtuar befas nga një dëshirë e papërmabjatur, ta drejtonim makinën përatje, mirëpo të gjithë ishin përndezur nga ethet e Pallatit të Papëve të Avignonit dhe mezi ç'prisin tē arrinin atje sa më parë. Megjithatë, u ndalëm vetëtimthi në Les Beaux, ku natyra qe stisur artificialisht për të krijuar një vend të hatashëm turistik, ku me cikërrima qenë sajuar mjeshtërisht mrekullira artizanale dhe përdredhje fantazie, dhe ku unë bleva një skelet njeriu plastik kinez dhe një maskë faqekuqe prej allcije.

Në të kthyer, sërisht më ndoqi pas një lloj fataliteti ogurzi; miqtë e mi, aq të mirësjellëi zakonisht, as që e përfillën Vauclusën time, dhe këmbëngulën të qëndronin në St. Remy. E kishin bërë mendjen top të gjenin Nostradamusin, hijen a fantazmën e tij dhe ta detyronin t'u përsëriste profecinë e llahtarshme për vitin 2000.

Në mes të një morie të pafund rrugicash të gurta të St.

Remysë, arritëm, më në fund, të gjenim portën shekullore të errët, të mbuluar fund e krye nga pluhuri dhe të mbathur me sumbulla bronxi, të shtëpisë ku pat jetuar Nostradamusi.

Nga një hije e vvetetishme ngallmimi, ajo ngjante si e vulosur prej shekujsh. Miqtë e mi zunë të bërtisnin e të bënин potere përpara saj, në rrugicën me rrezet e fundit të ditës, të mbytur nga afshi i nxehtë i gurëve, duke thirrur Nostradamusin, të hardallosur nga vera e Avignonit dha pa guxuar t'i binin çokut të derës.

Poterja e tyre u shua në çast kur unë kapa rrëmbimthi çokun. Ishte krejt pa kuptim. Mbi portën e rëndë varej një pllakë e vjetër porcelani ku shkruhej "Shtëpia ku jetoi Nostradamusi 1503-1566" dhe asnjë shenjë tjetër që të mund të tregonte se ajo shtëpi që kthyer në muze. Megjithatë, i rashë çokut, që lëshoi një kërcitje të thatë e të shurdhët e që, pa dyshim, nuk u përcoll aspak përtej portës. Kështu duhet të kenë menduar edhe të tjerët, sepse kur që përtej portës erdhi përgjigjja e papritur: "Qui est?", të gjithëve na goditi e njëjta drithërimë si rrufe qielli. Ishte një zë pa seks, që ngulmonte të më thoshte se aty nuk kish mbetur më asgjë, asgjë fare nga Nostradamusi.

Më pas, kur e morëm veten nga çudia, zumë të haheshim me njëri-tjetrin në ishte zë burri apo gruaje zëri i përtej portës së Nostradamusit, derisa njëri arriti të gjente zgjidhjen e perëndishme: ishte zë fantazme.

E kisha harruar edhe etiketën e verës në bagazhin tim, edhe brengën e Vaucluses së Cortazarit ditën që fluturoja sërisht me makinë Parisit pranveror. Nuk e njihja kryeqytetin e botës dhe mikeshë që më shoqëronte më emërtonte shpejtazi deri edhe rrugët dhe rrugicat e tij. Po drejtoheshim për në "La Coupole", për të kërkuar të tjera fantazma malli njerëzish të shquar, kur zëri çuditërisht i huaj i mikeshës më komunikoi se porsa kishim kaluar Qimiterin e Montparnassit, ku prehej prej vitesh Julio Cortazari. Dhe nuk kishim kohë

të ktheheshim pas.

Brengë e Vaucluses atë çast gjeti rastin, u ngrit nga harresa dhe u plas mbi muame një peshë të dyfishtë. Ndjeva se fataliteti ogurzi më qe vënë sërish pas. Të nesërmen largohesha edhe nga Parisi, edhe nga Franca. M'u krijua përshtypja e vetvetishme se, në fund të fundit, kisha ardhur në Francë vetëm përt'u takuar me ëndrrën e pothuaj një jetë të tërë: Julio Cortazin. Dhe tani po largohesha duke lënë Vauclusen dhe Qimiterin e Montparnassit dhe ëndrrën time.

U ktheva në Hotel-Jardin *La Brea* dhe mbaja ende në gojë shijen e kafesë së ftohtë të *La Coupole*, kur vajza e recepcionit më dorëzoi një pusullë nga askush. U ula e lodhur ta lexoja në hollin e vogël intim e të lulëzuar të hotelit. E hapa pa qejf. Nuk u besoja syve: ishte një copë fletë fletoreje nga ato që nuk kisha parë prej vitesh. Më linte takim buzë Senës, atë pasdite në orën 6.00. Nuk kishte emër: jetërshkruesi pat qenë i sigurtë se, përt'u njojur, nuk kish nevojë të nënshkruante. Shkrimin, po, shkrimin e kisha shumë të njojur, vetëm se më ngjante pak si i vjetër, a pak si shumë i ri, si i dalë nga koha -- a ndërron shkrimi i njeriut nëpër vite?!

Takim buzë Senës! Vetëm një njeri që nuk e njeh as Parisin e as botën, mund të lërë një takim në erë si ky.

U futa në dhomë me kokë të ngatërruar nga mendimet dhe u shtriva në krevatin e pafund bashkëshortor, që ndodhej përballë një ballkoni të mrekullueshëm. Faqeve të tij kish shpërthyer një blerim i harlisur pranvere, me vargje urthi dhe dredhkëlash të mbushura me lulëza rrëzulluese bardhë e rozë. Herët në mëngjes kish rënë një shi i hollë e i vakët shirtëror, që i pat shtuar një notë më shumë paqje qetësisë pariziane dhe më tepër vesë ballkonit tim. Hapa kanatat e xhamta dhe shkova dorën nëpër blerimin e harlisur të vagjeve të urthit me lulëzat vezulluese... E pabesueshme!

Blerimi pranveror qe artificial, i rremë, dredhkëlat të rreme, të rreme edhe peronkat që, të fshehura mes gjethive,

i mbanin mbërthyer pas faqeve të ballkonit. Vetëm një myshk i hollë, i artë e i përunjur kish lindur i vërtetë qosheve.

U ktheva te pusulla e këtij takimi tjetër, që nuk e prisja. Zbulova se qe shkruar me një frëngjishte të kulluar klasike, të cilën kisha frikë se nuk e përdorja më dot dhe me një lloj serioziteti naiv, të cilin e pikasa vetëm kur shkova tymazi në takim.

Mora një taksi që në orën pesë, dhe u nisa drejt Senës. As vetë nuk e di përse vendosa të ndodhesha në vendin e takimit të cilin vetëm Rastësia mund të ma zbulonte, përpara orës së caktuar, që ta kapja në befasiletërshkruesin misterioz dhe të mund ta shihja në formën e tij të vërtetë.

U ndala në afërsi të Senës dhe zura të ecja kuturu. Përnjëherë ndjeva se po jetoja ekzaktësish një copë jetë, të cilën e kisha jetuar tashmë. Po ai vend, po ajo orë, po ajo aromë, po ai qiell. Në një tregim të Borgesit kisha lexuar se shkrimitarit i kishin ndodhur dikur e njëjta gjë dhe kjo, sipas psikologëve, i përgjigjet një stadi lodhjeje...

E pikasa që larg, tek ia kishte ngulur sytë ujit. Dy jaka të bardha shkollareje i dilnin nga një pulovër e madhe bezhë, e cila ngushtohej në fund mbi një palë pantallona ngjyrë qumështi. E njoha menjëherë dhe lëvdova Zotin që më pat shtirë në mendje ta zija befas në formën që do të kish atij çasti. Ndryshe nuk do të mund ta njihja dot. Ishte pa mendje.

Iu afrova me të shpejtë dhe i fola:

- Po ti, ç'bën këtu? - U u trëmba menjëherë nga zëri im i vrazhdë dhe autoritar. Sytë e saj të dëlirë më vështruan me habi. Po sikur të mos qe ajo?

- Po ja, - m'u përgjigj ajo pas pak, duke vënë buzën në gaz. - Po të pres ty.

- Vetëm?

- Vetëm.

Vajzukja që kisha përpara më mallëngjeu. Befas u merakosa.

- Sa kohë ke vetëm në këtë vend?

- 12 vjet. Që atëherë...

- Dhe ç'bën këtu vetëm? Si më the? - e pyeta kot.

Nuk foli. Ia mbërtheu sytë sërisht ujit. Atë vështrim unë e adhuroja. Ishte një përzierje melankonike malli dhe pasioni. E kisha humbur atë vështrim që kur nuk më zinte më për krahësh, tinzar dhe i fuqishëm, malli i çartur për sipërfaqet e ndera të ujit, që burgosnin copëra qelli dhe unë nuk bridhja si e shkalluar bregut të detit a të liqenit. Sa kohë kisha që e kisha humbur! Tani mundohesha ta gjeja vetëm tek ajo nëpër fotografira.

E përqafova përmallshëm dhe ndenjëm të dyja ulur pa folur, në krahët e njëra-tjetrës. Pa dashur, isha lumturuar-veten time arrija ta njihja veç në pasqyrë e në fotografi. Imazhi im së largu më ngjante përherë i huaj. Ndërsa me zërin, çështja qe edhe më e koklavitur; nuk e dalloja dot që ishte imi as në incizime e as në jehona. Tani isha mësuar ta identifikoja me diçka të njohur, por kursesi nuk e-pranoja si timin. Atë e njoha menjëherë, e njoha si një fotografi të vjetër dhe të dashur.

*Ja Karmeni arixheshka,  
Një syzezë e flökë pis  
Zemrat seç ua djeg si eshka.*

.....

Nisi të recitone ajo që nga krahët e mi  
- *Karmeni i Gautierit*, - thirra unë.

*Lugat me ca sy shkrumbë të zi  
Në shtrat unë një natë do të vi.*

.....

- *Baudelaire*, - shpalla unë. Ajo mori zjarr.

*Jam bërë skillavi yt; prandaj ja ku të sjell  
Kët kulpërqë shket e ngjitet dhe drurët i pështjell.*

.....

- Ronsard, bien sur! - klitha unë e ngazëllyer që e mbaja ende vajzuken brenda vetes sime. Zumë të qeshnim si të marra.

Tani më dëgjo me kujdes! Zëri i saj qe bërë papritur serioz dhe si lojcak. - Është prova finale! - Nuk isha e ndërgjegjshme se po më merrete në provë! Ç'provë ishte kjo?

*On dance aux pieds de la colline.  
On ne sait rien...*

Heshti sakaq. Ato vargje s'më thoshin asgjë.

*Le ruisseau court, la fleur s'incline  
L'aurore vient!*

Tunda kokën. Ajo bëri e dëshpëruar një përpjekje të fundit.

*On chantonne le long des branches  
On ne sait rien...*

Më qe fshirë krejt nga kujtesa, nëse e kisha pasur ndonjëherë. Atëherë, ajo më rrëfeu një bllok shumë të njobur lëkure, që kundërmonte një aromë të myllur. Poezia ndodhej aty dhe qe shkruar nga Helena Vacaresco; pra e kisha humbur përgjithmonë atë pjesë të vvetvetes që i përgjigjej kohës së asaj 'poezie'. Apo ndoshta ajo kohë nuk pat ekzistuar kurrë tek unë? Nisa ta vështroja dyshimtare vajzuken studente që kisha përballë, e që kish zënë të

përtypje një fije bari me kokën rrëzuar anash! Po, a ishte vërtet ajo që qëndronte tani përballë meje? Befas, m'u kujtuan të tjera vargje:

*Tendidos en la yerba  
Una muchacha y un muchacho  
Comen naranjas, cambian besos  
Como las olas cambian sus espumas*

.....

Tani e kish radhën ajo të më vështronte me dyshim.

- Është *Të dashurit* e Octavio Pazit, nuk e gjete dot?  
Mbi ballin e saj u grumbulluan re të përhime.

- Tamam, që atëherë filloi çarja midis nesh. Që kur ti braktise Pasionin tënd të madh për... - Nuk iu durua asaj.

- Më beso, nuk e kam pasur të lehtë, kam qenë e detyruar. E di ç'do të thotë të të detyrojnë të heqësh dorë nga një pasion i madh? Ndërsa mundohesha të krijoja pasionin tim të ri, tërhiqja zvarrë pas vetes atë tjetrin, të parin, e kupton, të mbaja ty mbi shpinë... Por nuk e bëra dot shumë kohë këtë, nuk mundesha, dhe më në fund u kënaqa duke ruajtur vetëm disa grimca të tij. - I kapa rrëmbimthi duart, e brishta me gishtinj të hollë e të gjatë për të mbytur mallëngimin që më shtërngonte kraharorin.

- Të kujtohet si fërgëlloje kur dëgjoje emrin e Parisit? - edhe ajo ishte mallëngjer. - Të kujtohet si rrjje orë të tëra duke ndjekur me gisht në hartë vijat e rrugëve mbi planimetrinë e tij? I kam shëtitur të gjitha pëllëmbë për pëllëmbë, duke të pritur ty. - Sytë e saj të dlirë ishin rrëmbushur. - Ndërsa ti vonove kaq shumë! Po, po përkthimi yt i parë, të kujtohet, ishte Baudelarie, apo jo?

- Dëgjo, nuk kam pasur mundësi të vija më parë, vërtet! Ti e di sa vështirë është. E merr me mend se ç'po përkthej tani?

Zërin tim e dëgjova të huaj, ndërsa nata kish rënë papritur edhe mbi Paris, edhe mbi Univers. Vajzuken nuk e shihja më, vetëm e ndieja pranë.

- Eja me mua, mos rri vetëm këtu, - i thashë.
- Ku, në Spanjë? - ma ktheu me qesëndi. Pastaj me shumë mall pëshpëriti:
  - Unë këtu jam, nuk kam ku të shkoj. Ti eja më tako prapë.
  - Më duhet një pusullë tjetër misterioze në hotel, - ia prita me të qeshur.
  - Jo, s'ka nevojë, tani ti e di që unë të pres këtu, - foli seriozisht. - Eja nesër, po të duash.
  - Mirë, - iu përgjigja.

Përreth ishte errësirë pus. U ngrita dhë u largova verbazi. Nuk i thashë lamtumirë dhe as i tregova se të nesërmen do ta lija Francën. Nuk e di pse më pëlqeu ta gënjeja dhe ta mbaja atje, mbërthyer përgjithmonë pas Pasionit të Parë, veten time të rinisë, duke më pritur mua, që isha dënuar të ecja nëpër vite.

*Prill, 1993*

## Ishët kohë ankthi

*Atë ditë, me rastin e një përvjetori të botimit  
të Don Kishotit, për herë të parë në Spanjë,  
revista dhe gazeta flisnin për përkthyesin e  
madh shqiptar të kryeveprës së Servantesit  
Fan S. Noli.*

Për herë të parë për të më foli një mikesha ime, që asokohe jetonte në tokën bavareze. Më tregoi flurthi në telefon për vuajtjet që po i shkaktonte. Dhe ç'ishte më e keqja, fara e tij molepsëse lëvizte bashkë me ajrin. Në prag të udhëtimit tim të parë jashtë vendit, rrezikun e tij e ndjeva me gulshe të forta; nisa të zhytesha në një frikë pa rrugëdalje dhe përdesh hoqa dorë prej udhëtimit kur më mbiu në kokë mendimi gjenial se, në fund të fundit, mikesha ime po vuante vetminë dhe jo ankthin, siç e pat quajtur ajo torturën e pazakontë shpirtërore që e kish kapluar. Ndërsa unë vetminë e njhja prej kohësh dhe kisha arritur ta doja.

Qe shpëtimtare. Me këtë mendim të génjeshtër e naiv, e bëra me qejf udhëtimin, duke sajuar në fantazinë time lloj-lloj çastesh të lumtura takimi me vetminë e asaj toke të huaj, e cila do të më krijonte kushte të hatashme pune dhe kështu e lashë veten, pa e kuptuar, në prehrin e Ankthit.

Nuk qe tinzar. më doli ballazi porsa shkela në Spanjë dhe kërkoi të më hynte natyrshëm dhe pakundërshtueshëm në gjak. Prandaj nuk i bëra dot asnjë lloj rezistence. Endieva të njojur dhe përnjëherë m'u kujtua frika dhe vuajtjet e natës

së kohës së pubertetit, të cilat nisa t'i jetoja sërih e përmalluar e me gjëzimin e njeriut që gjen papritur një kohë të humbur. Dhe ishte e vërtetë: si atëherë kur fillova të njihja cilësi të reja të trupit tim, tanë po njihja fiziologjikisht, një faqe të re e të mohuar të botës - Madridin.

Pas Madridit, u vendosa në Shtëpinë e Përkthyesit, një vilë e bukur disakatëshe, në Tarazona, qytet i alkimisë dhe korridave, rruga "Borja 7".

Dhe mbeta fillikat e vetmuar që ditën e tretë. Dhe ankthi im madridas i puberitetit, ankthi i butë e i njohur, kish mbetur diku në Cason Guernica.

Që ditën e tretë, ajri i botës së zbuluar nuk më bëri më, ndërsa gjithçka përreth meje gatoi, me marifete alkimie, një ankth të tmerrshëm, i cili që në çastin që u ngjiz, vendosi të më vriste.

E llahtarisorvura re se, në një sekondë të vetme, më kish ndërruar krejt brendësia ime: diafragma kish marrë një harkim të madh e të pakthyeshëm sipër dhe u kish zënë vendin mushkërive, të cilat ishin atrofizuar e nuk ekzistonin më, ngaqë nuk duheshin. Zemra e zmadhuar tepër kish fituar peshë të madhe dhe kish zbritur në fund të këmbëve, ndërsa rropullitë kishin marrë arratinë.

Kish filluar ndeshja me Ankthin. Ai më përgjonte e më përndiqte çdo çast dhe, kur gjente volinë, më ngulte nga një grath. Kur haja, e kisha në tryezë, kurfilia, e thithja padashur me hunë, dhe atëherë gjumi më kthehej në zgjime drithëruese. Zemra gigante më dhembte thekshëm dhe dhembja e saj e paepur nuk reshtte kurrë, as në kotje dhe as zgjuar. Kur ngjitja shkallët, qeshë e detyruar ta mbaja në duar që të mos shkallëmohej.

Nisa të lija hapur dyer e dritare, me shpresë se diçka e papritur dhe e rastësishme do të hynte në vilë dhe në jetën time pa të papritura, që të më shpëtonte. Nuk ndodhi asgjë, ndërsa Koha filloi të rëndonte së tepërmi mbi trupin tim, që sa vinte e pakej. Përktheja kuturu për të vrarë kohën dhe

çliruar trupin, duke përgjuar atë që më ndiqte me beft: më pas, arrita të merja vesh se qe përkthimi im më i mirë.

Kish raste kur futesha në shtrat, mbuloja kokën dhe ia dilja të qetësohesha pak çaste. Atëhere e kuptoja se Ankthi qe lodhur dhe qe struktur diku.

Librat, biblioteka, televizori, shtretërit e të tjera dhomave, çdo objekt i vilës bëhej i gjallë tek unë me anë të aromës së tij të pagabueshme e materiale, që e gjente rrugën për te shtrati im, i cili ndodhej në papafingon moderne të ndërtesës. Dhe krijohej me ta një lidhje magjike që e thyente vetminë. Por zgjaste pak. Shpejt, Ankthi mëkëmbej dhe e prishte në çast lidhjen, me një goditje grathi.

Kishin kaluar dhjetë ditë që kur isha ngujuar në vilë. Nuk kishte mbetur asgjë për të ngrënë. Duhet të dilja e të blija diçka, që të mund të mbesja gjallë. Ishte e pamundur. Më ishte krijuar ideja e ngulur se do të mbaroja në çast, po të dilja jashtë e të bija në kontakt me ajrin, nga një reaksion i tmerrshëm papajtueshmërie.

Atëherë vendosa të kthehesha në shtratin e papafingos me tarracë dhe të mos ngrihesha më. I krijoja sërisht lidhjet e mrekullueshme me sendet që jetonin së bashku me mua, nëpërmjet aromës së tyre që thyente vetminë. Ankthi më la të qetë, priste jermin, që nuk vonoi të vinte. Atëhere, si shenjë të fitores së tij, më dha në dorë një rrambull kohe, të cilin ëngjelli i Fatit më bëri ta vërtisja drejt Shpëtitimit. Qeshë ndalur në një pikë krejt të harruaq të fëmijërisë sime dhe u bëra gati të jetoja prapë e me të gjitha hollësitë, diçka që e pata jetuar kur isha nëntë vjeç.

Me një perde kadifeje ngjyrë vishnjeje mbështjellë tri herë rreth trupit, recitoja pa u lodhur përpëra pasqyrës që ndodhej në dhomën e gjyshes, që nuk kishte të marrtur e që ishte sa një bojë njeriu, monologjet e mrekullueshme të Zhulietës nga "Romeo e Zhulieta".

Më kujtohjt imazhi i kopertinës së librit që tani nuk

ekzistonte më, ashtu si faqet e para që ishin grisur, edhe atë imitoja. Zhulieta e zbehtë, rrëzuar në krahët e Romeos në kubenë e përmendores së varrezave, mbante një pelerinë të kadifenjtë ngjyrë vishnjeje, ndërsa buklet e zeza të flokëve shpëtonin nga një skufje po e kadifenjtë e derdheshin supeve.

Isha dhënë aq shumë pas asaj tragedie shekspiriane, saqë çdo ditë, pasi bëja detyrat e shkollës, mësoja përmendësh të gjitha rolet, të cilat i recitoja më zjarr përpara pasqyrës që nuk marrtej, sa herë që gjyshja dilte dhe më linte vetëm. Deri ditën, kur një frysme e beftë dhe e çastshme prej përkthyesese, e cila do të ringjallej me të njëjtën forcë vetëm pas shumë vitesh, më bëri të pyesja time ëmë për përkthyesin e tragedisë së famshme: ishte imzot Fan Noli.

Lajhitja e saj qe e përditshme, sepse më bëri të rrëmoja e të zbulojta në lidhjet e miqësisë stërgjyshore me Mjeshtrin e madh, një provë familiare të ekzistencës së tij, një unazë të mrekullueshme, që gjyshja ime e mbante në gishtin tregues të dorës së djathtë dhe ku ishin të gdhendura inicialet F.S.N. Nuk më shkoi mendja ta vendosja atë në vite, e as që e bëja dot këtë, kur e vëtmja dëshirë që më kish pushtuar ishte ta gjeja e ta takoja. Kërkimi që zgjati me orë të tëra, qe aluçinant. Kisha marrë me vetë Mimozën, shoqkën time të ngushtë dhe së bashku brodhëm pa prehje rrugëve e rrugicave të qytetit të detit, një ditë të freskët prilli, duke zhbiruar fytyrat e njerëzve, pa ditur tamam ç'kérkonim, deri sa humbëm çdo lidhje me botën, në një rrugë që nuk ekzistonte, por që duhet të lidhte qytetin tonë me Ballkanin, e që në atë orë qe kredhur në mugëtirë.

Na gjetën si mos më keq. Mirnoza e gjorë me fustanin e kuq qull nga lotët, qante e lebetitej se nuk do të largohej më kurrë nga shtëpia, ndërsa unë dridhesha si purteka dhe villja çikë-çikë shpirtin prej hidhërimit, ngasse në çastin final, më qe ndriçuar mendja vetiu se përkthyesi i ëndrrave të mia kish vdekur pa e ditur unë dhe shumë, shumë larg vendit ku po vuaja.

Dikush trokiti përtë parën herë në derën e vilës së rrugës "Borja 7". Lashë jermi në shtratin përtë mos u ngritur më të parafingos, rrumbullin e kohës dhe çastin e fëmijërisë dhe fluturova shkallëve. Përmes derës, horizonti i muzgut turiasonenas qe mbytur në gjak demash të porsavrarë në *Plaza de Toros*.

Ai qëndronte në përag dhe më kish zgjatur dorën. Ngjante sikur notonte në një re të ndezur. "Imzot i ndëruar..." mezi arrita të artikuloja, sepse befas më qenë kujtuar fjalët e një libri: "Përherë do të gjendet një muzg i përfshakur që të na shpëtojë nga vdekja", dhe e lashë, pa mënuar, dorën në dorën e tij që më tërhoqi përjashta.

*Prill, 1993*

## Murgeshat e mbyllura të Santa Anas

Nuk kisha dëgjuar, kurrë për murgeshat e mbyllura. Si njalin e parë për ekzistencën e tyre ma dha një murgeshë plakë e jetës së lirë, të cilën e takova në kishën e San Franciskos. Shkoja shpesh në atë kishë, jo vetëm ngaqë s'kisha parë kurrë më parë kishë të vërtetë dhe jetën e saj nuk e njihja pothuaj fare, por edhe pse, mbasë edhe sugjestedionoja veten, aty gjeja një qetësi të madhe dhe një paqe absolute. Pas meshës së orës 11.00 édhe atë ditë ndenja paš turmës, duke u munduar të merrja vesh diçka më shumë për ikonat e shumta dhe statujëzat që mbushnin kishën. Kur ndodhej dikush pranë meje, i lutesha të më shpjegonte diçka. Atë ditë, pra, dijenitë e mia po i plotësoja me murgeshën plakë, që dukej sikur mezi e tërhiqte zhgunin ngjyrë gri. Kisha gjetur njeriun e përshtatshëm për të pyetur, (në moshën që isha qe vërtet skandaloze), pse as kërkoi shpjegime se nga vija e cilit kombi i përkisja. Nisi të më rrëfente plot historira biblike duke m'i ilustruar me kuadrot e mjeshtreve të mëdhenj turiasonenas. Fishtë ngadalë, me një zë mbushamendës e njerëzor dhe me një pasion të çuditshëm për t'i zgjedhur fjalët, deri edhe sinonimet e tyre me finesat e ngjyrimet kuptimore, saqë mendova me bindje, se vetëm një vokacion i madh prej përkthyesi mund t'ia kish shpërthyer atë pasion.

Kur dolëm në rrugën me kalldrëm, që ishte ndezur nga një zheg i zakontë për atë qytet, ndërsa unë e ftoja të pinim diku kafë, ajo papritur më foli për murgeshat e mbyllura,

duke bërë kujdes të më shpjegonte më parë kuptimin e fjalës të mbyllura dhe dallimin me murgeshat e jetës së lirë që jepnin mësim në kolegje. Ajo jetonte në kolegin e Santa Pilarit. Dikur kish dhënë mësim në atë kolegji, tanë ishte në pension dhe e kalonte kohën duke u kujdesur për murgeshat e sëmura dhe ato më plakat e komunitetit të tyre.

"A mund t'i shoh e të bisedoj me murgeshat e mbyllura, Motër Pilar?" e pyeta unë që më ishte përfshakur fantazia nga rrëfimet e saj. "Nuk është e lehtë", m'u përgjigj, "por shko dhe thuaju se të kam rekoma nduar unë".

Quheshin Karmelitat e Santa-Anës dhe manastiri i tyre gjendej në rrugën "Borja", në rrugën ku ishte Kolegji i Përkthyesve, pikërisht disa metra më larg vendit ku jetoja ato muaj. E pabesueshme! Çdo ditë kisha parë asaj ane vetëm një mur rrethues të trashë e shumë të larfë, pas të cilit mund të dalloje vetëm majë qiparisash dhe asnjeherë nuk kisha dyshuar se aty rrinin përjetësisht të mbyllura këto të tjera "Amazonat" e Spanjës katolike. Përparrë se të guxoja që të shkoja tek ato, nisi të pyesja pak poshtë e lartë; cila që kryemurgesha, çfarë mund të thosha që të mund të pranonin të flisnin me mua, si duhet të sillesha, a ekzistonte ndonjë rit i veçantë që duhej ditur përparrë se të shkoja atje e plot të tjera. Pyetjet e mia shkaktuan një tufan të vërtetë diskutimësh mës miqve të mi. Shumëkush e quante krejt pa interes atë vizitë. Të tjerët përkundrazi, thoshin se do të kisha vërtet fat po të flisja me Motër Jacintan, Kryemurgeshën e atyre Karmelitave: disa i përbuznin, sepse qenë gra që ishiin tërhequr nga jefë normale, nga ajo e vështira dhe kishin zgjedhur jetën e manastirit si jetën më të qetë dhe më të lehtë. Por kishtë edhe nga ata që i quanin të shenjta dhe i adhuronin. Megjithatë, nuk e di përsë më mbetën në mend fjalët e një mikut tim, lektor në Seminarin e qytetit, padre Jose Luis Sofiñiti, me të cilin kisha bërë shumë biseda teologjike: "Ato gra bëjnë atë që ne nuk e bëjmë dot, por që e kemi fort të nevojshme: lutën për ne".

Siq thashë, manastiri i tyre ndodhej fare pranë meje. Qe një ndërtësë nga ato të lashtat, që dukej sikur ngrihej mbi një shkëmb, megjithëse shkëmbi nuk ekzistonë dhe ëme një natyrë të vetën krejt të ndryshme nga pjesa tjetër e asaj që e rrëthonte. Porta e jashtme e murit rrëthues, e mbathur me pafta hekuri, të nxirrte në një oborr të vogël me lehe lulesh nëpër qoshe, nga ato që rriten vetëm nëpër manastire. Porta e brendshme qe gjysmë e hapur. Njeriu i parë që takova qe një plak i kërbunjur. "Jam në gregull" thashë me vete, tamam si rojtarët apo si kopshtarët e manastireve nëpër libra. I thashë plakut, që ishte vërtet rojtari i manastirit, se vija në emër të Motër Pilarit që të takoja Kryemurgeshën. Më la të prisja disa minuta, pastaj më drejtoi për te një si rrëfyestore. Rrëfyestorja, që ndodhej në gjysmërrësirë, kishte në të djathtë të saj një dritare rrotulluese me vrima të rrumbullakta. Prita gjatë para asaj dritareze, me shpresë se do të më jepte rrijë lloj zgjidhjeje. Po mendoja të dilja prej andej ngadalë dhe të vidhesha përjashta, e mërzitur nga pritja, kur nga vrimat e rrumbullakta vërshoi drita në gjysmërrësirën ku ndodhesha e zhytur. Në të njëjtën kohë u dëgjua një zë i ngrohtë gruaje: "Mirdita, kush jeni?". Nuk e shijha, dhë kjo mënyrë komunikimi më krijoj një ngërç në stomak. Thashë me vete të prezantohesha si përkthyese a gazetare dhe t'i rrëfeja vetëm emrin dhe rekmandimin e Moter Pilarit; kur nuk ia sheh bashkëbiseduesit fytyrën mund të thuash ç'të mundesh, por pastaj, për pyetjet që kisha ndërmend të bëja, e kuptova që duhet të justifikoja padjen time, duke thënë se isha shqiptarë, madje po të që nevoja, edhe t'i shpjegoja se ç'ishte bërë me fenë në vendin tim. "Shqiptare, si Nënë Tereza!" briti e entuziasmuar zëri m atanë dritarezës, që m'u duk i perëndishëm, ngasa vetëm ashtu mund ta bënte atë lidhje, për të cilën s'isha ende e ndërgjegjshme, e që shpejtoi të prezantohej: "Jam Jacinta, Kryemurgësha". Nuk pata nevojë për tjetër rekmandim; ajo më priti në një audiencë të veçantë, si rrallëherë i takonte

të priste.

Ndodheshha në një sallë të modernizuar, por të thjeshtë, një faqe murit të tē cilës ishte e hapur me një rrjetë hekurash. Andej Kryemurgesha, këtej unë. Të dyja të entusiazmuara. Ajo me shëmbëllityrën e Nënë Terezës në sy, unë me etusiazmin e njeriut që ndodhet përpara një zbulimi të madha. E dija që Motër Jacinta ishte rreth të pesëdhjetave, por fytyra tejet e bardhë dhe primitive e gruas që kisha përballë nuk tregonte më tepër se tridhjetë vjeç. "Motër, si është e mundur që jeni kaq e re?" e pyeta, pa dashur ta pyesja. "Pasiioni i madh për Atë, bija ime" u përgjigj Kryemurgesha që më la pa mend. Kisha një bindje krejt tjetër: pasioni shkatërron, dhe rrënojat që lë pas dallohen së pari në fytyrë. Por nuk fola.

Përpara se ajo të më shfaqej përtetë hekurave, kisha mundurtë dalloja një çast duart e tejdukshme të një murgeshe të re që ishin zgjatur përtetë hekurave dhe kishin marrë një kuti me bombone çokollate, të cilat ia kishin sjellë familiarët në takim. Rit burgu.

Nuk i pashë dot qelat e tyre, sado që këmbëngula shumë. I fshihnin me fanatzëm nga sytë e ne njerëzve të tjerë, sikur të kishin frikë se i molepsnim me jetën tonë të vërtetë.

"Sa murgesha ndodhen në komunitetin tuaj, Motër?" e pyeta. "Nëntë." m'u përgjigj ajo dhe nisi të më rrëfente për Të Shenjtën që kish themeluar Urdhërin e tyre, përmurgeshat e para, dhe, ndërsa më tregonte, unë mundohesha t'i gjeja një emër zërit të saj të padëgjuar, që më kishte trazuar shpirtin e që s'do ta dëgjoja kurrë më. Ma tregoi ajo vetë, kur më ktheu një çast shpinën për të marrë portretin e Shenjtores së Urdhrit të tyre, dhe unë pashë, vetëm për një çast dy flatra të mëdha, të bardha e të mbledhura në rrudhat e zhgunit: ishte zë i pamëkatë, zë ëngjëjsh.

Më pas, Motër Jacinta më tregoi për jetën e tyre të përditshme; që, siç kuptova, ishte një rreth i mbyllur: lutje;

qëndisma, përgatitje ëmbëlsirash dhe lutje, lutje... dhe nuk dilnë kurrë nga manastiri. Jeta e tyre kishte ngecur në një pikë të hershme të historisë së njerëzimit:

Më kish qëlluar të shijoja në një dasëm një tortë me kate, që e kishin përgatitur karmelitat e Santa Anas. Ishte një vezullim i tërë trëndafilash të kuq zjarr, të cilin nuk kisha përtar harruar kurrë nga tërë ai intensitet pasioni që rrezatonte pérreth. Kujtimi i tij më armatosi gjithë gjemba; s'duroya dot dhe e thumbova Kryemurgeshën: "Po mirë, Motër, cili është vallë shkaku i mbylljes? Ndonjë dashuri e dështuar? Ndonjë dashuri e penguar, apo e vështirë?". "Jo, jo, aspak!". Sytë e Kryemurgeshës kishin marrë flakë. Pasi i qetësoi disi, më rrëfeu: "Ndodhem këtu e mbyllur me binjaken time që prej afro 30 vjetësh. Ishim rreth pesëmbëdhjetë vjeç dhe gjendeshim në një panair, kurna mbushi befas të dyjave dhe në të njëjtin çast një frysëzimi i perëndishëm: t'i kushtoheshim Zotit, të bëheshim nuset e Krishtit. Megjithatë, vetëm frysëzimi ishte i pamjaftueshëm, na duhej një besim që të mermim një vendim të përgjithmontë. Kështu që pritëm vite e vite të tëra për t'u bindur, përpëra se të bënim betimin". "Betimin", e ndërpërra. Ajo fjalë më futi ngjethmat, pse më dukej e pakthyshme. "Dhe s'mund ta shkelnit kurrë atë, edhe sikur të pendoheshit, edhe sikur t'ju bëhej e padurueshme jeta?" "Posi jo! Madje edhe tani, po të duam, mund ta prishim betimin dhe të kthehem i në jetën tuaj. Gjithçka bëhet vetëm me dëshirë"

Sa herë kemi ëndërruar në adoleshencën e hershme, u kujtova, ta linim jetën e tokës për atë të qellit, ta linim mërsoren për idealen, të rronim në paqe në ndonjë manastir e t'i kushtoheshim Zotit apo yjeve.

"Moj nuse e Krishtit" iu drejtova Kryemurgeshës, "A je e sigurt ae do ta takosh Krishtin?". "Për atë takim jetoj" m'u përgjigj ajo dhe unë e ndieva menjëherë se çdo gjë tjetër e saj qe shuar, fshirë. "Do ta takoj patjetër në jetën e përtejme". Kishte aq shumë bindje në zërin e saj, sa m'u duk

vërtet ligësi kur e pyeta: "Po sikur kjo të mos jetë e vërtetë, ke dyshuar ndonjëherë?"

Pothuaj të gjitha streset që kisha kaluar e që i kisha mbytur në alkol, më kishin ardhur pikërisht nga lëkundja e besimit në pasionin tim. Po ato, ato si mund t'i kalonin ato lëkundje besimi pa alkool, pa muzikë, pa arratisje nga vjetvetja, pa çmendurirat e jetës së tokës? Nuk e morra vesh dot kurrë. Mësovat vetëm se ato qenë çastet më të tmerrshme të jetës së tyre të mbyllur.

Bota i kish harruar. Ose më mirë, kujtohej për to vetëm gjatë ëndërrimeve të çartura të adoleshencës. Ndërsa ato, përkundrazi, e siguronin përjetësinë e tyre duke u lutur e duke u sakrifikuar për të, duke sakrifikuar jetën e tyre të qashtër dhe duke ushqyer pasionin e tyre pa prehje.

Nga ai takim i padëgjuar, më mbeti vetëm një shami e qetë dhe e hollë batisti qëndisura me lulëza të kaltra, të cilën ma dhuroi Motër Jacinta, dhe një dëshirë e marrë për t'ia mbathur me të katra e përmos u kthyer më kurrë në atë vend, ku pata përshtypjen se Qielli ishte shumë afër dhe se Vdekja pritej me bujari. Madje as për të lexuar vargjet që shkruante Kryemurgesha.

**1991**

## Kadare, Atxaga, Çmimi Nobel, Lopez Rubio në shtratin e vdekjes

Kësaj radhe Spanja m'u duk më e qetë dhe më pak pasionante se një vit më parë; ndoshta ngaqë s'më kish mbetur më ç'të zbulojë nga thesari i saj (iluzion i marrë); ndoshta ngaqë fantazma-mall e Markezit qe shkrirë e nuk e kzystonte më (ai nuk kish ndërmend të vizitonte Spanjën); ndoshta kisha marrë përsipër një barrë shumë të madhe -- përkthimin në spanjisht të një *Antologje* të Poezisë së *Sotme Shqiptare*, e prandaj më nevojitej, më tëpër se gjithçka, qetësi dhe ndihmë specialistësh gjuhe. Spanja qe për mua vendi ideal, ngasë do të punoja e paturbulluar. Por s'ndodhi ashtu; punova vërtet, madje shumë, për përgatitjen e antologjisë; por jo në qetësi të plotë.

"Prishjeqetësia" filllooi me Bernardo Atxagën.

"Është Kadareja ynë bask", më kish thënë vitin e kaluar një mikesha ime, shkrimtare baske, kur më pat folur për shkrimtarin e madh Bernardo Atxaga, Çmimi Kombëtar të letërsisë spanjolle dhe finalistin e Çmimit European, autorin e romanit të famshëm *Obabakoak*.

Dhe kjo lloj përqasjeje, por ndoshta edhe fama e madhe e Kadaresë, që ato kohë kish marrë përmasa të reja në Spanjë, a njohja ime si përkthyesja e tij, a vetëm fakti që isha shqiptare, e solli Bernardon tek unë. Apo mos ndoshta vinte si një pushues modern letrar -- ato ditë kisha dëgjuar

se ekzistonte një film i quajtur *Pushtimi i Shqipërisë* (La Conquiste de Albania), që tregonte për dyndjet e baskëve në Shqipëri, qindra vjet më parë.

Ndodhesha në Manastirin e Vëruelës kur Atxaga më tha:

- E di Mira, se deri pak kohësh e përfytyroja Shqipërinë një vend të ftohtë e akullimë, ku dëborë nuk shkrinte kurër?

- E pse? - e pyeta unë e habitur. - Nuk e dije se është vend mesdhetar?

- Jo, po... e kisha fjalën për Shqipërinë e kuqe, si Bashkimi Sovjetik; më kupton, Shqipëria e ndarë nga bota, cingërimë, një lidhje krejt naive, - zuri të më shpjegonte. Shpjegimet ndoqën njëra-tjetrën dhe, kur nisëm të flisnim për politikë, kuptova se në atë dalldi nacionaliste që kish përfshirë vendin bask, Bernardo ishte, ndoshta, njeriu më mendjekthjellët e i matur. Me të qeshur zura ta thërrisja: *nacionalist në mbrojtje*.

Në mbarim të takimit, në kafenenë *La Corza blanca*, ku të dukej se kishe hyrë në një nga legjëndat më të arrira të Becquerit, Bernardoja më tha: "Mundohem që për bibliotekën e fshatit tim të lindjes Asteasu, të mbledh libra me autografët e shkrimitarëve të mëdhenj. A më bën një nder të marrësh autografin e Kadaresë për fshatin tim?".

Më 23 shtator, në sallonet e pallatit Gaviria në Madrid, bëhej prezantimi i Pallatit të Ëndrrave, të Kadaresë në spanjsht, në një ceremoni ku qe ftuar dhe autorë.

Mall o mall ... Malli për të Ikurin dhe amaneti i Atxagës, më bënë të fluturoja drejt Pallatit Gaviria, Pallatit të Ëndrrave, ndërsa ora shkonte 2000 dhe trafiku i Madridit bëhej i tmerrshëm. Edhe ata të dy alkimia e mallit i kish ndryshuar, e një malli tjetër, ku e ku më të madh se malli im pipiruq -- Elena qe zbukuruar e kish shpërthyer në një pranverë bukurie, Ismaili ishte çiruar nga arroganca - mburojë ndaj diktaturës dhe mbante në gjithçka të tijën,

madje edhe në klimën që e rrethonte, shenjën e Çmimit Nobel.

Më dukej se gjithë ç'ishin aty, vetëm për këtë pëshpërisnin; edhe vajzat e reja që i kërkonin autografin edhe gazetarët që i merrnin intervista edhe dy shkrimtarët e tjerë që bënин po njëloj si ai prezantimin e veprave të tyre edhe plakushet e pispilosura që mezi vërtiteshin të kërbunjura nëpër shkëlqimin e sallave dhe që dukejshin sikur i gjëmonin këto ceremonira, vetëm e vetëm për të nxjerrë edhe njëherë nga sëndukët veshjet lüksoze të mykura, që dukejshin sikur futeshin vetë kudo, ndaqë askush s' i llogariste më, edhe vetë botuesi Mario Muchnik, ebreu shtatshkurtër që gjendej kudo, në të njëjtën kohë.

Elena dhe ünë s'u ndamë një çast dhe, më vonë, duke lënë gjithçka dhe gjithkënd, Ismaili u bashkua me ne në një tavolinë, në një sallë të vogël të pallatit Gaviria, ku ndezëm një shandan - si shenjë bashkimi - dhe unë dëgjova fjalët: "Do të kthehem sa më shpejt që të jetë e mundur".

Ndërsa më pas zoti Uriz, poet dhe përkthyes i njohur spanjoll komenton me Ismailin veprat e tij dhe Ismaili më thosh se i bëhej shumë qejfi që kisha arritur të injihesha me gjithë ata intelektualë spanjollë, unë ngazellehesha nga nendimi, se magjini e asaj mbrëmjeje duhet t'ia dedikoja fustanit tim të kuq indian, që thoshin se sillte fat.

Më pas, da të bëja një tjetër fluturim dhe kësaj radhe drejt vendit bask, drejt San Sebastianit të hatashëm - vendpushimit të mbretërve - dhe Astreasut të blertë, të blertë sa s'ka, që dukej sikur qe krijuar enkas për të mikpritur të largëtit. Në fshatin e vogël Ateasu, ku ndodhej edhe shtëpia e fëmijërisë së Bernardo Atxagës, kthyertani në një vend të paqtë që priste e përcillte shtegtarët e letrave, mbaroi dhe odisea e amanetit të Baskut: vendosa në bibliotekën e fshatit, që ndodhej në ndërtesën antike të Bashkisë, librin me autografin e Ismail Kadaresë.

Ishte data 3 tetor 1991. Që në mëngjes Radio Spanja zuri të buçiste për Çmimin Nobel të letërsisë, që do të jepej atë ditë në Stokholm. Në orën 13.00 do të shpalley në radio; bëheshin komente, flitej për Pazin, nobelistin e një viti më parë, për kandidatët e mundshëm të këtij viti, përmendej Kadareja, Gordiméri...

Zura ta ndieja veten keq; tërë atë ankth të fjetur, të cilin kisha ditë që e vuaja mjegullazi, Radio Spanja e kish shpallur zëshëm dhe unë fillova ta vuaja zëshëm e me bujë. S'më zinte vendi dhe nisa ta shprehja aq shumë shqetësimin, saqë miqtë më këshilluan të pija disa pika Avena Sativa - qetësuesi i përsosur i Shtëpisë së Përkthyesit - të cilin e kish lënë në të kalur një përkthyes - alkimist bask e që të gjithë përkthyesve të gjorë, kujt më parë e kujt më pas, iu duhej ta përdornin.

Pas Avena Sativës, u nisa për në Zaragoza ku duhet të siguroja një vizë franceze në konsullatën e Francës. Pasi mbarova punë në konsullatë, e shoqëruar nga dy mikeshat e mia shkova në katedralen Pilar, që të falesha për Nobelin. Nuk dija asnjë lloj lutjeje, megjithatë, mendova se vetëm vajtja do të më ndihmonte.

Ishte vërtet një katedrale madhështore, ndërsa brendësia e saj qe magjepsëse: vargan njerëzish blinin qirinj gati një metër të gjatë me rrathë bojari i vendosnin të ndezur në një vend të posaçëm bajtësqirinjsh, tymnaja e të cilit ngjitej lartë, deri në një cep të kubesë së katedrales, të cilën kish nisur ta brente zishëm. E ndeza dhe unë qiririn tim, e putha dhe Zemrën e Shenjtë, ku shumëkush kish neveri të vinte buzët, ngaqë aty s'rreshnin të puthurat dhe, së fundi, u gjenda përpara vet virgjëreshës në Altar. Një gjyshe që kishte sjellë aty nipin 6 - vjeçar, po i pëshpëristë:

"Shihe, sot Virgjëresha është veshur me të kuqe, mund të thuash më mendje një dëshirë dhe ajo do të

të pëtësohet.". Përpara se vogëlushi, me syçkat e mbyllura në një ekstazë kerubini, të formulonte dëshirën, unë, sikur të qeshë në një garë dëshirash me të, thirra pa mendje e më zë të lartë: "El Premio Nobel (Çmimi Nobel)!". Të dy mikeshat, gjyshja dhe vogëlushi, më vështruan të habitura, ndërsa unë shfajsohesha hutueshëm:

"Na duhet, na duhet çmimi!"

Më pas, ndërsa ora i afrohej rrëmbimthi 13.00, u futëm në restorantin *Pasqyrat* të hanim drekë. Të zotërit e restorantit, dy homoseksualë simpatikë e të qeshur, na sajdisën përmrekulli. Isha marrë vesh t'i telefonoja zotit Uriz në orën 14.00, ndaj puna e parë që bëra, kërkova të dija ku ndodhej telefoni. Në orën e caktuar telefonova. Zëri që përtej më thoshte: "Dëgjo, Mira, zoti Kadare është tepër i ri..."

"Po kush e mori?" e ndërpresa unë.

"Nadine Gordimer", formulohej përgjigja që vijonte "Është, grua, Mira, është grua! Ty duhet të të bëhet qejfi... Në këta 25 vjet... asnjë grua..."

Të dy homoseksualët buzëqeshnin pa të keq, ndërsa mua më vinte t'u bërtisja: "Ju dhe buzëqeshjen e keni perverse!"

Rrugës përnë Francë, kalova nga Barcelona, ku kishte "strofullën" Gisberti i madh, mjeshtri i letërsisë imagjinare përmes rindërimit të rastit fatlum e të mos e takoja, aq më tepër që tani, përvyeçse mbaheshë si lexuesja e tij, kisha në dorë përkthimin e librit të tij *Magjistari i Esmirnës*.

Më priste përpara hyrjes tejet luksoze të konsullatës franceze. Ishte mesditë dhe Barcelona rrëzëllinte nga një diell i ngrohtë vjeshtor (Barcelonën s'mund ta përfytyroja dot pa diell). Gisberti i gjatë e i hajthshëm, me një kostum të lehtë ngjyrë ulliri të çelët, me flokë të dredhur e të

gjatë, me mjekër e mustaqe - Krishti katalan 41 - vjeçar - dukej sikur porsa kish dalë nga librat e vet. Kryemjeshtri i fantazisë dhe misterit - libri im i dytë përfëmijë *Teotihuakani vendi i diellit i kushtohej pikërisht atij: Joan Manuel Gisbertit, magjistarit katalan, që më orientoi në labyrinthine fantazisë...* " më vështronte gulmazi me sytë e tij të blertë pas syzeve lentebardha që s'e pengonin aspak forcën e tyre dhe unë, në gjendje gati hipnoze, e dëgjoja të më thoshte se ai e mbante farën e gjenisë në pëllëmbën e dorës së majtë, ku dy vija përsosmërisht paralele tregonin se qe i "zgjedhuri" mbi këtë tokë, se një magjyp i famshëm i kish parathënë fatin, parathënie që ai e mbante të fshehtë, të kyçur në kaseta manjetofoni, por ama dukej tepër i kënaqur nga ajo; se njerëzit që s'shohin ëndrra, ndryshe nga teoritë e deritanishme, i përkasin një zhvillimi shumë më superior se normalja; se ai e kish parandjerë qysh vite më parë takimin me mua kur pat shkruar "Talismanin e Adriatikut", se mbase unë qeshë nga vendi i talismanëve të gjallë të Adriatikut.

Joan Manuel Gisberti dukej se, edhe kur s'shkruante, jetonte në botën fantastike të mistereve që krijonte.

Me vdekjen isha vënë në garë: kush do ta arrinte më parë Jose Lopez Rubion, humoristin e madh spanjoll, skenaristin e dëgjuar të Hollivudit, autorin e tregimit të famshëm *Pijetari i dritës* të botuar një vit më parë në Zëri i Rinisë. I madhi Rubio dergjej, kish kohë, mes mjegullinave të humbamendjes dhe unë e dija këtë, prandaj lusja Zotin të mos e merre përpara se të vija këmbën në Spanjë. Zoti ma akordoi favorin, por s'qe e thënë ta takoja. As unë, as vdekja.

Lopez Rubio qafqohej me vetminë dhe flërtonte me vdekjen; herë shkonte në botën e përtejme dhe herë kthehej në botën e këtejme, por në asnjë rast s'pranonte të shihte njeri të gjallë me sy, veç mikut të afërt dhe arkivistit të

veprës së tij, padre Jose Maria Torrijos.

Padreja ishte si i modeluar në qiri, me ca sy të vegjël të kaltër në gri tepër të zgjuar, i veshur me një sqimë e kollarisje që s'dukeshin të kësaj bote. Madje, parfumi i tij i vinte vulën kësaj përshtypjeje. Njeriu i arkivit të Rubios më rrëfeu shumë gjëra për humoristin e madh; kur gjente një grimë kthjelltësie midis delireve, memorja e kaltër e Rubios, ku parakalonin njëshkolonë artistët e mëdhenj hollivudianë si Çaplin, P.Godard, L.Séanson, S.Laurel, O.Hardy e të tjerë, pyeste: "Pó mirë s'kanë punë tjetër shqiptarët, veç të më përkthejnë e botojnë mua?".

90-vjeçari s'gjente prehje, kërkonte sërisht paqe mes përcartjeve dhe i kthehej arkivistit: "Shiko more, e more vesh, më kanë përkthyer në Shqipëri, të besohet?".

**Tetor 1991**

## Ferri i Novelave Orientale

(Përkthimi dhe çmenduria)

Që kur lexova njërin pas tjetrit romanet madhështore të Marguerite Yourcenarit *Kujtimet e Hadrienit* dhe *Opus Negrum*, e ndava mendjen me një vendim të pakthyeshëm: nuk do t'i futesha kurrë përkthimit të asaj shkrimtareje të rrezikshme, përndryshe erudicioni i saj i frikshëm, i cili më pat mrekulluar gjatë leximit të thjeshtë e të përciptë, domosdo, mund të më zinte frymën po të guxoja ta lexoja në të thellën e tij -- ta përktheja. Një dreq deformimi profesional më minonte gjithsaherë shijimin e leximit të rrjedhshëm, pse gjithsaherë më detyronte të vija në peshore veprat që mund të përktheja dhe ato që s'do të mund t'i prekja dot me dorë. Yourcenari më trembte. Dhe mundohesha t'i rrija larg. Deri ditën që shkova në Kolegin e Përkthyesve në Arles të Francës, e vendosur të përktheja një vepër nga letërsia bashkohore franceze.

Arli më preu në besë dhe më beri të shkelja vendimin tim të pakthyeshëm.

Nuk kisha vendosur ende se çfarë do të përktheja, mendjemarrë nga malli për Parisin, kur dola nga aeroporti Charles De Gaulle dhe shoqërueshja më bëri një pyetje, që më zuri gafil: "Çfarë do të përkthesh?". U kapa në çast, pa e vrarë mendjen gjatë, pas një emri shpëtimtar që m'u kujtua befas, dhe mërmërita: "Tournier". Më pas, ndërsa çanim rrugëve të humbura nën një shi hollak e të vakët, u ktheva

dhe e mendova seriozisht: "Po sikur tē përktheja me tē vërtetë diçka nga Tournier?"

Mekanizma tē mistershëm fillojnë tē fuksionojnë në kokën e një përkthyesi në çastin që ai ndodhet përpara dilemave tē mëdha tē zanatit tē tij dhe vendosin për tē, sepse sado që mundohesha tē zgjidhja diçka nga Tournier, nuk ia dilja dot; librat e tij që njihja, binin e humbisnin një e nga një në një pikë tē errët tē kujtesës sime.

Kolegji i Përkthyesve ndodhej në ngrehinën e dikurshme tē *Hotel de Dieu*, e cila mbahej në këmbë që nga shekulli i XVI. Ishte restauruar e tëra dhe ambientet brenda ishin tē modernizuara, por më mjaftoi tē shihja në tavanin e dhomës sime trarë tē mëdhenj e tē zhveshur dhe pranë tyre ca dritarëza papafingoje që sillnin nga jashtë gugatje pëllumbash në pranverë, për tē kuptuar se lashtësia, që ndillte një vetmi tē çuditshme, do tē ishte përherë me mua. Qe një klimë e hatashme për tē përkthyer.

Lidha duart dhe iu luta Shën-Jeronimit -- shenjtë mbrojtës tē përkthimit, tē më çlironte nga mëdyshja që më kish kapluar si sëmundje e ligë. Dhe vërtet, atë pasdite, ndërsa në oborrin e brendshëm tē Kolegjit kishin ndërtuar, brenda disa orëve, një lulishte tē mrekullueshme me kube lulesh, e veja e Danilo Kishit, përkthyese e veprës së tij në frengjisht, që mbante, në gjithçka tē sajën, vulën e një humbjeje kozmike, e zgjidhi në çast mëdyshjen time: "Përse nuk përkthen *Novelat Orientale* tē Yourcenarit" më tha. "Ka edhe legjenda ballkanike që do tē tē pëlqeijnë".

Pata përnjëherë sigurinë se ajo vepër kishte nevojë për mua dhe, pa menduar më për asgjë, e shkela vendimin tim tē pakthyeshëm.

"Lamtumirë o personaliteti im", thashë me vetë kur vendosa t'i përvishesha punës. "Një tjetër do tē tē zëvendësojë e do tē tē tërheqë zvarrë nëpër hulli tē shkelura", sepse gjithmonë kam besuar se përkthimi është zgjedha më e shkëlqyer që na hedh mbi zverk letërsia.

Leximin e përciptë, atë në frengjisht, e bëra me një frysme -- *Novelat Orientale* qenë të mrekullueshme.

Por për t'i shijuar të plota, për të arritur deri në thellësitë e tyre autentike, duhet t'i përktheja. Isha e vetmja lexuese e tyre e privilegjuar, pse jo vetëm që po i deshifroja një e nga një, duke e zhbiruar e kuptuar në thelb tekstin origjinal, por po e transmetoja në një tjetër sistem linguistik, për ta vënë në shërbim të të tjerë lexuesve të gjuhës sime, të cilët, nga ana e tyre, do të ishin të detyruar të bënin një lloj tjetër përkthimi origjinal, për ta përshtatur më mirë me veten e tyre.

Pa dashur, *Novelat* kalonin brenda meje, shkriheshin tek unë, bëheshin unë dhe shpejt humbiste kufiri ndarës midis meje dhe autores.

Sa e saherë ëndërroja syhapur sikure shoqëroja unë plakun Vang-Fo udhëve të mbretërisë Han; nisa të recitoja përpara princit Genghi poezi që dilnin nga goja e Zonjës - së fshatit - të luleve - që bien. Madje, një ditë, fillova të rishkruaja në shqip, pa e pasur përpara tekstin origjinal, faqe të tëra të *Qumëshitit* të vdekjes, duke përfytyruar sikur vetë autorja po e shkruante në shqip. Qe një lloj Mishërimi. Por shpejt bëhesha e ndërgjegjishme për humnerën e kobshme që na ndante ne të dyja, për prangosjen time gjuhësore, dhe atëherë, e shihja veten të dënuar të përtypja një ushqim të hidhur e melankonik, i cili qe gatuar në Babel, në vendin ku u thye uniteti i Gjuhës së Fillimit.

Megjithatë, siç më ka ndodhur edhe me libra të tjerë, erdhi edhe për përkthimin e *Novelave* ai moment i çmuar, të cilin mund ta quaj parajsa përkthimore, kur u bëra mëndjekthjellët se, në fund të fundit, ekzistonte një lloj vartësie nga autorja, por, mbi të gjitha, ekzistonte liria ime absolute.

Porsa mbaroi përkthimi i librit, filloi ferri im i vërtetë: Pasiguria. Dhe kjo u bë akoma më therrëse në çastin kur u fiksua botimi. Kisha dyshime për saktësinë e

fjalëve të përdorura, për intensitetin e tyre, për masën e ngjyrimeve kuptimore -- çdo çast bëja korrigjime anash fletëve të përkthyera. Kishte raste që vuaja nga shproporsioni i përkthimit tim: kështu, vura re se në vend të dy fjalëve në origjinal, kisha përdorur tre në përkthim, në vend të dy mbiemrave në origjinal, kisha përdorur vetëm një në përkthim, e kështu me radhë. Dhe kulmi fare, më ishin veshur sytë dhe, duke i shkuar pas një logjike të pakuptimitë, kisha përkthyer *Qumështi i së vdekurës* në vend të *Qumështi i vdekjes*.

Kalova kohë të tëra duke pastruar, lëmuar, prishur e ndrequr, me një lloj çakërdisje mendore dhe duke gëlltitur gjithsaherë dyshime gjëmbaçë. Jo më kot kanë vënë shenjë barazimi midis përkthimit dhe çmendurisë.

Një ditë, krejt arbitrarisht, i dhashë fund një pune të pafund dhe dola ngadalë e pa u ndjerë nga përkthimi, si flutura nga krizalida, për të lënë përballë njëri-tjetrit Marguerite Yourcenarin dhe lexuesin shqiptar, në këto novela të mrekullueshme orientale.

Mars 1994

## **Puthja e katallanit**

*Katallani që pat dalë nga deti dhe pat shkelur vendin e vogël, kish rrëmbyer të Bukurën e Dheut dhe e ruante, me një xhelozи sa bota, në një shpellë skërkash deti. Zogjtë dhe peshqit që guxonin ta shihnin, binin të zhuritur nga rrufeja e tërbimit që shpërtihente nga syri i tij i vetëm i blertë. Ndajnatëherë, e Bukura zgjaste një tufë flokësh gështenjë përmes shkëmbinjve me lëmashkë, që Katallani ta çikte me buzë. Ky qe riti.*

Atë pasdite vonë, ndërsa muzgu që asaj i dukej se pérherë mbinte nga deti, po binte ngadalë mbi Barcelonë si një perde e tejrëndë, të cilës dikush i mblidhëtë litarët, Viola u ul të shkruante faqen e fundit në ditar. Qe faqja e fundit sepse nuk shkroi më as të nesërmendë as të pasnesërmendë e asaj dite e as kurrë ndonjëherë. Ngjarjet rrodhën aq shpejtë dhe aq marramendëse, saqë ajo nuk e kuptoi dot kalimin e kohës dhe nuk e ktheu fletën në ditar. Gjithçka fillonte dhe mbaronte atë ditë.

*Ai i kish sytë të blertë dhe tepër të tejdukshëm, si një mineral i qelqët e i rrallë, i zhdukur shekuj më parë, apo si fosili diçkaje që s'dinte pse qe shfaquredhe një herë në faqe*

*të tokës. Ndërsa flokët e tij të të dendur e të hapërdarë seç kishin diçka prej deti, ngjanin si një tufë algash thinjoshe të një specie të veçantë që s'kish guxuar më të dilte bregut, ngaqë ruante me fanatizëm të fshehtën e llojit të saj. Nuk di pse sytë e tij m'u dukën të njojur, të vërtetë, të lashtë e të frikshëm...*

Fjala e fundit i futi njethmat, "Pse të frikshëm?" pyeti veten dhe ndjeu të ftohtë.

Kishte pritur me ankth ta shihte e të ndodhej në auditorin ku ai do të jepte ciklin eleksioneve për psikanalizëm e teksteve letrare. I gjithë kursi i saj ishte si në ethe kur ai u shfaq në auditor vetëm pa shoqërues dhe pa pasur nevojë të paraqitej. Disa ditë më parë ishte përhapur lajmi se profesori i madh katalanas, Manuel Valverdu, ndodhej në Francë dhe nuk do të vinte në universitetin e tyre për ciklin e parashikuar të leksioneve; por, të nesërmen u tha se përkundrazi ai jo vetëm që do të vinte, por e kish afruar edhe ditën e fillimit të leksioneve. Pas dy ditësh do të ishte aty.

Viola ndodhej në rreshtat e parë të auditorit, kur e pa të hynte pa shoqërues e pa pasur nevojë të prezantohej, dhe kur befas e ndjeu të afërt, si një njeri që e njihte prej shumë kohësh, madje si një njeri me të cilin kish kaluar një copë jete. U mundua të queshte me vete dhe ta zbonte atë ndjenjë të pamendtë të cilën me siguri ia kishin pjellë emocionet.

Emrin e tij e kish parë që përpara disa vjetësh në revista spanjolle e të huaja. E quanin një nga psikanalistët më të mëdhenj letrarë të kohës. Pat lexuar edhe artikuj të tij, por vetëm përpara një viti, kur kish ardhur në Spanjë të studionte për letërsi moderne në Universitetin e Barcelonës, i qe futur tamam veprës së tij. Dhe kjo nga një rastësi fatlume. Në shtëpinë e mikeshës së saj në Madrid, kish gjetur gjithçka duhej për të krijuar një lidhje të madhe me Profesorin dhe veprën e tij; libra të përkushtuar dhe një arkiv të vërtetë artikuash dhe shkrimesh për të, prerë nga revistat

dhe gazetat, shumë fotografi plot çikërrima të këndshme, dhurata që ia sillte nga udhëtimet e tij nëpër botë, asaj shtëpie mikëpritëse, dhe një vazhdë të tërë kujtimesh.

Në parkun e madh El Retiro, kur po shëtiste një mëngjes vezullues vjeshte me mikeshën e saj madridase mes vargut të statujave bardhoshe të mbretërve e mbretëreshave të Spanjës, që vjeshta u kish falur dekorata gjethesh të praruara; kur u ndodhën pranë një hauzi të madh, ku notonte një mjelmë e vetmuar dhe ku shtresa zverdhake e palëvizshme e gjetheve e hidhte në një kohë antike dhe e bënte të dukej si pellgun e fundit të përblytjes së botës; kur u gjendën padashur mes zallahisë së ciganeve vezulluese që kërkonin të hidhnin fall, që i kapnin përdore dhe i detyronin me lajka t'i dëgjonin më në fund fjalët e tyre të shpejta përfthim dhe misterin e kësaj jete, u doli përparrë një ngrehinë e madhe e qelqtë me një kupolë të ngjyrshme, e cila kish për t'i ndërruar jetën.

Do të kthehej sërisht në atë vend me mikeshën e saj, dhe më pas vetëm për të vënë rregull në kujtime, sepse pikërisht aty madridases i zgjidhej gjuha dhe i fliste për të, ashtu si nuk i fliste gjetkë. Asaj here të parë i rrëfeu se, pikërisht tek ajo ngrehinë e qelqtë ku organizoheshin ekspozita të arteve figurative, e pat njojur profesorin e madh, veprën e të cilit ia këshilloi Violës si shumë të rëndësishme për studimet e saj. Po në atë vend, kohë më pas, i rrëfeu se profesori i kishte telefonuar dhe i kish kërkuar t'i fliste gjatë për mikeshën e saj të re, për studenten ballkanase të Universitetit të Barcelonës. Se madje e kish pyetur - madridasja qe bërë serioze - a qe e bukur dhe ç'ngjyrë i kishte sytë...

Në mbarim të leksionit, Viola u bashkua me grupin e studentëve, që i qe avitur grumbullit të librave dhe artikujve të fotokopjuar që ndodheshin para tij. Ndërsa ai i doli përparrë dhe, tek i hetonte sytë, i zgjati dorën dhe i tha: "Ti je Viola, sigurisht!"

Ishte truplartë, rreth të dyzetepesave. Mbante një kostum ngjyrë vaji dhe, nga lëvizjet tepër të matura që bënte, dukej i ndrojtur.

“Jo, gabim”, mendoi Viola ndërsa e kish lëshuar dorën në dorën e tij. “Nuk është i ndrojtur, sytë bleroshë i përflaken, veçse duket sikur ka dalë nga kallëpi i një statuje. Vetëm gjigandët mund të lëvizin kaq ngathtazi”. Në mes i kishin hyrë atë çast të tjerë studentë, por ajo e dinte se ai qe përqëndruar vetëm tek ajo.

- Viola, dalim? - Zëri i Bertranit e shkëputi nga qendra e vëmendjes së profesorit. Në mes saj dhe profesorit, zhurma e studentëve qe bërë e madhe dhe largësia e thellë, por, megjithatë, ajo e ndjeu se ai kish arritur të vendoste një fill të hollë lidhjeje midis të dyve. Uli kokën, fajtore që po e këpuste atë fill, dhe u largua.

- Hola, Bonita, mbaruat? - i thirri dikush në korridor.
- S'ka pak, - iu përgjigji ajo.

Që kur Andresi, një miku i saj, kish kënduar në katalançe, me kitarë, në një rreth të ngushtë miqsh, “Teu uells, Bonita”, të cilën e pat kompozuar vetë, të gjithë e thërrisin Violën “Bonita”. I kish ngjitur aq shumë ai emër, sa shumëkush nuk ia dinte të vërtetin, ndërsa asaj vetë i pëlqente ta quante si përkthimin e emrit të saj në spanjisht.

Ishte një kriesë e brishtë dhe shumë e bukur. Flokët gështenjë i kish të rëndë e të gjatë, derdhur poshtë supeve, dhe vetëm në mes të shpatullave u bënte pritë me një lidhkë të zezë fijeari. Krelat e lehta të tyre i rrethonin fytyrën e qumësht ovale, ku sytë e mrekullueshëm larushë kishin pjesën më të madhe. “Me siguri një nga stërgjyshet e tua ka pozuar për Venusin e Boticcelit”, i kish thënë një nga shokët e saj të kursit.

Drekoi së bashku me Bertranin në një restoran të vogël rus, që kish një emër ekzotik *Rasputin* e që ndodhej pranë pensionit ku banonte. Kish mbaruar së ngrëni ca lloj byreçkash të mbushura me puding peshku dhe po pinte me

ëndje verën e lehtë duke dëgjuar pa mendje muzikë të vjetër ruse, gjysmë e përgjumur nga muzgu i freskët ngjyrë vishnje i lokalit; sytë ia kish ngulur pishtarëve bojari nëpër mure, që në atë orë të ditës rrin në kot. Kur befas, ndjeu në dorën e djathtë prekjen e dorës së Profesorit. Vera i dogji faqet. Nëpër trup i kaloi një drithmë eëmbël. Pastaj u mbush e tëra me një vlagë të vakët dhe të gjithë muskujt iu nderën nga një ekstazë tepër e hollë. Zgjati vetëm pak sekonda. Kamarieri, veshur me një kostum kuq e zi, qendisur me gjitanë të artë të kohërave të carëve, qëndronte gatitë përballë saj.

- Kafe?

- Po, dy kafe, - foli Bertrani.

Ajo nuk e kishte mendjen. Provtoi ta ndiente edhe njëherë ekstazën e perëndishme që e kish kapluar pak çaste më parë, dhe ia doli mbanë; i mjafkonte vetëm ta shpinte mendjen te prekja e duarve, që gjithçka të krijohej nga e para: faqet i digjin, drithma eëmbël i kalonte nëpër trup, vлага e vakët e mbushte të tërën dhe muskujt i ndereshin.

Atë mbrëmje, pasi shkroi edhe faqen e fundit në ditar, u plas në shtratin e vetmuar dhe ndenji orë të tëra me një pasqyrë të vogël tualeti në dorë duke këqyrur fytyrën e saj të mrekullueshme dhe duke u ushtruar në bëjen dhe zhbërjen e ndjenjës që i pat krijuar në restorantin rus kujtimi i prekjes së duarve. E krioi dhe e prishi sërisht me duart e saj qindra herë ekstazën e përditshme, duke e jetuar gjithsaherë po aq të plotë sa herën e parë, derisa, e dërrmuar, ra dhe u plaqurit në një batak vetmie dhe boshillëku.

Nuk kishte zbardhur ende dita, kur u zgjua e lemerisur dhe e mbytur në një djersë cingërimë nga një frikë e panjohur. I qe bëre sikur binte me mijra herë në një hon, e rrokullisur nga një shkulmë ere.

Ngritur përgjysmë mbi shtrat, nuk e pengoi dot vidhisjen e trupit të saj në hon, megjithëse ishte syzgjuar dhe, për herë

të parë që kur kishte ardhur në atë vend të huaj, e zuri një dënesë pa prehje. Qau me lotë të mëdhenj e të nxeh të për të gjitha përbuzjet plot mirësjellje që i ishte dashur të kapërdinte gjatë bisedave përvendin e saj të vogël komunist, gulçoi tërë pezm për të gjitha ekzaltimet e pamenda që shfaqnin disa syresh kur flisnin për atë rregjim të përcudnuar, dhe la sumbullat e fundit të lotëve mbi jastëk, pa gjetur dot ngushëllim, nga se e ndiente veten përherë e më të huaj për atë botë që e rrethonte. Kur mbeti si kacek i shfryrë pa një pikë loti në sy, arriti ta merrte vesh se në Barcelonë kishte plasur furtuna më e tërbuar e atyre viteve, ndërsa në vendin e saj po ndodhët përmbyssja më e madhe politike e tërë historisë së tij.

Gjithë mëngjesin e kaloi në shtrat. Ishte e pamundur të dilej në rrugë. Shkulmat e erës së ngrrohtë fshihnin çdo gjë. Pasdite vonë, kur gjëmimi i furtunës u kthye në një vërvshëllimë ere dhe ajri u freskua, ajo ngriti grilat dhe u kujtua se nuk kishte futur gjë në gojë që nga dreka e një dite më parë. Kujtimi i drekës në restorantin e pishtarëve të kotë bojari, i solli në mend ndjenjën e mrekullueshme dhe të beftë të duarve. U ul dhe deshi të merrej sërisht me ushtrimin e saj, kur u dëgjuia zilja e telefonit.

Ishte Bertrani dhe qe i shqetësuar. Tërë bota po fliste për eksodin e tmerrshëm që po trondiste vendin e saj. I tha të provonte të lidhej me shtëpinë e saj në telefon; por Viola e dinte se qe pothuaj e kotë. Nga Madridi kish mundur të lidhej dikur me të, pas përpjekjesh të gjata. Do të pres të më marrin vetë në telefon", ia ktheu, dhe nuk e ftoi, siç bënte ngahera, të pinte kafe mbasdite me të. Atë çast dëshiroi me gjithë shpirt të ndodhej në San-Sebastian, pse u kujtua se vetëm atje mund të lidhej kollaj me vendin e saj në telefon. Ai u çudit dhe e shprehu çudinë e tij me anë të një heshtjeje të shkurtër; pastaj, ngaqë nuk mori përgjigje për heshtjen e tij, i tha një "mirupafshim" të mbytur dhe e mbylli telefonin. Viola ndjeu papritur keqardhje të madhe; përmbyssja më e

tmerrshme po ndodhte tek ajo vetë; ishte e detyruar ta përzinte Bertranin menjëherë ngajeta e saj.

Kujtimi i San-Sebastianit e goditi sërisht fortazi. Dhe fill pas tij, kujtimi tashmë i largët i Bertranit. Mbante mend se që kapur fort pas tij që ditët e para që kish ardhur në Barcelonë, dhe vetëm ashtu kish mundur të mbijetonte nga frika e botës së huaj, ku po guxonë të vinte këmbët. Dashurinë e tyre vetëtimë e pat trishtuar më vonë zilia e të gjithëve, që dukej sikur i prekte të tërë ata që i afroheshin Violës së bukur, por që, në të vërtetë, kish goditur e shituar vetëm Bertranin ngadhnjimtar.

Atëherë të dy ishin arratisur në San-Sebastian që të gazmonin jetën. Kishin qëndruar me orë të tëra netëve në plazhin e mrekullueshëm të La Conchas, përballë ishullit të Santa Claras, me rezidencat verore të mbretëve mbi shpinë, duke derdhur në Atlantik shkumën e praruartë verës baske, txakolisë, dhe duke u betuar për dashuri të përjetshme. Kishin hipur në malin Igeldo një ditë me shi për t'i pasur mbretërit nën këmbë, dhe kishin luajtur si fëmijë në një park lojnash të trishtë e të braktisur, mu përpëra hundës së rojtarit që s'guxonte të dilte nga kolibja e tij në atë rrebesch shiu, madje as përt'u hequr zinxhirët barkave që përplaseshin me tërsëllimë pas faqeve të kanaleve-labirinte ogurzeza. Kishin shkëmbyer të puthura të vockla nën tamarinet e mrekullueshme të plazhit dhe një të puthur të gjatë fati përpëra statujës së Zemrës së Shenjtë në majë të malit Urgull. Më tej, kishin shkuar dhe e kishin filruar dashurinë e tyre në skelën e portit, ku pluskonin ca anije jashtë kohës, ku dergjeshin në kalbëzim leshterikë e bimë detare, dhe ku ai i tha se pat varrosur përgjithmonë dashuritë e tij të vjetra. Paskëtaj, u kthyen në Barcelonë, të huaj krejt për botën dhe të vendosur të jetonin vetëm për njëri-tjetrin.

Dashuria e tyre e përjetshme kish zgjatur një vit. Atë çast, Viola e pa si vdiq rrëth drithës së abazhurit, në formën e një fluturë të madhe nate. E zuri lehtë nga krahët e ngarkar

me pudërtë hirtë që iu shkërmoqën në duar, dhe e flaku nga dritarja; ajri i freskët mbushi dhomën.

Viola doli në rrugë dhe mori një taksi për të shkuar asgjekundi. U ndal padashur në Las Ramblas dhe nisi të ecet ngadalë në shëtitore. S'kish bërë as disa metra, kur befas e zuri paniku; nga taksia nuk kish mundur të dallonte se muzgu qe ndezur flakë, dhe qyteti ngjante sikur pluskonte në një llurbë gjaku. Edhe ajo vetë po notonte në atë lëndë të përgjakur. Dëshiroi e lebetitur të kishte dikë pranë, por e kuptoi se kjo tani qe e pamundur. Shpejtoi të krijonte aty në vend, por për t'i bërë ballë panikut, të vetmin talisman që kishte - ndjenjën e perëndishme të prekjes së duarve dhe mori vesh se magjia e tij ishte prishur. Atëherë ndjeu nevojën e ngutshme për t'u kthyer në shtëpi që të bënte një banjë të nxeh të e të pastrohej nga lënda e kuqe muzgore që i ishte ngjitur trupit. Ndërsa priste taksinë që po vonohej të vinte për të, pse të tjerët e zinin përpëra, lebetia i rritej pa fund brenda zemrës. Kur arriti të vinte çelësin në bravën e apartamentit të saj, shqetësimin e mbartte drizë mbi kokë. U fut drejt e në banjë dhe hapi rubinetin e dushit. I flaku rrobat përtokë si lëfetra leckash të përgjakura, dhe bashkë me shiun e ujit të ngrohtë mbi trup, ndjeu zilen e telefonit. Ishte krejt lakuriq dhe përballë kishte një pasqyrë të vjetër sa një bojë njeriu, kur kapi receptorin.

- Viola? - dëgjoi zërin e rëndë të burrit dhe përnjëherë shqoi mbi pasqyrën e vjetër pupuriqe të mëdha që i mbulonin trupin. Përpëra se të përgjigjej "po", nuk harroi të mendonte se vërtet kishte një Zot lart në qiell.

- Je vetëm? - Zëri kish marrë më tepër peshë, - Ç'po bën? Nuk dole për t'u freskuar? Kaloi furtuna, për fat!

Viola iu përgjigj pyetjes së parë.

- Vetëm jam, sigurisht, - dhe deshi t'i shpjegonte se vetëm atë çast po e kuptione veprimin e zemrës së saj, se tani qe e lirë për të. Por dinjiteti i zërit të tij i ra përsipër dhe i mori frymën.

- Nuk është Bertrani me ty? - profesori i kishte hyrë një loje të rrezikshme. Kish hetuar për Bertranin dhe kjo dukej sheshit. Viola e kuptoi menjëherë se qëllimi i telefonatës së tij ishte t'i kërkonte shpjegime për jetën e saj intime. Nuk arrinte të merrete vesh se me ç'të drejtë, vetëm se, ndryshe nga ç'e priste, frymëmarrja e shpeshtuar nga ankthi në anën tjetër të fillit, u bë lojcake.

- Jo, s'mund të jetë me mua.

- E njeh ai lëkurën tënde?

Violës iu bënë faqet prush padashur. Nuk kishte pikë dyshimi; ai duhet të kishte mbi të të drejta që ajo nuk i njihte, por që duhet të qenë aq të fuqishme e të lidhura me ca instikte të pakuptueshme, sa Viola nisi t'u përgjigjej pyetjeve vetiu e pa tjerrur gjatë se përsë i bëheshin.

- Si të them... - Ai s'po e kuptonte dot që ata ishin ndarë përgjithmonë.

- E njeh në dritë apo në errësirë? - Zëri i tij ishte tanë pa ankth dhe i qetë, por shumë këmbëngulës.

- Në dritë - hixe, -- bëri shaka Viola, dhe vijoi hidhurazi,

- E ç'rëndësi ka më tanë?

I kishte marrë frenat e vetes në duar dhe e ndërprenë seancën torturuese të pyetjeve me një propozim të hatashëm:

- A nuk takohemi për një kafe?

- Ku?

- Këtu tek unë.

Nuk pati nevojë t'i jepte adresën e saj. Pas një gjysmë ore ai u shfaq në derë, truplartë e i ngrirë si një statujë. Ndërkokë Viola ishte mëdyshur për veshjen me të cilën do ta priste. E nervozuar kishte veshur në fillim një bluzë marinari dhe një fund të bardhë të shkurtër paladendur, të cilin e kish hequr më pas dhe e kish zëvendësuar me një fustan të kuq me tiranda, i cili i kujtoi menjëherë të çmendurën gazmore të lagjes së saj, që vishej përherë me të kuqe, që sillte modën europiane në qytet dhe që u shtinte zilinë të gjitha vajzave, ngaqë ishte e vetmja që mbante minifund. U

kujtua se e kishte parë një ditë tek e têrhiqnin zvarrazi policët dhe e fusnin në një "xhips", për ta mbyllur më në fund në çmendinë; iu kujtua qyteti i mbetur i shkretë, pa çmendurinë e saj gazmore, dha vajza pa zili minifundesh. E vendosi fustanin në karrige si homazh për të mbyllurën dhe iu duk vetja si një anijembytur në stuhinë e garderobës. U qetësua vetëm atëherë kur gjeti andej nga fundi i dollapit një fustan të blertë, të hollë e të freskët si bimë detare, të cilin nuk e kish veshur prej shumë kohësh. Përpara se të hapte derën, i hodhi vetëtimthi pasqyrës së madhe një mbulesë, ngaqë iu duk se aty kishin mbetur ende pupurriqet e mëdha të lëkurës së saj lakuriqe. Me të hyrë brenda, Profesori ia nguli sytë pasqyrës kryefshehur që kishte marrë një pamje qesharake dhe s'e mbajti dot gazin. "Pasqyrë karnavalesh", tha.

I kishte rënë pikës.

E zonja e pensioni i kishte treguar Violës, se gjatë karnavaleve të shkurtit, dy "arlekinë", kishin ardhur me një grup karnavalistësh dhe i kishin lënë në prag, mes të qeshurave, britmave dhe zallahisë së papërmnjat, pasqyrën sa një bojë njeriu. Që atëhere kishin kaluar plot dhjetë vjet, ishin festuar dhjetë karnevale shkurti, por askush nuk qe kujtar për ta marrë pasqyrën.

Viola nisi të përgatiste kafenë, ndërsa profesori u kujdes të merrete sërisht qëndrimin e ngrirë akademik. Kur vajza i serviri kafenë, nuk gjeti tek ai as gjurmën më të vogël të intimitetit të telefonit, dhe e zuri frika se mos qe gabuar që e kish ftuar për kafe në shtëpi. Vazhdonte ta bluante me vete atë frikë, duke dëgjuar pa mendje profesorin që ligjëronte pa prehje për shkencën e tij, kur u ngrit të mblidhët filxhanët dhe fshiku me kindat e fustanit dorën e burrit. Një tufë bimësh detare prekën lëkurën e Profesorit, që u drodh me një drithërimë të cilën ia trasmetoi asaj përnjëherësh, dhe me një kujtesë pothuaj një mijëvjeçare, atij i erdhën në mendje petkat e dantellat prej algash gjelbëroshe që thurte gjysmëkredhur në ujë, pa dalë ende dielli.

Befas u kthye nga një kohë e niga një horizont tjetër, dhe i foli asaj zëmbytur nga një krizë shumë e fortë malli për bregdetin e zemrës së tij. I foli dhe i rrëfeu dy orë të tëra për skërkat e mugëta e të stërlashta që, edhe në pikë të diellit, ruanin *copa nate* në mazgallat e tyre; për guackat e arta që vdisnin mbi shkëmbinj ndajnatëherë, pasi kishin nxjerrë në dritë nga një legjendë; për dallgët e rënda ngjyrë smeraldi dhe ujin e pafund; për ajrin e lirë të maleve që freskonin këmbët në det e që ai kishte dashur ta kishte të vetin; për të Bukurën e Dheut sylarushe, dhe për një xhelozë të madhe sa vetë bota. Që në fjalët e para, *Viola* e mallëngjyer kishte njojur bregdetin e vendit të saj.

I drobitur nga tërë ato kujtime, ai i kërkoi më pas leje të largohej, duke e lënë të trondituri pa asnjë shpjegim dhe, në pragun e derës, si përshëndetje, i çiku flokët me një të puthur të lehtë që nuk mjaftonte as për një flutur.

*Viola* mbeti në derë buzëdridhur, dhe ndenji ashtu pa lëvizur, derisa ashensori humbi boshllëkut te poshtë. Atëhere u shtri dhe nisi të klithët nga një lëngim i tmerrshëm dashurie që i nisi te buzët dhe i mori tërë trupin deri te thonjtë e këmbëve. Vuajti minuta të tëra, pa ditur si të qetësohej, me një brengë të madhe misteri në shpirt dhe me atë frikën e hidhur të rrokullisjes në humnerë që po i helmonte gjakun. Zuri t'i binte numrit të tij të telefonit që t'i lutej të kthehej tek ajo dhe t'i zbraste në pëqiqi të fshehtat e tij. Dhe pastaj, të boshatisur e të pastruar krejt nga misteret, të bënин dashuri gjer në agim, që të mbesnin gjallë. Vazhdoi t'i binte telefonit pareshtur, duke ftohur trupin në heshtjen që vinte përtej fillit e duke iu lutur me zë të kthehej tek ajo atij që nuk ndodhej asgjékund. Pas një ore të tërë, më në fund, iu përgjigj zëri i burrit i bymyer nga alkooli, dhe ajo e mbylli menjëherë telefonin, ngaqë ishte harxhuar e tëra dhe nuk kishte më ç'ti thoshte.

Dy ditë më vonë, *Viola* ende nuk qe shëruar tërësisht nga lëngimi i beftë i dashurisë së asaj nate, kur profesori i

telefonoi sërish, dhe sërish ajo e ftoi të pinin kafenë e pasditës. U kujdes të mos e vishte fustanin e blertë si bimë detare, që të mos ia turbullonte kujtesën profesorit të saj. Veshi, përkundrazi, një fustan të zi e të ngushtë që bënte një kontrast farfuritës me lëkurën e saj të bardhë, me një dekolte të mrekullueshme, qarkuar nga një vetull dantelle, që dukej sikur mezi e mbante kërcellin e brishtë të qafës së saj. Notonte në një pranverë të vakët e të lulëzuar, dhe trupi i saj i mësuar me dashuri kish filluar të drithërohej lehtazi nga spazma të vockëla ankthi. Si do ta shihnin sytë e tij?

Kish qeshur sa herë me shoqet e saj që visheshin e kriheshin vetëm pér sytë e burrave, se vetëm ata mund t'i gjykonin e t'i orientonin hullive të bukurisë. Kishin arritur deri atje sa të krijonin një shije të përgjithshme mashkullore dhe vetëm asaj i përbaheshin. Shijet e tyre të veçanta femërore nuk kishin pikë rëndësie. Viola kukurisej tek i shihte që ndryshonin krejt, tek metamorfozoheshin dhe merrnin pamje nga më të çuditshmet kur u dilnin burrave përpëra, duke u mekur nga ankthi dhe frika, a thua se në sytë e tyre do të shihnin vlerën e vërtetë që kishin. Tani ajo vetë kish rënë në kurthin vdekjeprurës të syve të burrit. Por nuk zgjati shumë. Në sallonin dritëpaket të shtëpisë së saj, ajo u mundua të depërtonte e të burgosej në të blertën e syve të tij, por ai e shpëtoi duke e tërhequr me ngut pas vetes së tij dhe e shpuri të pinin shampanjë të rrallë në apartamentin e tij, në katin e pesëmbëdhjetë të një ndërtese afër portit, ku kohë më parë ajo kish ndenjur orë të tëra duke soditur karavelën e Kristofor Kolombit që dergej e pandryshuar në një lym kohe. Kaluan nëpër Plaza Mayor ku kishte shpërthyer një festë pa emër, ku po vallzonin ngathtazi disa figura gjigantësh, dhe ku asaj iu kujtua se kish kërcyer Sardanën vitin e kaluar së bashku me Bertranin.

Apartamenti i tij ishte i vogël, i stisur me një rregull maniak që mbante erë farmacie dhe me një kotje të paqtë vjeshtake. Dhe ishte përmbytur nga bufët. Në çdo hapësirë

të zbrazët të bibliotekës qëndronte shpendi i urtë; kishte buf të argjendë me sy rubini, buf të fildishtë, buf të drunjtë, buf plisi, buf prej gëzofit, buf plastikë, të qelqtë, buf qeramike...

Shampanja e çmendur ngjyrë vjollcë i ra Violës në kokë. Fluturake ajo nuk priti më, por iu ngjit gotës së shampanjës dhe priti e priti pa fund, e nderë mbi një gjerdan filluskash vere, atë që gjerbte heshturazi shampanjën me sy fundosur në trupin e saj. Atëherë ajo e kuptoi se gjithçka midis tyre nuk qe e plotë, përderisa ai nuk e njihet trupin e saj. U ngrit ngadalë me këmbët ngulur fort mbi rruzujt e filluskave dhe i pëshpëriti burrit te goja një "te quiero, te quiero mucho", që e rrokullisi pastaj në një hon pendese. Ai e uli nga gota e shampanjës, dhe, plot dhemshuri, ia mori kokën në duart e tij të mëdha, dhe nisi t'i tregonte me një zë pa kohë e që s'ngjante i tiji, për Katalunjën e lashtë. I rrëfeu zvargazi, tamam sikur gjerbte shampanjë, legjendën e kontit Guinfred el Velloso dhe atë të emblemës së artë katalane që mbante katër shufra gjaku; i tregoi për Sharlëmanjin e shenjtë dhe pavarësinë e Katalunjës nga francezët, duke i puthur lehtazi flokët, ndërsa ajo digjej përtë në thëllësi të honittë pendesës. Dhe, në fund, i shpjegoi me bindje se shpirti i pavarur i Katalunjës nuk kishte vdekur ende, ndërkohë që ajo dha shpirt përtë, përfund honit.

Të nesërmen në mëngjes, Viola mori ekspresin për Madrid. U mendua gjatë, përpara se të vendoste të shkonte së pari në El Retiro. Mezi e njohu parkun e vjeshtës së saj. Vargu i mbretërve të bardhë ngjante i ngrirë dhe i pafund, dhe s'kish mbetur kund një gjethë zverdhake. Mjelma vetmitare në pellgun e përmbytjes së tokës kishte ikur së bashku me shtresën e ndenjur e të palëvizshme të gjetheve, dhe kish lëri pezull mbi hauz një avull magjik ftohtësie. Qielli i plumbtë i kish përzënë cigankat vezulluese. Nga zallahia e vjeshtës kish mbetur vetëm një fëmijë që po hante akulloren e fundit të botës.

Viola u ndal përballë ngrehinës së qelqtë që tashmë

qe mbyllur për të armiqësore. U ul mbi një stol të ftrohtë dhe nisi të vinte rregull në kujtime, që të mund të kuptonte atë që s'po kuptonte dot. Nuk e pati të lehtë, se ato i vinin e i ngatërroheshin me dëshirat dhe ëndërrimet e saj që patën marrë formën e kujtimeve. Luftoi për të vënë rregull në to, derisa një ndriçim i beftë i mendjes e bëri të kuptonte gabimin e hatashëm: po përpinqej të hynte dhunazi në një botë që refuzonte ta pranonte! Po përpinqej të fitonte një dashuri që s'ishte për të! Dhe bota e huaj ia kish kthyer përgjigjen e prerë - do t'i jepte vuajtje gjer në fund, derisa ajo të mësonte të tërhiqej.

Viola shkundi flokët e rëndë gështenjë që kriheshin vetë nga pesha e tyre, dhe mendoi se ndoshta tamam këtë dëshironte: të dhunonte një botë që s'ishte e saja. Më pas e kuptoi se do të lodhej befas, siç i ndodhët me të gjitha pasionet e saj të vrullshme, dhe vendosi pa dhembje të tërhiqej. Madje për një çast u çudit se si nuk e kish marrë më parë atë vendim. Vetëm atëherë, e çliruar, u kujtua se duhet të fliste patjetër me shtëpinë në telefon, se duhet të ishte interesuar më kohë se si po i shkonte filli përbësjes së madhe të vendit të saj, dhe një ndjenjë faj i kaploj zemrën. Mund të lidhej me familjen shumë më shpejt nga ç'mendonte, dhe u habit kur mori vesh se meraku i prindërve të saj qe më i madh se meraku i saj për ta. Me sa dukejt mendoi, shqetësimi i vërtetë nuk lind larg ndodhisë, siç thonë, por brenda, mu në qendër të saj. U ul në një kafene trotuari dhe, përpara se të porosiste kafen, i telefonoi mikeshës së saj. Ajo e gjeti symavijosur nga brenga, por të qetësuar, si të vinte e hidhëruar nga një varrim i zgjature i dhembshëm, por me ngushëllimin se mund të kthehej sa herë të dëshironë në qimiter, që të qante mbi varrin e qënies së dashur. I respektoi brengën. Në makinë, megjithatë, rrugës për në shtëpinë e saj, i tha se kish telefonuar Profesori. Viola mbajti frymën dhe nuk foli. Por pas disa sekondash e pyeti:

- Dinte gjë që ndodhem këtu?

- Jo, çne! Është e premte sot, apo jo? Ne flasim në telefon çdo të premte. M'u duk ndryshe. E ke lumturuar, Viola.

Viola nuk u përbajt.

- Të lutem Maria, më thuaj diçka për Manuelin.

- Pak të kam folur për të?

- Jo, jo, më thuaj diçka për jetën e tij intime, - Viola qe nervozuar papritur.

- Unë të të flas ty për jetën e tij intime! Viola, mos u bëj fëmijë!

Maria vështroi sytë e ndezur të vajzës dhe buzët e tendosura, dhe padashur vijoi:

- Ç'të të them... Kur e njoha në fillim, u dashurova pas tij menjëherë. Madje edhe ai më dukej i dashruar. Por qeshë gabuar dhe fatmirësisht e kuptova shpejt. Që atëherë dhamë e morëm bashkë vetëm miqësi.

Viola qe zbeetur.

- S'ka pasur kurrë të dashur?

- Ç'thua! Sa herë vjen në Madrid, fle në shtëpinë tonë, sigurisht. Por në mëngjes, ama, kur e shoqëroj me makinë për në aeroport, gjej një tabor me mikesha të tij që vijnë ta përcjellin. Madje kam dëgjuar historira, ha-ha-ha! - Maria i shkeli syrin.

Shtrirë në shtrat në dhomën e Natalias, vajzës së vogël të Marias, nën një qiell gëlqereje me yje të fosfortë, Viola ndenji orë të tëra duke vështruar shtrigat e mrekullueshme të bibliotekës së Natalias, dhe mendoi se dhe ajo vetë ishte domosdo njëra prej tyre, ndoshta ajo më e reja, që dukej sikur mezi ç'priste t'i hipte fshesës së saj të hollë e të brishtë, që të fluturonte e të rrëmbente me marifete magjje zemrën e primit të tjetërkujt. Ju lodhën sytë dhe ra në një përgjumje të ëmbël; para se ta zinte gjumi i thellë, me një dritë të vakët mendjeje, mendoi se ndoshta do të qe më mirë të ishte lugat që të rrëmbente zemra përdhunshëm, dhe zuri të recitonte pa vetëdije e pa zë "Lugatin" e Bodëlerit në

origjinal. Më pas, me shpejtësi rrufeje, kujtesa e saj recitoi vargje Lamartini, Remboje, Andre Shenieje.

Në anën tjetër të botës, në shtëpinë e mbushur me kotje vjeshtake, profesori mendonte përtë. Vargjet e poetëve të mëdhenj francezë, që Viola po i recitonte pa vetëdije dhe me një dritëz të vakët mendjeje, i erdhën një e nga një deri te shtrati i tij dhe e mbushën me lumburi, pse e kuptoi, që në tingëllimin e parë, se ato vargje të mësuara në moshë të njomë, po i kushtoheshin vetëm atij.

Të nesërmen, kur mbërriti në Barcelonë, Viola u gjend ballazi me një vendim, i cili brenda një çasti të vetëm ia përtëriti dhe ia bëri të gjalla ëndërrimet e tërë viteve të rinisë së parë: Francën. Nuk e vroa mendjen se si kish mundur Profesori të pikaste ëndrrën e saj të vjetër, ngase tani qe e bindur se ai njihte çdo pjesëz të jetës së saj.

Brenda dy ditëve bënë gati gjithçka. Ai arriti të siguronte një vizë përtë në konsullatën franceze, ajo përgatiti zemrën. Do të vizitonin Jugun e Francës. Udhëtimin do ta bënin me makinë.

Viola rrinte e qetë dhe e ftohtë në vendin e saj. Kërkonte revanshin. Kish vendosur të matej në gjithçka, të mos lejonte t'i binte në kokë pasioni, që të mund të parandalonte gremisjet e padurueshme në honine pendesës. Kishte gjysmë ore që kishte pirë një kokërr Biodraminë kundër marramendjes së makinës dhe atë çast ndjeu një turbullirë të lehtë në kokë. I dha karar të strukej në kotjen e Biodraminës. Përpara se të qetësonte drithërimën e qepallve, e vështroi atë dhe u shtang. I gjeti të grumbulluar në sy, si një llum të vjetër vere në fundin e një amfore antike, një pasion të lashtë dashurie, që po ia përvëlonte dhe po i thellonte gropat e syve. Kishte ndodhur befas dhe pa asnjë paralajmërim. Viola e këputi shikimin nga një lloj frike pa emër. Pastaj e vështroi sërisht tek ngiste i përqëndruar makinën, dhe përdesh u dogj në atë zjarr. E mposhti kotja e Biodraminës që e zhyti ëndrrave...

*“...Kur qepallat e rrumbullta tē valës  
trupi i saj, kupat e saj  
gufojnë lëkurën e detit...”*

.....

*Vjen si një lule që nga toka,  
por, kur kjo lule e thellësive pëlçet,  
sjell gjithë dritën që dot nuk shkrepit,  
sjell tërë degët që nuk u dogjën  
dhe gjithë burimin e bardhësisë...”*

*Male tē larta valësh u turreshin shkëmbinjve me lëmashkë. Bota mbytej në bardhësi tē lagësht. Dielli ndërronte ngjyrë. E Bukura e Dheut në shpellën e skërkave, hapte duart e i zhyste në shkumë deti që tē freskonte zemrën. Shkuma i sillte në fshehtësi edhe përshëndetjet e qenieve detare. Nga ishulli i Krëtës, një shkumë e kaltëri solli ca fije floku si kujtim nga një nimfë endacake, tē cilën ajo e pat gjetur plasur shkëmbinjve që igrinin mishin e pavdekshëm, dhe e kishte shëruar...*

Makina ecte fare ngadalë dhe mundimshëm. Viola hapi sytë nga një ndërrim universesh dhe vështroi nga dritarja. Përjashta qe borimë. Kur ishin nisur ajo mbante mend se i qenë vënë mbrapa një dielli shkëlqimtar me një disk tē përkryer që i udhëhiqte në një udhë pranvero - vjeshtake, e cila tërhiqte fuqishëm pas horizontin. Tani dielli kish humbur. Nuk kishte më as qjell e as zogj, vetëm një si mjequll idhnjake e zymtake, e cila rrinte pezull e ngrirë mbi tokë. Rrotat e makinës lëshonin një kërkëllimë ogurzezë tek shkelnin mbi një borë tē ngrirë, përzier me baltë pa ngjyrë. Një tabelë që u doli përpara “Të mos kalohet shpejtësia 50

km/orë", i rrëfeu asaj vërtetshëm tmerrin nëpër të cilin po kalonin. Nën këmbët e tyre, Viola u drodh, hapej një hon ferri pa fund e pa anë...

Ndodheshin në Col d'Aubisque. Viola ndjeu përqëndrimin e dridhëruar të tij në timon dhe, tek hodhi sytë në hartën që kishte përpara, e kuptoi gabimin e saj të madh; kish ngulur këmbë të kalonin nga Tarba e heroit të fëmijërisë së saj - d'Artanjanit - dhe kapriçoja e saj duhet të përshkonte Col d'Aubisque. Nuk foli. U mblodh përsëri kutullaç në sedilje dhe priti të kalonte tmerri. Për minuta të tëra tmerri i saj luftoi me kotjen e Biodraminës.

-Viola, Viola, hapi sytë, shiko ku kemi ardhur!

Vajza hapi sytë me zor dhe gjeti mbi sup dorën e Profesorit. Zbritën nga makina në një shesh të vogël, të mbuluar me një shtresëz miell dëbore. Iu avitën cakut të sheshit; nën këmbët e tyre u shfaqën Pirenejtë madhështor.

-O Zot, ç'përrallë kozmike! - Viola mbylli sytë dhe hapi krahët. Ndjeu me gjithë shpirt se mund të fluturonte mbi kreshtat e vjollcëta të maleve, ngase trupi i kish humbur peshën dhe, për një çast, e harroi revanshin, maturinë, gremisjen në honin e pendesës së pasionit të saj; u kthyte e përmalluar nga ai, por i gjeti sërisht në sy, kur nuk e priste, llumin përvëlues të dashurisë antike. U shtang.

Më tej, sikur të ishte bllok nga ija e Pirenejtë, shfaqej një ngrehinë e madhe e murme dhe e ftohtë, të cilën Viola nuk e kish pikasur deri në atë çast. Në një cep të çatisë së saj varej një dielli i plotë, i zbehtë.

-Shkojmë të pimë një kafe atje? - tha Profesori.

-Pse, kafene është? - Viola nuk guxonë t'i shihë sytë.

-Është shtëpi pushimi, por ka edhe kafene.

-Jo, jo, më mirë nisem! më duket si shtëpi magjistarësh. Shiko, vetëm me sajesa magjie mund të varet dielli në cep të çatisë.

-Ha-ha-ha! - Profesori qeshi me gjithë shpirt. - Shtëpi magjistarësh.

Nisën prapë rrugëtimin; kësaj here nëpër një udhë pa tmerr me pisha të larta plot muzg, të shtruar me kristale dëbore të kaltëruar. Viola nuk harroi të fuste në gojë një kokërr tjetër Biodraminë...

*E Bukura e Dheut kish kohë që i kish flakur petkat njerëzore dhe mbante trupit thurima e mrekullueshme dantellë që Katallani ia qepte vetë në agim pa dalë dielli, me alga bleroshe e bimë të tjera detare. Trupi i saj i qumësht e i epshëm ngjante si trup sirene. Ditën, kur ciklat e arta të rezeve të diellit depërtionin në skërkat e lëmashkëta, ajo bënte me to gjerdanë e kurora dhe humbiste mendjen duke lodruar, kur shkuma e dalgëve arrinte gjer në shpellë, e Bukura e Dheut sylarushe qetësonte përpëlitjet e zemrës në freskinë e saj, dhe mblidhte jetë që të jetonte në muzg. Ndajnatëherë, kur zinte të mugej, kur shkuma-balsam qe tretur, kur cikrrat e arta diellore qenë shuar, ajo zgjaste mes shkëmbinjve një tufë nga flokët e saj të rëndë gështenjë, të cilën më parë e ngarkonte me gjithë dashurinë e shpirtit, që Katallani vigan ta cikte me buzë. Ai avitej ngadalë, zinte me hijen e tij horizontin dhe bëhej njësh me qiellin. Zogjtë merrnin arratinë dhe peshqit strukeshin në zemërtë detit që t'i shpëtonin xhelozisë vdekjeprurëse të syve të Katallanit. Ai ulej pafundësish që të mund të vinte buzët mbi tufën e dashur të flokëve. Përnjë çast, syri i tij i vetëm shfaqeji si një copë e blertë oqeani e tallazuar përpara syve të saj, që atij çasti dëshironte vetëm të hidheje të mbytej në syrin e tij. Por ai e ruante si bebëzën e atij syri, dhe nuk e linte të mbytej. Ajo vdiste për të ditën e dielltë dhe natën me hënë, dhe ngjalëj e bëhej me frymë vetëm kur niste të mugëllonte. Qante e u lutej dallgëve t'ia hanin e t'ia mpaknin trupin Katallanit që të mund ta merrte në gj...*

Makina kishte ulur shpejtësinë. Kish hyrë në qytet.

-Viola, arritëm në Beziers.

Viola nuk e dëgjoi. Profesori vuri kasetën e poemës *Testamenti i vjeshtës*. Qetësinë e përgjumtë të makinës e krisi zëri i vyer i Nerudës:

*Midis vdekjes dhe mosvdekjes,  
Vendosa të zgjedh kitarën...*

Viola nuk e dëgjonte...

*Natën e thellë, kure Bukura e Dheut kishte vdekur për të në një skutë të shpellës, Katallani, gjithë zhur dashurie këpüteje e zhytej si një shkëmb në det. Shtyllat e ujit ngriheshin gjer te malet dhe binin sërish të shkrumbuara në një shtrat zhurgu... Pasi fitohej, Katallani hapte me thonj kraharorin dhe derdhite gjak zemre në det...*

*E përskuqur, shkuma e valëve, i rrëfente në agim të Bukurës së Dheut për të fshehtat e natës.*

Kur zbritën në Arles dhe parkuan makinën pranë Amfiteatrit Romak ia kishte behur nata bashkë me Mistralin e stuhishëm. Viola e kishte kokën plumb nga tërë ato Biodramina që kish pirë, dhe era e ngriqtë i ngjante sikur e lehtësonte. Në hotelin *Saint-Trophime* zunë dy dhoma dhe lanë bagazhin e pakët.

Murlani i Mistralit i çorientoi rruginave pa fund të qytetit, derisa dikush i ndihmoi të gjenin më në fund restorantin më të mirë të qytetit, sipas fjalëve të hotelxhiut, *L'Olivier*.

Në mes të hollit, ku ndodhej edhe libri i të ftuarve, që mbante emra të rëndësishëm, e ku pas darke Viola shkroi *C'était vraiment parfait*, gjendej një pemë e gjallë ulliri, e vjetër sa bota, gjithë nyje e gunga. Në muret e pasuvatuara

që ruanin një klimë të qëmotshme digjeshin shandanë të tymtë. Diku më tej, pas shpinës së disa të ftuarve të heshtur, shndriste një zjarr brambullitës vatre.

Profesori ishte përballë saj. Në mes të tryezës xixëllinte një qiri gjysmë i tretur. Ai ia kish ngulur sytë e blertë gotës së shampanjës. Viola i gjente sytë e tij të shtrirë në fundin e gotës. Befas, një flakë nga zjarri i vatrës hipë e qëndroi në mes të tryezës, pranë qiririt të tretur. Herë i frynte gjuhët e saj lart, herë tulatej si e frikësuar pa shumë shkëlqim, dhe bëhej njësh me qiririn. Viola u përqëndrua tek ajo. Ndërkohë, kamarieri kish ardhur pranë tyre me një tryezë të vogël prej xhami me rrotëza dhe kish nisur të recitonte emrat e dhjetra e dhjetra djathërave.

-Viola, zgjidh djathërat që të pëlqajnë, - i foli ai.

-Nuk i njoh, nuk kam dëgjuar asnjëherë, - iu pëf gjigj vajza gjysmë e dehur nga soditja e flakës.

-S'prish punë! Këtu qëndron magjia, zgjidh kuturu, pa e vrarë mendjen, serbes sikur t'i kesh njohur prej një jete të tërë.

Ajo s'ia vuri veshin. U zhyt sërisht në soditjen e flakës mbi tryezë për t'u dehur e tëra, dhe dëgjoi papritur e pakujtar të fshehtat e shkumës së valëve dhe të Bukurës së Dheut...

*E Bukura e Dheut mbante përpara duarve shkumën e valës:*

-Ai është i pavdekshëm, shpirti im! Unë, përfat të zi, jam vdektare; ai është si mali, unë sa lulja rrëzë tij. Po më shkojnë ditët pa e dashruar! Sa dua të mytem tek ai, por s'më lë syri i blertë; o Zot sa e dua e sa frikë që e kam!

-Duro, moj e Bukur, duro! Ai do të të bëjë të pavdekshme! Po nuk durove, do ta dashurosh një grimë dhe do të të shuhesh përjetë! - i mërmëriste shkuma.

-Ta dashuroj një grimë? E ç'më duhet tjetër? Por kur vallë, kur? - dëneste e Bukura e Dheut.

-Pas një mijë vjetësh! - i përgjigjej shkuma e valës...

Viola i ndiente faqet prush të nxehta. Duart i kishte akull. Flaka e tryezës qe kthyer në vatër. Ajo u ngrit. Bota tani notonte ngadalti në një tymnajë të hollë. Ai i futi krahun.

Në sallonin e ullirit vjetërak, Viola mori librin e të ftuarve, ndërsa profesori u fut në qilarin modern të qindraverërave për të marrë me vete një shishe nga vera e asajmbrëmjeje. Pas një grime, si një krizë e beftë sëmundjeje, vajzës i zuri fryshtë daldia e pasionit të saj. E kuptoi përfat se s'mund të bënte dot asgjë kundër tij; e la veten të lirë dhe ndjeu se vetja po e tërhiqte zharg përtë qilari i qindraverërave. Me buzët që nuk i ndiente më të sajat, filloi të pëshpëriste pa i dëgjuar vetë fjalët: "Manuel, mon petit Manuel..."

Përcartej frengjisht. Kur u gjend në dhomën e hotelit, mori vesh për një çast se po përcartej në gjuhën e nënës, ndërsa gjigandi i saj i përgjigjej në katalanë. Nuk kuptoheshin, por ndodheshin në krahët e njëri - tjetrit. Viola iu afroa buzëve të tij, sikur t'i afrohej një Qëllimi të Madh. Ende mendjekthjellët, Profesori u përpoq sa mundi ta shmangete. I zuri fortazi supet e bardha dhe bëri ta largonte nga vetja:

- Viola, jo tani Viola, është akoma shumë shpejt! Duro, Viola! Viooola!

Forca e tij ishte mpakur. Sytë nisën t'i mbusheshin rrëmbyeshëm me llumin e moçëm të dashurisë së frikshme. Ai u tmerrua dhe klithi përvajshëm.

- Mos Viola, nuk dua të të humbas, Viola! ...

Sytë e tij të blertë ishin fundosur krejt në llumin e moçëm të dashurisë.

Kishin kaluar një mijë vjet. Violandjeu krahëte fuqishëm të burrit që e ngritën Jart dhe e mbajtën pezull mbi botë,

ndjeu afshin e përvëluar të buzëve të saj dhe qe në gjendje të mendonte se po puthej për herë të parë në jetë.

Ai qe kthyer në mal dhe po e zinte vajzën përfund. Ajo e ndjeu trupin t'i squlej, ndjeu eshtrat t'i thërmoheshin nga një forcë e perëndishme. Gjeti pranë syve të saj sytë e tij të bashkuar në një, që u shfaqën si një copë e blertë e tallazuar oqeani. Kishin kaluar një mijë vjet. Viola nuk priti më asnjë çast -- s'kish forcë në botë që ta ndalte: u hodh dhe u mbyt e lumtur në syrin e blertë të dashurisë së saj...

## AKSIDENTI

*"Gjithçka ndodh për  
herë të parë, por në  
një botë të përjetshme.  
Ai që lexon fjalët e mia,  
është duke i shpikur ato."*

(J.L.Borges *Shifra*, 1981)

Kishte shumë kohë që e parandjente aksidentin. Parandjenja, ndonëse e njëjta, kish marrë qindra forma. I pat ardhur për herë të parë nga një kujtim, të cilin në fillim ai nuk e kish lidhur dot me jetën e tij. Më pas, duke u kredhur më thellë në kujtime, kish zbuluar se ai kujtim rridhete nga një tjetër kujtim, ndërsa ky nga një kujtim i tretë. Duke u vajtur pas një vargu të pafund kujtimesh, duke urrezuar hera-herë nëpër ta dhe duke gjetur rrallëherë ndonjë copë filli udhërrëfyes, arriti të merrte vesh se Kujtimi që i pat pjellë parandjenjën e aksidentit, ja i përkiste atij në një tjetër jetë, ja i përkiste dikujt tjetër. Arriti të merrte vesh edhe alkiminë e ndërtimit të parandjenjës; kujtimi i vendoste qartazi përpara syve një imazh dhe një ndjesi: imazhin e një aksidenti të tmerrshëm automobilistik dhe ndjesinë e zbritjes së lumtur nëpër rrathët e Ferrit, përmes aromës së pashqitshme të "Xeryus".

Më pas, parandjenjën e aksidentit ia krijonin të gjitha aksidentet automobilistike që ndodhnin çdo çast nëpër botë

e ku ai qe fatalishti i pranishëm gjithsaherë. Nisi t'i ngatërronte e t'i bënte lëmsh realitetet e aksidenteve, të filmave, të jetës së vërtetë dhe atyre që i përsëriteshin si kujtime të të tjerë njerëzve.

Jetonte prej kohësh në një rrethm në aksidentesh dhe parandjenja aksidentesh, kurtmerri i pangjyrë që i shkaktonin e që ia diktonte rrahjet e zemrës iu shua vetiu. Qe çasti kur filloj t'i kishte për zemër aksidentet. Filloj t'i donte paskëtaj me një dashuri të thekshme e të vërtetë, aq sa brenda trupit erdh e iu rrit një pasiguri dhe një ankth tragjik: a do të ndodhë vërtet aksidenti i tij? Do të ishin vetëm një, apo dy, tre shumë aksidente? A do ta shënjonte Fati me një privilegji që nuk e gëzojnë të gjithë të vdekshmit? Do t'i dilte e besës parandjenja? Ajo ç'i kish sjellë ndjenja paralajmëruuese s'ishte veçse reflektimi i një kënaqsie të pandodhur. Po kënaqsia e vërtetë?

Priti e priti gjatë, dhe kur mendoi se realiteti ishte fort i varfër, i vuri flakën imagjinatës.

Atëherë kur nuk e priste, një buzëmbrëmje të vaptë e të trishtuar vere, aksidenti ndodhi vërtet. I kredhur siç ishte në atë qerthull marramendës e të paanë imagjinatë dhe reflektimesh aksidenti, ai nuk kish për të kuptuar gjë, por një çast vetëtimë mori përsipër t'ia rrëfente të gjitha.

Qyteti notonte në një avullim të qelqtë e të nxehët që buronte nga toka. Syngultazi mbi një pikë të qielliit ai ecte i shkujdesur në mes të rrugës (kështu ecte, kishte vite) mes tollovisë së makinave që fluturonin pa e prekur, sikur gjithçka të ndodhë në një ëndërr, në kërkim të aksidentit të tij të pamundur. Befas, një valë rrëmeti (por mund të qe edhe një fillad ere) e goditi në ijen e majtë dhe e vidhisi. Nuk kish për të marrë vesh asgjë; nuk kish përtë kuptuar dot se pat ardhur më në fund aksidenti që kish pritur një jetë të tërë; por u gjend një çast -vetëtimë, që mori përsipër t'ia rrëfente të gjitha: ai vështroi pa dhembje se si iu shthur, gjer në syçkën e fundit, thurima e hatashme e organizmit të tij. Vështroi si u

transformua materia e ngurtë në të lëngët dhe pastaj si u derdh sheshit. Pa substancën gri të dilte nga kafazi e të ndërronte formë; pa gjithë rrjetin e gjakut (sikur të mos qe i tij) që u shpartallua, pa eshtrat si u zberthyen e dolën vendit, arriti, më në fund, të shquante lëndën kozmike që është thelbi i jetës sonë...

I pa të gjitha shkoqur, pa dhembje e pa keqardhje, por edhe pa kënaqësi, si në një film të ngadalësuar dhe kërkoj të dinte se në ç'pikë të kozmosit ndodhej mendimi i tij.

Vazhdonte të mbante një farë lidhjeje me mendimin e tij në pikën e kozmosit, kur e shpunë (atë, apo një pjesë të atij që pat qenë trupi i tij) në një sallë të bardhë që mund të qe burg e spital njëherit, dhe e lanë poshtë disa dritave të fuqishme që i derdheshin lumë përsipër.

Filloi për të një përjetësi torturash që e shpinte në botën reale, të cilën ai mundohej tanë harronte.

Nxehtësia dhe akullima ndërronin vend me njëra - tjetrën tek shoqëronin çelikun e ftohtë që punonte paprerë brenda mishrave të tij...

Nuk pati zbritje të lumtur nëpër rrathët e ferrit, e aromë të pashqitshme të "Xeryus". Vetëm përjetësi torturash. Ai eurreu botën reale, aksidentin, përbërjen e tij prej mishi e gjaku, Ferrin që nuk ekzistonte dhe ëndrrat e tij dhe, pasi u mbush me urrejtje gjer në grykë dhe derdhi në të tërë forcën e shpirtit, një mrekulli e shpëtoi nga përjetësa e torturave. Atëherë pati mundësi të dilte me këmbët e tij nga ajo sallë e bardhë që mund të qe burg e spital njëherit, dhe të hidhej në botën e madhe. Asnjë i afërt nuk e priste. U hidhërua.

Në rrugë, kuptoi se kish ardhur vjeshta. Një vjeshtë e butë e lagësht dhe me aromëra. Tek i kalonte me ëndje nëpër filtrin e nuhatjes, befas, mes aromrave të verdha vjeshtake, zhbiroi aromën e pashqitshme të "Xeryus".

Kure ndjeu veten të rimëkëmbur ndërmori një udhëtim të gjatë e të lodhshëm për në qytetin e tij të dikurshëm. Atje,

në fëmijëri, kish ndjerë për herë të parë, përzier me aromën detare, aromën e pashqitshme të "Xeryus". Thoshin se atë e sillnin marinarët e largët që shfaqeshin agut pranë brigjeve të shkëmbinjta të qytetit, sa për të lëshuar aromën, dhe që zhdukeshin pastaj përtëj detit dhe s' dilnin kurrë në stere.

I kaloi orët e gjata e të mërzitshme të udhëtimit, me një diell të ngulët e verdhacuq që s'ndërronte vend në quell, duke lexuar njëra pas tjetrës Nëntë Esetë Danteske. Leximi në lëvizje i krijonte një marramendje të fortë dhe një ngërç të padurueshëm në stomak, por e ndihmonte të kuptonte se pat mbetur gjallë. Koha e la pas gjithçka lidhej me aksidentin e tij. Koha po e fuste në qytetin e dikurshëm, ndërkohë që ai lexonte "Puthja e fundit e Beatriçës" dhe ndiente se, me shuarjen e vegimit të Beatriçës në lartësirat e bardha, po humbiste pak e nga pak aroma e pashqitshme e "Xeryus" rrotull tij.

Kish nisur të rigonte një shi i vakët. Ajri qe mbushur me shushurima gjethesh të thara, ndërsa rrugët me një trishtim vjeshtak.

Qyteti i tij i dikurshëm iu duk i vjetruar e ca i ronitur, sikur gjatë tërë asaj kohe që nuk e kishte parë, aty të mos kishte bërë vaki gjë tjetër, veç plakjes së tij.

Udhës së detit ndodhej shtëpia e fëmijërisë së tij, ku e gjyshja vazhdonte të ekzistonte vetëm dhe pa moshë, duke u dergjurmës kujtimeve dhe dantellave që shkumëzonin paprerë nëpër duart e saj. Përpara se të hynte brenda, atij iu ndërmend se midis grumbullit të gurëve në oborr kish parë iriqin e vetëm në botë, pse asnjëherë më pas gjatë jetës së tij nuk i kish zënë më syri iriqë, se pas shtëpisë gjendej një pus i ulët mes pemësh të panumërtë, ku kishte rënë dhe qe mbytur mijëra herë gjatë ëndrrave të tij të liga.

Gjyshen e gjeti mbi sofanë e mbuluar me një qilim me thekëkuq e zi, mes një lumi bajamesh dantelle. Nuk i foli, pse mendoi se do të kishin shumë kohë për të biseduar e për t'u çmallur. Iu bë se pranë musandrës në korridor pa qenin e

përhershëm të shtëpisë dhe kurnuk e gjeti, e kërkoi gjithkund mes heshtjes së hatashme që mbushte shtëpinë dhe tërë rrëthinën e saj, duke i thirrur me emrin e tij. Kur u bind se qenë e kishte harruar përfundimisht, mori të shkonte nga deti që e kish hedhur rërën e bregut të tij gjer në oborrin e shtëpisë.

Shiu i vakët e hollak kishte qullur një shtresëz të hollë rëre, e cila thyhej nga hapat e tij dhe krijonte gjurmë të bardha rërëshkrifëta. Gjurmët shkonin gjer në bregun e mbuluar me mbeturina leshterikësh, guaskash të vdekura ditëve të shkuara dhe oktapodësh të gjymtuar.

Ndonëse ajri mbante erë shiu hollak, ai ndjeu nëpërtë aromën "Xeryus" të marinarëve që vazhdonin të largoheshin me vite nëpërdet, pa dalë kurrë në stere. Zbathi këpucët dhe u krodh në detin e bregut, siç bënte në fëmijëri, përtatndjerë më mirë aromën mes ujit. Uji shkumëzonte rrotull këmbëve të tij.

Ai priti të ndiente në lëkurë freskinë detare; priti që deti ta shihte së brendshmi, ashtu siç po e shihte ai. Në çast, kuptoi se boshti i dy botëve të huaja për njëra tjetrën i ndante rreptë dhe përgjithmonë. Lemerishëm kuptoi se nuk ekzistonte, se kishte vdekur diku në sallën e bardhë që mund të qe burg dhe spital njëherit, dhe se shpirti i tij kish ngecur në kujtimin eterik të aromës së pashqitshmë të "Xeryus"...

